



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2017 – Numri: 249

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E martë, 17 prill 2018**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 214, datë 28.12.2017	13495



## VENDIM

Nr. 214, datë 28.12.2017

**MBI MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË  
TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE DHE MARRËVESHJES SË  
PJESËMARRJES NË BURSËN  
SHQIPTARE TË ENERGJISË”**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “a”, dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, si dhe të nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 1, datë 19.1.2017, filloi procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë”.

- ERE, me shkresën nr. 100/8 prot., datë 27.1.2017, publikoi për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit, duke filluar nga data 28 janar 2017. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjitha palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve pune.

- Me shkresën nr. 88 prot., në datën 26.1.2017, ERE dërgoi Draftregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë, për marrje mendimi, pranë subjekteve: OSHEE sh.a., KESH sh.a., MEI, Autoriteti i Konkurrencës, AAES, Shoqata e Prodhuesve të Vegjël të Energjisë Elektrike, FIAA, si dhe AREA.

- Pas përfundimit të afatit 15-ditor të marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, rezultoi se janë paraqitur në ERE mendime nga Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 30/1 prot., datë 23.2.2017 dhe OSHEE sh.a., me shkresën nr. 2744/1 prot., datë 10.2.2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Të miratojë Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë”.

2. Këto Rregulla do të hyjnë në fuqi me bërjen të zbatueshme të modelit të tregut, në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë, siç parashikohet në pikën 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**RREGULLAT  
E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Kapitulli I  
Hyrje

Këto Rregulla Tregu përcaktojnë:

i) Një grup dispozitash që përcaktojnë procedurat për operimet dhe menaxhimin e tregut;

ii) Një kuadër koherent nën të cilin pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike mund të ndërveprojnë me njëri-tjetrin;

iii) Termat dhe kushtet e përgjithshëm për tregun e ditës në avancë;

iv) Termat dhe kushtet e përgjithshëm për tregjet e tjera të energjisë elektrike shqiptare.

Në të gjitha procedurat në lidhje me këto Rregulla tregu orët i referohen kohës qendrore evropiane (CET).

Monedha - Të gjitha pagesat dhe transaksionet financiare në treg do të shprehen dhe do të llogariten me monedhën që është rënë dakord në marrëveshje.

Njësitë - Të gjitha njësitë teknike shprehen me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI). Për shembull, gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë elektrike (energji elektrike) shprehen me



kwh (mwh, gwh), po ashtu gjenerimi, transmetimi dhe konsumi i energjisë reaktive shprehen me kVArh (mVArh). Kapaciteti ose kërkesa ose energjia shprehen me kw (mw).

## Kapitulli II

### Struktura e Tregut të Energjisë Elektrike

#### 1. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

1.1 Bazuar në ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE është përgjegjëse për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësve të tregut dhe për sigurimin e kontrollit rregullator në Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike.

1.2 Ligji për sektorin e energjisë elektrike i jep ERE-s autoritet për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. ERE ka autoritet të plotë mbi Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

1.3 Qëllimi i Rregullave të Tregut është përcaktimi i rregullave transparente dhe jodiskriminuese për Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike. ERE do të monitorojë vazhdimisht tregun e energjisë elektrike për të siguruar funksionimin e tij jodiskriminues dhe eficient dhe do të mbrojë konkurrencën efektive mes pjesëmarrësve të tij.

1.4 ERE do t'i rishikojë këto Rregulla Tregu për t'u siguruar që ato pasqyrojnë zhvillimet e sektorit shqiptar të energjisë elektrike dhe tregut rajonal.

1.5 Të gjitha aspektet e OST-së (dispeçerimi, operimet e tregut dhe të sistemit të transmetimit) duhet të funksionojnë në mënyrë transparente nën monitorimin rregullator të ERE-s, me qëllim zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike.

1.6 Roli i ERE-s në tregun e energjisë elektrike duhet të përfshijë edhe kontrollin e vendosjes së çmimeve nga biznesi monopol, politikat në lidhje me abuzimin me tregun, miratimin e rregullave, kodeve dhe ndryshimet dhe amendimet e tyre, ngritjen e bizneseve të rregulluara dhe lehtësimin e konkurrencës.

1.7 Tregu i organizuar i ditës në avancë dhe brenda ditës do të jenë sfera ekskluzive për tregtimin fizik të energjisë elektrike në kornizën kohore të ditës në avancë.

1.8 Rregullat për Tregun e Balancimit janë hartuar në një dokument të veçantë, si një grup rregullash më vete.

#### 2. ROLET E PJESËMARRËSVE TË TREGUT

##### 2.1 Bursa shqiptare:

2.1.1 Siguron të gjitha sistemet dhe ndërveprimet e nevojshme për operimin e BSHE-së (tregun e ditës në avancë);

2.1.2 Pranon aplikime dhe oferta për të blerë dhe për të shitur energji nga PPB-ja;

2.1.3 Merr dhe procesin kapacitetet e interkoneksionit nga OST-ja, si dhe informacione të tjera përkatëse;

2.1.4 Kryen ankandet e nevojshme dhe operacionet tregtare, në përputhje me rregullat e miratuara, duke përdorur për këtë qëllim, algoritmet *European Market Coupling*;

2.1.5 I dërgon PPB-ve përkatëse dhe OST-së, sipas afateve të përcaktuara, konfirmimet tregtare, duke përfshirë sasitë e alokuara dhe çmimet;

2.1.6 Publikon sasitë e shpërndara dhe çmimet përkatëse, sipas afateve të përcaktuara;

2.1.7 I dërgon PPB-ve përkatëse dhe OST-së, në përputhje me afatin e rënë dakord, njoftimet e kredive, llogaritë financiare;

2.1.8 Ekzekuton mjetet e shtrëngimit dhe pagesat për PPB-të përkatëse, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara;

##### 2.1.9 Mban dokumentet e transaksioneve;

2.1.10 Mban dhe përditëson kalendarin e tregtimeve;

2.1.11 Përbush kërkesat për transparencë, bazuar në rregulloren nr. 543/2013, dhe ushtron kompetenca të monitorimit të tregut;

2.1.12 Siguron që platforma tregtare është e aksesueshme nga të gjitha palët e interesuara;

2.1.13 Bursa e energjisë elektrike mund të kontrakttojë kryerjen e një apo më shumë shërbimeve të sipërpërmendura nga çdo subjekt që mund të ushtrojë këtë aktivitet, në përputhje me licencën e lëshuar nga ERE;

2.1.14 OST-ja është përgjegjëse për krijimin/përcaktimin e kompanisë që do të operojë Bursën e Energjisë. OST-ja ose të gjitha OST-të së bashku që janë licencuar në zonat e tenderimit dhe shërbehen nga kompania e Bursës së Energjisë do të kenë gjithmonë pjesën më të madhe të aksioneve të Bursës së Energjisë Elektrike.

2.2 OST-ja është kompania e pavarur shtetërore që kryen këto funksione:

2.2.1 Operimin fizik të rrjetit të transmetimit (pronësisë, mirëmbajtjen dhe zgjerimin);



2.2.2 Operatorin e sistemit, në përputhje me kërkesat e direktivës 2009/72/EC, duke përfshirë dispecerimin;

2.2.3 Të sigurojë shërbimin e lidhjes për të gjithë përdoruesit e lidhur me rrjetet e transmetimit, në kushte jodiskriminuese;

2.2.4 Përcakton kushtet për t'u bërë palë përgjegjëse balancuese (PPB) dhe palë shërbyese për balancim (PSB);

2.2.5 Zbaton procesin e llogaritjes së kapaciteteve ndërkufitare, koordinuar në përputhje me kërkesat në tregjet e organizuara;

2.2.6 Funksionin e Operatorit të Tregut të Balancimit:

i) Parashikimin dhe blerjen e shërbimeve ndihmëse, të ndara në energji balancuese dhe kapacitete rezervë, nga të gjithë ofertuesit e shërbimeve të balancimit, në një javë, ditën përpara dhe afatin kohor real të bazuar në treg.

ii) Kryerjen e veprimeve të nevojshme për balancimin duke aktivizuar rregullimin sekondar në ulje ose në rritje nga rezervat balancuese dhe/ose rezervave shtesë balancuese të ofruara në tregun e balancimit të energjisë elektrike;

iii) Blerjen e humbjeve të transmetimit në ditën në avancë bazuar në tregun e organizuar. Për periudhën tranzitore përpara se DAM-ja të filloi aktivitetin, procedura e prokurimit javor është e lejuar për OST-në, sipas rregullave të miratuara nga ERE;

iv) Kompensimit për shërbimet e balancimit që ofron, duke siguruar likuidimet financiare mbi baza mujore, nëpërmjet shlyerjes së disbalancave, bazuar në rregullat e përlllogaritjes së disbalancave, duke siguruar që iniciativat e duhura për pjesëmarrësit e tregut të jenë balancuar në kohë reale apo të afërt me kohën reale. Rregullat e llogaritjes së disbalancave reflektojnë devijimet ndërmjet gjenerimit, energjisë së tregtuar dhe konsumit të të gjitha palëve përgjegjëse balancuese dhe të çdo pale përgjegjëse balancuese. Ajo është e bazuar në një sistem të vetëm të çmimeve duke penalizuar devijimet në të dyja drejtimet;

v) Menaxhimin të mbledhjes së kërkuar të të dhënave të matjes, për të kryer një menaxhim efikas të disbalancave dhe shlyerjes financiare.

Çmimi i energjisë balancuese që do të paguhet nga pala përgjegjëse, do të vendoset në koston reale që OST-ja merr për balancimin e sistemit, për

periudhën përkatëse, që mbulon rezervat balancuese dhe të energjisë.

2.2.7 Tarifat, termat dhe kushtet e aksesit në sistemin e transmetimit do të rregullohen nga ERE;

2.3 OSSH - si një Operator i Sistemit të Shpërndarjes

2.3.1 Shpërndarja është e ndarë me furnizimin, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë. OSSH-ja do të zotërojë, do të mbajë, do të zgjerojë dhe do të operojë sistemin e shpërndarjes.

2.3.2 OSSH-ja do të ofrojë shërbimin e lidhjes për të gjithë përdoruesit në sistemin e shpërndarjes në kushte jodiskriminuese.

2.3.3 Blerjen e humbjeve teknike dhe joteknike, bazuar në tregun e organizuar të ditës në avancë. Për periudhën tranzitore përpara se DAM-ja të fillojë aktivitetin, procedura e prokurimit është e lejuar për OSSH-në, sipas rregullave të miratuara nga ERE.

2.3.4 Tarifat, termat dhe kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes do të rregullohen nga ERE.

2.3.5 OSSH-ja do të jetë përgjegjëse për reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike në sistemin e shpërndarjes, bazuar në një studim që zhvillohet nga vetë OSSH-ja dhe aprovohet nga ERE. ERE siguron iniciativat e duhura për reduktimin e këtyre humbjeve.

2.3.6 OSSH-ja do të jetë një PPB.

2.4 Pala Përgjegjëse Balancuese (PPB)

2.4.1 Termat dhe kushtet për t'u bërë palë përgjegjëse balancuese (PPB) duhet të sigurojnë një trajtim jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe të publikohen.

2.4.2 Marrëveshja që do të lidhet nga OST sh.a. me PPB-në dhe ofruesi i Shërbimit të Balancimit duhet të jetë marrëveshje tip, e publikuar dhe e miratuar nga ERE, në mënyrë që të drejtat dhe detyrimet e palëve të jenë të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, si pjesë përbërëse/aneks i Rregullave të Balancimit.

2.4.3 Të gjitha subjektet juridike që zotërojnë njësi gjenerimi ose konsumi që janë të lidhura në rrjet dhe mbi një kapacitet të caktuar nga OST-ja dhe të miratuara nga ERE, janë të detyruara të jenë PPB.

2.4.4 Një subjekt juridik që zotëron njësi gjenerimi ose konsumi të lidhura në rrjet dhe një kapacitet të caktuar nga OST-ja dhe miratuar nga ERE, mund të aplikojë për të qenë një PPB.



2.4.5 Një tregtar që tregton në Shqipëri apo që furnizon energji ndërkuftare, është i detyruar për të qenë një PPB.

2.4.6 PPB-ja lejohet të skedulojë kontratat dypalëshe fizike për të blerë/shitur kapacitetet e shpërndara në SEE CAO.

2.4.7 Të gjitha kontratat e brendshme afatgjata OTC do të bazohen në një kontratë financiare, ku energjia elektrike fizike do të tregtohet në BSHE dhe çmimi i BSHE-së do të jetë çmimi i referencës për kontratën financiare. ERE do të krijojë kontrata standarde financiare OTC.

2.4.8 Të gjitha PPB-të do të jenë të detyruara për llogaritjen e disbalancave.

2.4.9 Një PPB mund të marrë përgjegjësinë e PPB-ve të tjera ose të njëjstëve të prodhimit dhe konsumit mbi një kapacitet të caktuar.

2.4.10 Të gjitha PPB-të janë përgjegjëse për parashikimin e gjenerimit dhe të konsumit.

2.4.11 Të gjitha PPB-të janë të detyruara të sigurojnë mbrojtjen e duhur nga zbulimet e informacionit konkurrues dhe të ndjeshëm kur është nevoja, si dhe gjithë informacioni të kërkohe për performacën sa më të suksesshme të OST-së dhe ERE, në kohën e duhur, të plotë dhe të sigurt.

2.4.12 Çdo njësi që ushtron aktivitetin e furnizuesit duhet të jetë një PPB.

## 2.5 Ofruesi i Shërbimeve të Balancimit

2.5.1 Një OSB është një PPB që ofron shërbimin e balancimit për OST-në.

2.5.2 Kushtet dhe termat për t'u bërë një OSB përcaktohen nga OST-ja dhe rregullohen në një marrëveshje ndërmjet OSB-së dhe OST-së.

## 3. RREGULLAT DHE DETYRIMET E MARRËVESHJES

3.1 Rregullat e Tregut kanë ndikim të caktuar ndërmjet palëve dhe bëhen të detyrueshme për çdo pjesëmarrës.

3.2 Secila palë duhet të marrë veprimet e duhura për të kryer detyrimet në përputhje dhe në pajtim me Rregullat e Tregut.

## 4. LLOJET E TREGUT

4.1 Marrëveshjet ndërkuftare nëpërmjet kontratave bilaterale

4.1.1 Pjesëmarrësit e tregut do të kryejnë marrëveshje ndërkuftare me çmime lirisht të negociueshme, bazuar në kapacitetet e blera dhe të nominuara në ankandet e hapura të organizuara nëpërmjet SEE CAO, për çdo periudhë kohe relevante, të barabartë me një orë.

4.1.2 Njoftimet e skedulimeve në OST, në lidhje me këto marrëveshje do të bëhen në ditën përpara dorëzimit. Detaje të kësaj pjese do të përshkruhen në Rregullat e Balancimit.

4.2 Tregu i organizuar i ditës në avancë për energjinë elektrike

4.2.1 Pjesëmarrësit e tregut të regjistruar për pjesëmarrjen në tregun e organizuar të ditës në avancë dhe të tregut brenda ditës do të përfundojnë marrëveshjet e energjisë elektrike në tregun e organizuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga operatori i tregut, siç janë të përcaktuara në kapitullin III të këtyre rregullave.

4.2.2 Pjesëmarrësit e tregut që kanë marrëveshje aktuale për blerjen e energjisë elektrike ose ndonjë kontratë tjetër për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike, në kohën kur këto rregulla do të hyjnë në fuqi, duhet të regjistrojnë kontratat e tyre me operatorin përkatës të rrejtit për pjesëmarrje në tregun e organizuar të ditës në avancë dhe në tregun brenda ditës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Operatori Shqiptar i Tregut, siç janë të përcaktuara në kapitullin III të këtyre rregullave.

4.2.3 Marrëveshjet do të përfundohen me çmim të pasqyruar të përcaktuara në çdo periudhë kohe nga Bursa Shqiptare, e licencuar për administrimin e tregut të organizuar.

4.2.4 OST-ja dhe OSSH-ja do të blejnë energji elektrike vetëm për mbulimin e humbjeve teknike dhe joteknike të humbura në rrejt për çdo periudhë të caktuar dërgimi në tregun e organizuar.

4.3 Tregu i organizuar brenda ditës për energjinë elektrike

4.3.1 Tregu, brenda ditës, është një treg për tregtimin e vazhdueshëm të produkteve brenda intervaleve kohore ku marrëveshjet janë lidhur automatikisht, kur porositë konkurruese janë të regjistruara në sistemin e tregimit. Transaksionet mund të kryhen një orë para ofertimit.

4.3.2 Pjesëmarrësit e tregut mund të kryejnë transaksionet energjetike në tregun brenda ditës, në përputhje me pikën 4.2.1 të këtyre rregullave.

4.3.3 Bursa duhet që në mënyrë të vazhdueshme, gjatë çdo dite të tregimit, të japë informacione për të gjitha ofertat dhe transaksionet që janë regjistruar në ETS në mënyrë anonime.

4.4 Marrëveshjet financiare nëpërmjet kontratave bilaterale.

4.4.1 Pjesëmarrësit e tregut do të lidhin kontrata financiare.



## Kapitulli III

**Rregullat për Tregun e Energjisë Elektrike të organizuar nga Bursa e Energjisë Elektrike****1. RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

1.1 Një palë përgjegjëse për balancimin (PPB) që dëshiron të marrë pjesë në Bursën e Energjisë në Shqipëri do të ketë të drejtë ta bëjë këtë nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

1.1.1 Është regjistruar në territorin e Shqipërisë ose të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian ose të një vendi që i përket Komunitetit të Energjisë;

1.1.2 Ka licencat përkatëse të lëshuara në territorin e së paku njërit prej vendeve të përmendura në 1.1.1 më sipër, duke bërë të mundur që ai të veprojë me kapacitetin e një gjeneruesi, furnizuesi, tregtari ose blerësi të energjisë elektrike;

1.1.3 Ka siguruar garancitë e kolateralit, siç kërkohet nga rregullat e zbatueshme të tregut, Marrëveshja e Pjesëmarrjes, Rregullat e Tregtimit, Rregullorja e Tregut të Një Dite në Avancë (DAM), Rregullorja e Tregut të Përditshëm, Rregullat e Sjelljes në Treg ose Rregullat e Zgjidhjes Përfundimtare.

1.2 Transaksionet e kryera nga pjesëmarrësit e tregut në tregun e organizuar të energjisë elektrike të ditës në avancë ose brenda ditës do të njoftohen automatikisht nëpërmjet platformës tregtare të gjitha PPB-të.

1.3 Transaksionet e përfunduara në tregun e organizuar do të njoftohen tek operatori i transmetimit nga Bursa e Energjisë deri në orën 14:00 të D-1.

1.4 Transaksionet në tregun e organizuar do të përfundohen për çdo interval kohor.

1.5 Transaksionet e përfunduara në tregun e organizuar do të përfaqësojnë një angazhim të fortë për PPB-të përkatëse për furnizimin me energji elektrike, në rastet e pranimit të ofertave për shitje ose detyrimin për pranimin e furnizimit me energji elektrike në rastet e pranimit të ofertave për blerje, në përputhje me transaksionet përkatëse.

1.6 Çdo transaksion do të jetë për një ditë ofertimi, një interval kohor dhe një zonë të caktuar.

1.7 Bursa e Energjisë mund të përfundojë një marrëveshje me pjesëmarrësin e tregut (*Market maker*), i cili do të marrë përgjegjësinë për parashikimin e likuidimit në ankandet e energjisë elektrike nëpërmjet pjesëmarrjes ditore, me një

parashikim të sasisë së blerjes dhe të shitjes së energjisë elektrike, në përputhje dhe në bazë të marrëveshjeve të përfunduara.

**2. QËLLIMI I OPERIMIT TË TREGUT TË ORGANIZUAR**

2.1 Të krijojë kushtet për një treg konkurrues duke lejuar vendosjen e çmimeve të drejta.

2.2 Të krijojë kushtet për një treg të orientuar drejt importit/eksportit që të promovojë përfitimet e konsumatorëve, ashtu si edhe të sektorit të energjisë elektrike së Shqipërisë, duke ofruar fleksibilitet për integrimin e tregut të energjisë elektrike dhe bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda ditës.

2.3 Të krijojë kushte për kalimin transparent dhe efikas të flukseve të fondeve dhe llogarive, duke përdorur bursën si *cunter party* për të gjitha veprimet në tregun e organizuar.

2.4 Të krijojë një strukturë brenda së cilës të zhvillohet konkurrenca si në tregun me shumicë ashtu edhe me pakicë, duke promovuar dhe duke siguruar ndryshimin e shpejtë të furnizuesit.

**3. PARIMET BAZË PËR FUNKSIONIMIN E TREGUT TË ORGANIZUAR**

3.1 Zbatimin e parimit të kostos marxhinale të ofertave në tregun e organizuar, si pjesë e mbikëqyrjes së tregut, me qëllim shmangien e abuzimit në treg.

3.2 Tregu i ditës në avancë dhe tregu brenda ditës si sfera ekskluzive për tregtimin fizik të energjisë elektrike në periudhën kohore të ditës në avancë.

3.3 Tregtimi i kontratave fizike bilaterale afatgjate lejohen në bazë të kapacitetit të ndarë përmes ankandëve të organizuara nga SEO CAO ose në bazë të kërkesave sipas marrëveshjeve dypalëshe afatgjate të regjistruara bazuar në kapitullin III, pika 1.1 të kësaj Rregulloreje.

3.4 Të gjitha format e tjera të tregtimit do të jenë vetëm financiare.

3.5 Marrëdhëniet kontraktuale janë skemat bazë që shërbejnë për menaxhimin e marrëdhënieve ndërmjet subjekteve të ndryshme në treg.

**4. KUSHTET DHE REGJISTRIMI NË TREGUN E ORGANIZUAR NGA PJESE-MARRËSIT**

4.1 Çdo PPB mund të bëhet pjesëmarrës i tregut i regjistruar nga Bursa e Energjisë, për pjesëmarrësit në tregun e organizuar dhe ka të drejtën të paraqesë oferta për shitjen dhe/ose blerjen e energjisë elektrike.



4.2 Një pjesëmarrës i tregut duhet të bëhet PPB.

4.3 Pjesëmarrësi i tregut duhet të paraqesë një kërkesë për të pranuar kushtet për pjesëmarrjen dhe regjistrimin në tregun e organizuar të energjisë elektrike, bazuar në marrëveshjen midis Bursës së Energjisë dhe pjesëmarrësve duke përfshirë të gjitha shtojcat.

4.4 Bursa e Energjisë duhet të krijojë një kontratë që të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet midis palëve.

4.5 Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Regjistrimit në Bursën e Energjisë dhe duke plotësuar çdo kërkesë në këtë marrëveshje, çdo pjesëmarrës ka të drejtë të marrë pjesë në çdo treg të organizuar që i përshtatet, në bazë të këtyre rregullave.

4.6 Bursa e Energjisë duhet të mbajë një regjistër të përditësuar me të gjithë pjesëmarrësit në tregun e organizuar.

4.7 Regjistri duhet të mbajë të paktën këto të dhëna për çdo pjesëmarrës:

- i) Emrin e plotë, zyra qendrore dhe përfaqësuesi i kompanisë;
- ii) Marrëveshjet e lidhura për pjesëmarrësit në tregun e ditës në avancë, numrin dhe datën;
- iii) Kodin e ID-së të pjesëmarrësve në tregun e organizuar;
- iv) Datën e regjistrimit, datën e tërheqjes, datën e pezullimit.

4.8 Pjesëmarrësit e tregut janë të detyruar të lajmërojnë menjëherë Bursën e Energjisë për çdo ndryshim që mund të ketë në të dhënat e regjistrimit.

#### Kapitulli IV

### Përfundimi, pezullimi dhe papajtueshmëria e pjesëmarrësve të tregut

#### 1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Kërkesa për tërheqje, pezullim dhe përfundim janë subjekt i rregullimit të ERE-s.

#### 2. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

2.1 Çdo pjesëmarrës mund të përfundojë Marrëveshjen e Pjesëmarrësve, duke dërguar një njoftim në përputhje me rregullat e Bursës së Energjisë.

2.2 Përfundimi i përkohshëm ose përfundimtar i marrëveshjes për shkak, për moskryerjen e detyrimeve të një nga pjesëmarrësit, janë të rregulluara në këto Rregulla Tregu.

#### 3. PEZULLIMI I TREGUT

3.1 Bursa e Energjisë mundet që në çdo kohë të pezullojë tregun në sistemin e tregtimit në qoftë se:

i) një problem që ka ndodhur, i cili mund të afektojë tregun në disa produkte ose pezullimin nëse është e nevojshme që këto probleme të parandalohen.

ii) kur veprimtaria e tregut shkel kërkesat e ligjit të aplikueshëm, Rregullat e Tregut në tërësinë e tyre ose Marrëveshjen e Pjesëmarrjes.

3.2 Sistemi i tregut duhet të rihapet në funksionin e tij të plotë sa më shpejt pas korrigjimit që çoi në pezullimin dhe Bursa e Energjisë Elektrike gjykon se Tregu mund të funksionoi në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe Rregullat e Tregut.

3.3 Bursa e Energjisë Elektrike duhet t'i jap pjesëmarrësve informacion për pezullimin e tregut dhe rihapjen menjëherë nëpërmjet faqes së *website* ose me mënyra të tjera komunikimi që Bursa e Energjisë Elektrike e quan eficiente, duke pasur parasysh rrethanat.

3.4 Bursa e Energjisë mund të pezullojë një pjesëmarrës në bazë të papajtueshmërisë, në përputhje me pikën 3 të këtij kapitulli.

#### 4. PAPAJTUESHMËRIA

4.1 Në qoftë se një pjesëmarrës dështon në përputhje me:

- i) Këto Rregulla Tregu;
- ii) Tregun dhe rregullat e qarta; ose
- iii) Ligjin e aplikueshëm dhe shkeljeve të tilla që ndikojnë ose do të ndikojnë në aftësinë e pjesëmarrësve, në përputhje me Rregullat e Tregut;
- iv) Kërkesa për përfitimin e tregtimit të tregut përshkruhen në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes;

v) Përfaqësimi i përshkruar në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes, me kusht që përfaqësimi në opinionin e Bursës Shqiptare të Energjisë është i pasaktë ose çorientues në aspektin material dhe nuk është rregulluar brenda 15 ditëve kalenderike, pas njoftimit me shkrim nga Bursa Shqiptare e Energjisë ose keqpërfaqësimi, dukshëm tregon që pjesëmarrësi ose klienti i pagesave është i papërshtatshëm për tregtimin e mëtejshëm.

4.2 Në rast papajtueshmërie, Bursa e Energjisë Elektrike do t'u dërgojë pjesëmarrësve një letër brenda 15 ditëve kalenderike:

i) Në rast se pas 15 ditëve pjesëmarrësi nuk merr masat e duhura për të korrigjuar shkaqet që kanë shkaktuar papajtueshmërinë. Bursa e



Energjisë Elektrike i dërgon një njoftim me shkrim pjesëmarrësit ose mund t'i dërgojë një paralajmërim ose ta pezulloj një pjesëmarrës nga tregu, me efekt të menjëhershëm. Gjatë pezullimit, pjesëmarrësi mund të kryejë marrëveshje vetëm nëse Bursa e Energjisë Elektrike jep aprovimin.

4.3 E drejta e Bursës së Energjisë Elektrike për të përfunduar Marrëveshjen për Pjesëmarrjen është e përcaktuar në Marrëveshjen e Tregtimit.

4.4 Përpara se të merret një vendim sipas klauzulës 4, pjesëmarrësi duhet t'i jepet një mundësi për t'iu kundërpërgjigjur dhe të japë një opinion mbi këto fakte që janë prezantuar nga Bursa e Energjisë Elektrike.

4.5 Bursa e Energjisë Elektrike ka në diskrecionin e vet të vendosë nëse vendimi do të bëhet publik ose jo dhe përfundimisht mënyrën si do të bëhet publik vendimi.

#### Kapitulli V

### Rregullat për kontratat dypalëshe

#### 1. TREGTIMET FIZIKE ME KONTRATA DYPALËSHE

1.1 Tregtimi i kontratave fizike dypalëshe lejohet vetëm në përputhje me kapacitetet e blera dhe të nominuara në ankandin e hapur të organizuar në SEE CAO.

#### 2. KONFIDENCIALITETI I KONTRATAVE TË INTERKONEKSIONIT TË MARRËVESHJEVE DYPALËSHE

2.1 Kontratat e shitblerjes së energjisë elektrike të interkoneksionit nga SEE CAO do të jenë të parregulluara, me kontekst të rregulluar nëpërmjet negociatave midis palëve, duke respektuar dispozitat e këtyre rregullave të tregut.

2.2 Palët kontraktuese, sasia dhe çmimi nga negociatat paraqesin informacion konfidencial. Për sa u përket parashikimeve të Rregullave të Tregut, Kodit të Rrjetit dhe rregulloreve përkatëse, kërkojnë se një informacion i tillë duhet të deklarohet në OST në intervale kohore për ditën në avancë dhe do të nominohen me gjitha marrëveshjet e përfunduara të ditës në avancë në tregun e organizuar.

#### 3. TREGTIMI FINANCIAR ME KONTRATA DYPALËSHE

3.1 Të gjitha tregtimet e brendshme OTC do të bazohen në kontrata financiare, ku energjia fizike do të tregtohet nga Bursa e Energjisë dhe çmimi i Bursës do të jetë çmimi referues për kontratat financiare.

3.2 ERE do të krijojë një marrëveshje standarde për kontratat financiare OTC.

#### Kapitulli VI

### Rregulla për periudhën tranzitore për tregtimet ndërkuftare nëpërmjet zonave të importit/eksportit

#### 1. TË PËRGJITHSHME

1.1 Si masa tranzitore përpara bashkimit të tregut, ankandi implicit i interkoneksionit me shtetet fqinje mund të organizohet nëpërmjet zonave të organizuara të importit dhe eksportit:

i) Zonat e importit dhe të eksportit mund të vendosen si zona në Bursën e Energjisë Elektrike;

ii) Zonat e importit dhe të eksportit duke lejuar njëherësh palët të tregtojnë me ndërkuftarët duke u bazuar në kapacitetet e disponueshme të interkoneksionit;

iii) Pjesëmarrësit për zonat e importit dhe të eksportit mund të jenë PPB, të cilët duhet të plotësojnë kriteret normale të jenë pjesëtare të tregtimit të ditës në avancë dhe të kenë leje të tregtojnë energji elektrike.

1.2 Detajet teknike për zonat e importit/eksportit përgatiten nga OST-ja dhe aprovohen nga ERE.

1.3 Marrëdhëniet tregtare dhe rregullat operacionale për zonat e import/eksportit janë nën qeverisjen e Bursës e rregulluar në aneksin e Marrëveshjes së Pjesëmarrjes.

1.4 Përdorimi i zonave të importit/eksportit nënkupton caktimin e ditës në avancë në kapacitetin e importit/eksportit nëpërmjet tregut, ku OST-ja vë në dispozicion, si pjesë e shpërndarjes së kapacitetit të tyre të përditshëm, një sasi minimumi (50%) të kapacitetit në dispozicion të tregut të organizuar. Sasia e vlerës minimale duhet të shikohet në baza mujore. Vlera minimale mund të ndryshohet në bazë të një vlerësimi që OST-ja përcakton dhe aprovohet nga ERE.

1.5 Qëllimi përfundimtar është integrimi i tregut të energjisë elektrike shqiptare me tregun evropian.

#### Kapitulli VII

### Rregullat për faturimin dhe pagesat

#### 1. TË PËRGJITHSHME:

1.1 Faturat do të dërgohen (një herë në ditë/muaj/vit) nga Bursa e Energjisë Elektrike te pjesëmarrësit e tregut dhe do të paguhet të gjitha paratë e përlogaritura për periudhën paraprake





tregtare në tregun e organizuar, sipas procedurave të detajuara në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në Bursën e Energjisë Elektrike.

1.2 Marrëdhëniet financiare për tregun e organizuar, për një periudhë të ndërmjetme, mund të trajtohen nga ofruesi i shërbimeve i Bursës së Energjisë.

### Kapitulli VIII Garancia

1. Bursa ka të drejtë t'i kërkojë pjesëmarrësve depozitim të një garancie, pas regjistrimit si pjesëmarrës i tregut në tregun e organizuar të energjisë elektrike.

2. Rregullat e detajuara për sa i përket garancisë, procesit për azhurnimin dhe për kontrollin janë të përcaktuara në shtojcën 5, Rregullat e Shlyerjeve dhe Pagesave.

### Kapitulli IX

#### Të dhënat dhe shkëmbimi i informacionit

1. Dispozita më të hollësishme për komunikimin e Bursës së Energjisë Elektrike dhe Pjesëmarrësve të Tregut janë të përcaktuara në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes në Bursën e Energjisë Elektrike. Kjo përfshin komunikimin në procesin e tenderimit, procesin e vendosjes së çmimit, si dhe të gjitha proceset e zgjidhjes së problemeve duke përfshirë edhe garancinë.

2. Komunikimi ndërmjet Bursës së Energjisë Elektrike dhe OST sh.a. do të hartohet në një procedurë operationale të detajuar të zhvilluar dhe të mirëmbajtur nga Bursa e Energjisë Elektrike dhe OST sh.a.

3. Çdo pjesëmarrës do të mbajë përgjegjësi për sigurimin dhe mirëmbajtjen (me kostot e pjesëmarrësve) e telefonit, linjës së internetit dhe çdo strukturë tjetër të komunikimit të kërkuar për të vepruar në tregun e organizuar.

### Kapitulli X

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

##### 1. PROCEDURAT E PËRGJITHSHME

1.1 Në rast mosmarrëveshje mes palëve lidhur me këto Rregulla Tregu, palët do të përpiqen me mirëbesim të zgjidhin mosmarrëveshjen lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Rregullat e Tregut.

1.2 Në rast se palët dështojnë në arritjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, ajo do të zgjidhet nga ERE sipas ligjit të aplikueshëm dhe rregullave.

##### 2. NJOFTIMI I MOSMARRËVESHJES

2.1 ERE do të pranojë çdo kërkesë me shkrim për zgjidhjen e një mosmarrëveshje që vjen direkt ose indirekt nga sjellja jotransparente dhe diskriminuese e palëve aktive në tregun e energjisë elektrike dhe që ajo autorizohet ta zgjidhë sipas ligjit për sektorin e energjisë elektrike.

##### 3. PROCESI I ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

3.1 ERE do t'i trajtojë dhe zgjidhë çështjet e ngritura në kërkesë ose në ankesë sipas rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

3.2 ERE rezervon të drejtën për të punësuar ekspertë të jashtëm të fushës për trajtimin e çështjeve të veçanta.

##### 4. MOSMARRËVESHJET LIDHUR ME LIKUIDIMET

4.1 Në rast mosmarrëveshje, çdo pjesëmarrës është i detyruar të mbulojë koston e vet. Në rastet kur një mosmarrëveshje refuzohet, pjesëmarrësi i tregut është i detyruar t'i paguajë çdo shpenzim të kryer nga Bursa Shqiptare e Energjisë.

4.2 Ankesat kundër përmbajtjes së raportit të transaksioneve pranohen vetëm në rastin e gabimeve që rezultojnë nga veprimet e Bursës së Energjisë Elektrike.

4.3 Çdo ankesë kundër përmbajtjes së raportit të transaksioneve duhet paraqitur jo më vonë se dy (2) ditë pas transaksioneve të përmbajtjes së raportit të transaksioneve nga Bursa e Energjisë Elektrike.

4.4 Bursa e Energjisë Elektrike do të njoftojë pjesëmarrësit e tregut mbi pranimin ose refuzimin e ankesës respektive jo më vonë se dy (2) ditë pas afatit të specifikuar në paragrafin e mësipërm. Në rastin e pranimit, Bursa e Energjisë Elektrike do t'i përcjellë një raport të transaksionit të rregulluar pjesëmarrësit të tregut.

4.5 Nëse gjatë intervalit kohor të specifikuar në paragrafin e mëparshëm, pjesëmarrësi i tregut të energjisë elektrike nuk paraqet asnjë apelim ndaj raportit të transaksionit të marrë prej tij, atëherë ato konsiderohen si të pranuar.

4.6 Asnjë apelim i paraqitur nuk e shkarkon pjesëmarrësin përkatës të tregut të energjisë elektrike nga përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga transaksionet e diskutueshme.



Kapitulli XI  
Masat tranzitore

1. Këto rregulla tregu hyjnë në fuqi me bërjen të zbatueshme të Modelit të Tregut të Organizuar në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të

Energjisë, siç parashikohet në pikën 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016 dhe do të publikohen në faqen zyrtare.

2. Rruga e përcaktuar për secilën fazë:

Hapat	Veprimet
Faza 1 Janar 2017	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapja e BSHE-së</li> <li>- Zbatim fillestar të zonave import/eksport (ose treg i plotë me marrëveshje bashkimi me të paktën një vend)</li> <li>- OST-ja të blejë humbjet nga BSHE-ja</li> <li>- OSHEE-ja të blejë humbjet në një treg të parregulluar</li> <li>- Klientët në HV në një treg të parregulluar</li> <li>- Klientët në 35 kV në një treg të parregulluar.</li> <li>- Klientët në 20 kV në një treg të parregulluar.</li> <li>- Furnizuesit e kualifikuar për tensionin e rrjetit të lartë - rreth 1 Twh.</li> <li>- Volumet e mbetura nga KESH-i, pas plotësimit të kërkesës nga konsumatorët tariforë – rreth 250 gwh</li> <li>- Procedura të pavarura (si: Devolli, Kurumi, Fani) – rreth 405 gwh</li> <li>- Importet nëpërmjet tregtarëve dhe/ose zonave të import/eksportit + tregtarë të tjerë të kualifikuar – rreth 1 gwh</li> </ul>
Faza 2 - Hapja e tregut Janar 2018	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapja e tregut bazuar në mekanizmat balancues (BM)/Tregu Balancues i Energjisë Elektrike</li> <li>- BM dhe BSHE në përputhje të plotë me rregullat</li> <li>- Sistemi i disbalancave në përputhje me BSHE</li> <li>- CFD për 50% të volumit të tarifave të rregulluara</li> <li>- Furnizuesit e kualifikuar për rrjetin e tensionit të lartë – rreth 1 Twh</li> <li>- Prodhuesit e pavarur (p.sh., Devoll Hydropower, Kurumi, Fani) - rreth 1005 gwh</li> <li>- Importet nëpërmjet tregtarëve dhe/ose zonave të importit/eksportit + tregtarë të tjerë të kualifikuar – rreth 1 gwh</li> <li>- Volumet CFD (nga KESH) – rreth 1.75 gwh</li> <li>- Klientët në 10.6 kV në tregun e parregulluar</li> <li>- Klientët në 0.4 kV në tregun e parregulluar</li> </ul>
Faza 3 - Zbatimi i plotë i tregut Janar 2019	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hapja e Bursës Shqiptare Energjetike nëpërmjet platformës IDM</li> <li>- Marrëveshjet tregtare të bashkëpunimit me shtetet e EU-së që e kanë këtë të drejtë, qoftë nëpërmjet zonave të importit/eksportit ose bashkëpunimeve me vendet e shteteve jashtë EU-së</li> <li>- CFD për 70% të volumit të tarifave të rregulluara</li> <li>- Furnizuesit e kualifikuar për rrjetin e tensionit të lartë – rreth 1 Twh</li> <li>- Prodhuesit e pavarur (p.sh., Devoll Hydropower, Kurumi, Fani) - rreth 1005 gwh</li> <li>- Volumet e mbetura nga KESH-i, pas plotësimit të kërkesës nga konsumatorët tariforë – rreth 600 gwh</li> <li>- Importet nëpërmjet tregtarëve dhe/ose zonave të import/eksportit + tregtarë të tjerë të kualifikuar – rreth 1 gwh</li> <li>- Volumet CFD (nga KESH) – rreth 1.75 gwh</li> <li>- Klientët në 0.4 kV - Bizneset, jobuxhetorët në tregun e parregulluar</li> <li>- Klientët jashtë Shqipërisë në tregun e parregulluar</li> </ul>
Faza 4 - Zbatimi i plotë i tregut Janar 1 <sup>st</sup> 2020	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëveshjet tregtare të bashkëpunimit me shtetet e EU-së që e kanë këtë të drejtë</li> <li>- (100%) e tregut me pakicë bazuar në çmime tregu (CFD e hequra) Mund të ndahen në dy hapa nëse kërkohet politikisht</li> </ul>

ANEKS I  
PËRKUFIZIMET

Këto përkufizime janë në fuqi për të dyja këto dokumente: Rregullat e Tregut dhe për Marrëveshjen e Pjesëmarrësit.

<b>Mbajtësi i llogarisë</b>	Do të thotë një anëtar që mban një ose më shumë llogari pagesash për regjistrimin e transaksioneve të pagesave.
<b>Marrëveshje kolaterali të grupuar</b>	Do të thotë një marrëveshje ku një anëtar, i cili është anëtar i më shumë se një Tregu Grupimi Kolateralësh bëhet subjekt i grupimeve të kërkesave të kolateralëve dhe posteve të kolateralëve mbi një bazë grupimi.
<b>Ligji në fuqi</b>	Do të thotë ligjet dhe rregulloret në fuqi nën çfarëdo juridiksioni në fuqi, përfshirë çdo urdhër apo gjykim apo vendim tjetër i çdo gjykate kopetente apo organizmi rregullator, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tilla në vendin dhe kohën përkatëse.
<b>Ankand</b>	Nënkupton mekanizmin e përdorur në tregun e ankandit për dorëzimin e porosive dhe llogaritjen e vëllimit dhe të çmimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe marrëveshjen për shitblerje, brenda një periudhe të caktuar të ofrimit.
<b>Pala përgjegjëse për disbalancën</b>	Do të thotë, një pjesëmarrës që ka hyrë në marrëveshje me një operator sistemi transmetimi dhe që balancon disbalancën e vet të energjisë elektrike, përmes Tregut kombëtar rregullator të energjisë elektrike apo ofrimit të hapur të energjisë elektrike balancuese nga ana e operatorit të sistemit të transmetimit.
<b>Garancia bankare</b>	Do të thotë një garanci, sipas kërkesës, ofruar por dhe pranuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lidhur me detyrimet e një mbajtësi llogarie kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
<b>Ditë bankare</b>	Do të thotë një ditë në të cilën bankat në Shqipëri kryejnë aktivitete bankare.
<b>Kolateral bazë</b>	Do të thotë kolaterali për t'u dërguar nga ose në emër të një pjesëmarrësi apo klienti që bën shlyerjet, me qëllim që të mbulojë rreziqet e brenda natës të Bursës Shqiptare të Energjisë.
<b>Kërkesë për kolateral bazë</b>	Do të thotë kërkesë e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për Kolateral nga ana e pjesëmarrësit apo klientit të shlyerjeve, në përputhje me nenin 8.2 të Termave të përgjithshëm të Rregullave për shlyerjet.
<b>Ofertë</b>	Do të thotë porosia për të blerë.
<b>Zonë e ofertës</b>	Do të thotë një nën- e Zonës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike e përcaktuar nga ana e OST-ve. Zona e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike është e ndarë në zona ofertash me qëllim që të menaxhojnë kufizimet e transmetimit. Pjesëmarrësit duhet të bëjnë Porosi në përputhje me zonën ku prodhimi ose konsumi i tyre është i lidhur fizikisht në rrjet, duke përcaktuar në këtë mënyrë zonën e ofertimit për secilën porosi.
<b>Blerës</b>	Do të thotë pala që bie dakord të blejë energjinë elektrike sipas çdo transaksioni.
<b>Llogari <i>cash</i></b>	Do të thotë llogari <i>cash</i> garancie apo llogari <i>cash</i> jogarancie.
<b>Kolateral <i>cash</i></b>	Do të thotë kolateral në formën e depozitave <i>cash</i> në një llogari <i>cash</i> garancie.
<b>Shlyerje <i>cash</i></b>	Do të thotë shlyerje <i>cash</i> për t'u kryer ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe anëtarëve.



<b>Sasi e shlyerjes <i>cash</i></b>	Do të thotë sasia neto <i>cash</i> e llogaritur në përputhje me nenin 10.1.1 të Termave të përgjithshëm të Rregullave të pagesave.
<b>Pagesë</b>	Do të thotë një proces pagese nëpërmjet zëvendësimit ku Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike hyn në një Transaksion si një kundërpalë qendrore dhe bëhet në këtë mënyrë kundërpalë për anëtarët.
<b>Llogari pagese</b>	Do të thotë një llogari(të) anëtar i me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për regjistrimin e transaksioneve.
<b>Ditë pagese</b>	Do të thotë ditët bankare në të cilat një shlyerje monetare është kryer.
<b>Rregullat e pagesës</b>	Do të thotë rregullat e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për shlyerjen e transaksioneve të rregulluara në shtojcën 4 të Rregullave të tregtimit.
<b>Kolateral</b>	Do të thotë marrëveshjet e pranuar shprehimisht nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe të njohura nëpërmjet Rregullave të pagesave si një garanci për detyrimet e një anëtar i ndaj Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, duke përfshirë depozitat në <i>cash</i> në një llogari garancie <i>cash</i> dhe garanci mbi bazën e kërkesës, si dhe çdo instrument garancie të pranuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nën një Marrëveshje Kolaterali të grupuar me anëtarin.
<b>Treg i kolateralit të grupuar</b>	Do të thotë çdo treg në të cilin Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike vepron si kundërpalë qendrore dhe i cili është i ligjshëm për një Marrëveshje të Kolateralit të grupuar, ashtu siç njoftohet nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
<b>Thirrje për kolateral</b>	Do të thotë thirrje e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për Kolateral nga një pjesëmarrës apo klient pagese, në përputhje me Rregullat e pagesave.
<b>Valuta e kolateralit</b>	Do të thotë, lidhur me një anëtar i cili është duke tregtuar në valuta të shumta tregtie ose që është palë në një marrëveshje kolaterali të grupuar, monedhë e tillë është pranuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, si monedha përkatëse për llogaritjen e thirrjeve të saj për kolateral.
<b>Njësi konsumi</b>	Është një burim i cili merr energji elektrike për përdorimin e tij vetjak; këtu operatorët e sistemit të transmetimit apo operatorët e sistemit të shpërndarjes nuk konsiderohen të jenë njësi konsumatore.
<b>Person kontakti</b>	Do të thotë një person fizik i emëruar si person kontaktues, në përputhje me Rregullat tregtare në lidhje me tregtinë.
<b>Kundërpalë</b>	Do të thotë një pjesëmarrës dhe një klient pagese që hyn në një transaksion dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, që vepron si një kundërpalë për të gjithë transaksionet.
<b>Shkëputja apo shkëputja e tregjeve</b>	Një situatë në të cilën procesi i bashkimit të çmimit ( <i>Price Coupling</i> ) është pezulluar dhe/ose anuluar.
<b>Shpërndarja</b>	Do të thotë sasia e energjisë elektrike që duhet të shpërndahet në lidhje me shlyerjen e transaksioneve.
<b>Dita e shpërndarjes</b>	Do të thotë një seri e vazhdueshme e orëve të shpërndarjes e cila fillon në orët 00:00 CET në një ditë kalendarike dhe mbaron në orët 24:00 CET në të njëjtën ditë kalendarike, në mënyrë që fillimi i një dite shpërndarjeje të përkojë me kohën në fund të ditës së mëparshme të shpërndarjes.
<b>Ora e shpërndarjes</b>	Një orë brenda një dite shpërndarjeje.
<b>Periudha e shpërndarjes</b>	Një periudhë që konsiston në një ose më shumë orë shpërndarjeje.
<b>Marxhini i devijimit</b>	Do të thotë marxhinat e çmimit për t'u zbritur nga apo për t'u shtuar në rangun respektiv, kur merremi me gabimet e tregtimit, ashtu si më gjerësisht është përcaktuar në Rregullat e Tregut.



<b>Zona e tregtimit</b>	Do të thotë e njëjta me zonën e ofertimit, por ky term është përdorur referuar Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.
<b>Çmimi i Tregut të Një Dite më Parë</b>	Do të thotë çmimi i përcaktuar për sa i përket secilës periudhë shpërndarjeje, si rezultat i llogaritjes së çmimit të tregut të Një dite më parë.
<b>Tregu i Një Dite më Parë</b>	Ka kuptimin e përshkruar në kapitullin 2, neni 4.2, të këtyre Rregullave të Tregut.
<b>Rregulloret e tregut të Një Dite më Parë</b>	Do të thotë aneksi i Marrëveshjes së Pjesëmarrjes, “Tregu i një dite më parë”.
<b>Llogaritja e çmimit të Tregut të Një Dite më Parë</b>	Do të thotë metodologjia për përcaktimin e çmimit të Tregut Shqiptar të një Dite më Parë dhe volumin e duhur të energjisë, ashtu siç është përcaktuar në rregulloret e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.
<b>Zona e shkëmbimit të energjisë elektrike</b>	Do të thotë zonat gjeografike të Tregut të Një Dite më Parë, në të cilat Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka të drejtë të organizojë Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe nëpërmjet marrëveshjeve me OST-të ka alokuar kapacitetet transmetuese në fazën e planifikimit, në mënyrë që të ketë të drejtë për të transferuar energjinë elektrike ndërmjet këtyre zonave.
<b>Volumi i energjisë</b>	Do të thotë numri i njësisive të energjisë për t’u shpërndarë gjatë Periudhës(ave) relevante të Shpërndarjes dhe do të, nëse nuk specifikohet ndryshe, konsiderohet e shprehur në mw. Për produktet që shtrihen në disa periudha dorëzimi, vëllimi i energjisë përfaqëson një numër të barabartë dhe konstant gjatë secilës periudhë dorëzimi në fuqi.
<b>Kufiri i volumit të energjisë</b>	Do të thotë sasia maksimale e volumit të energjisë të aplikueshëm për një porosi, ku ky përcaktim është i i aplikueshëm.
<b>ETS</b>	Do të thotë një sistem(e) për tregtinë elektronike peroidikisht.
<b>EU</b>	Do të thotë Bashkimi Evropian, ashtu siç ekziston periodikisht.
<b>Euro apo EUR</b>	Do të thotë një valutë e ligjshme e atyre shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që kanë adaptuar valutën e veçantë, në përputhje me një traktat që themelon Bashkimin Evropian, ashtu siç është ndryshuar nga traktati mbi Bashkimin Evropian.
<b>Programi i tarifës</b>	Do të thotë ashtu siç aplikohet shtojca e tregtimit e specifikuar me këtë cilësi në tabelën e përmbajtjes së kushteve të përgjithshme të Rregullave të tregtimit.
<b>Ngjarje e forcës madhore</b>	Do të thotë ndodhja e një ngjarje, e cila: i) është jashtë kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur; dhe ii) e cila e pengon palën nga kryerja e një ose më shumë prej detyrimeve të saj sipas Rregullave të tregtimit apo Rregullave të Pagesave; dhe iii) raste të tilla apo ndikimi i ngjarjeve të tilla në performancën e palës ndaj detyrimit(ve) përkatës(e), në mënyrë të arsyeshme nuk ka qenë e mundur të kapërcehet ose pengohet nga pala e brendakohës së lejuar për kryerjen e detyrimit(ve) përkatës(e). Për qëllimet e këtij përkufizimi, veprimet e Perëndisë apo të armikut publik, aktet e një autoriteti civil ose ushtarak, akte terroriste apo veprime të tjera kriminale, trazirat civile, embargot, zjarri, përmytjet, mosmarrëveshjet e punës, mungesa ose kufizimi i kapaciteteve kompjuterike ose të përpunimit të të dhënave, ose mungesa ose kufizimi i sistemet të shlyerjeve, ose i sistemeve të transferimit të bankës, normalisht do të konsiderohet të jetë jashtë kontrollit të arsyeshëm të një pale, me kusht që pala ka vepruar me maturi dhe kujdesin që mund të pritët prej kësaj pale.



<b>Mbyllja e portës</b>	Do të thotë koha para së cilës në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë Porositë duhet të merren nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, me qëllim që të jenë valide, ashtu siç përcaktohet në Programin e Tregtisë.
<b>Njësi gjeneruese</b>	Është një strukturë e vetme gjenerimi energjie elektrike, ose më vete ose së bashku me struktura të tjera gjenerimi, që përbëjnë pjesë të një njësie prodhimi.
<b>Gw (dhe gwh)</b>	Do të thotë një bilion (1,000,000,000) <i>watt</i> dhe “gwh” do të thotë energjia e gjeneruar apo e konsumuar me një përqindje konstante e një (1) gw për kohëzgjatjen e një (1) ore.
<b>Porosi e orare</b>	Do të thotë një porosi në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë, ku volumet e blerjes apo të shitjes të shteteve pjesëmarrëse në nivele të ndryshme çmimesh në një komplet hapash çmimi, të përcaktuar për një orë specifike shpërndarjeje. Secila palë e çmimit dhe volumit trajtohet si një pikë në kurbën e porosisë (kërkesës) me interpolim linear ndërmjet secilës palë.
<b>Kw (dhe kwh)</b>	Do të thotë një mijë (1,000) <i>watt</i> dhe “kwh” do të thotë energjia e gjeneruar apo e konsumuar me një përqindje konstante prej një (1) kw për kohëzgjatjen prej një (1) orë.
<b>Periudha e mirëmbajtjes</b>	Do të thotë një periudhë brenda orëve të tregtimit gjatë së cilës ETS është i mbyllur për qëllime mirëmbajtjeje, ashtu siç mund të jetë përcaktuar në programin e tregtimit apo nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim nga operatori i tregut.
<b>Rregullat e drejtimit të tregut</b>	Do të thotë shtojca e specifikuar si e tillë në tabelën e përmbajtjes së Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në fuqi.
<b>Operatori i tregut</b>	Do të thotë bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në lidhje me Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë.
<b>Monitorimi i tregut</b>	Do të thotë njësi organizative përgjegjëse për monitorimin e përputhshmërisë me Rregullat e Drejtimit (Sjelljes) së Tregut në emër të operatorit të tregut
<b>Ngjarja e mospajtueshmërisë substanciale</b>	Ka kuptimin e përkthuar për të në Marrëveshjen e Pjesëmarrësit, Rregullat e tregtimit - Termat e përgjithshëm
<b>Kufiri maksimal i çmimit Anëtar</b>	Kufiri teknik i sipërm i çmimeve në vargun e çmimeve. Do të thotë një njësi ekonomike që ka hyrë në një marrëveshje të vlefshme për anëtarësim të efektshëm për tregtimin në tregjet shqiptare të Një dite më parë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
<b>Kufiri minimal i çmimit TTS</b>	Kufiri teknik i poshtëm i çmimeve në vargun e çmimeve. Do të thotë një sistem i operatorit të tregut, i bazuar në telefoninë dhe zërin për regjistrimin e porosive.
<b>Mw (dhe mwh)</b>	Do të thotë një milionë (1,000,000) <i>watt</i> dhe “mwh” do të thotë energjia e gjeneruar apo e konsumuar në një përqindje konstante e një (1) mw për kohëzgjatjen e një (1) orë.
<b>Ngjarja e mospajtueshmërisë Llogari jogarancie</b>	Ka kuptimin e përcaktuar për të në këto Rregulla të Tregut. Do të thotë llogari e krijuar nga pjesëmarrësi në një depozitë bankare të aprovuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, e cila do të aplikohet në lidhje me shlyerjet <i>cash</i> kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
<b>Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, Bashkim i çmimeve EVP</b>	Platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës dite. Bashkimi i çmimeve prej dhe ndërmjet bursave të caktuara të energjisë



	elektrike dhe operatorë të sistemit të transmetimit të rajonit EVP, rajonit nordik/balltik dhe UK në përputhje me termat e Marrëveshjes së Operacioneve të Një Dite më Parë të EVP (Evropa veriperëndimore – <i>shën. i përkth.</i> ).
<b>Ofertë</b>	Do të thotë një porosi për të shitur.
<b>Garanci mbi bazën e kërkesës</b>	Do të thotë një garanci në favor të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për një sasi të parapërcaktuar detyrimesh siguroese të një pjesëmarrësi kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
<b>Balancë e hapur</b>	Do të thotë një pozicion neto në secilën seri produkti të regjistruara në një llogari pagese, i cili mundet të jetë ose pozitiv ose negativ. Një vlerë pozitive identifikon një pozicion blerjesh në atë produkt, ndërsa një vlerë negative identifikon një pozicion shitjesh.
<b>Porosi</b>	Do të thotë një kërkesë apo një ofertë për një produkt apo disa produkte që një pjesëmarrës në mënyrë valide regjistron në ETS.
<b>Çmimi i porosisë</b>	Do të thotë çmimi të cilin Blerësi ka dëshirë të paguajë apo Shitësi ka dëshirë të shesë në lidhje me një Porosi, sipas rastit.
<b>Kufiri i çmimit të porosisë</b>	Do të thotë kufiri maksimal apo minimal për Çmimin e Porosisë.
<b>Tipi i porosisë</b>	Do të thotë metoda nëpërmjet së cilës një porosi do të ekzekutohet, p.sh., plotësoni ose të gjitha ose asgjë sipas rastit në lidhje me secilin treg.
<b>Marrëveshje anëtar</b>	Do të thotë një marrëveshje ndërmjet një pjesëmarrësi dhe Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, Marrëveshje Pjesëmarrjeje, që i dhuron pjesëmarrësit akses në tregtinë e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.
<b>Palë</b>	Do të thotë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ose një anëtar.
<b>Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë</b>	Do të thotë tregu(gjet) të operuara nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike për tregtimin e kontratave të energjisë elektrike me shpërndarje fizike.
<b>Llogari <i>cash</i> garancie</b>	Do të thotë një llogari garancie e krijuar nga një pjesëmarrës në një Bankë Shlyerjesh e aprovuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe e cila do të aplikohet në lidhje me shlyerjet <i>cash</i> dhe depozitat <i>cash</i> të kolateralit kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
<b>Zona e çmimit</b>	Do të thotë çdo dy apo më shumë zona ofertimi që kanë të njëjtën zonë çmimi të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë në një orë specifike.
<b>Bashkimi i çmimit</b>	Do të thotë mekanizmi me anë të të cilit, me qëllim maksimizimin e pasurisë publike, çmimet e përcaktuara nga tregu dhe pozicionet neto për tregje të ndryshme të energjisë elektrike të një dite më parë janë përcaktuar në një hap të vetëm, duke iu referuar ATC-së fizike orare dhe/ose kapaciteteve të bazuara në flukset.
<b>Gama e çmimeve</b>	Do të thotë një spektër çmimi për një ankand, i përcaktuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në përputhje me Marrëveshjen e Pjesëmarrësit të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.
<b>Hapi i çmimit</b>	Do të thotë një çift i çmimit të kërkesës dhe vlerave të volumit të energjisë mbi një kurbë të kërkesës në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë ndërmjet (dhe përfshirë) kufijtë e sipërm dhe të poshtëm të çmimit të kërkesës.
<b>Produkti</b>	Do të thotë çdo produkt i listuar në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe referencat për një produkt të vetëm do të thotë, të gjitha seritë e produktit të cilat janë klasifikuar si të të njëjtit lloj, në përputhje me specifikimet e produktit.
<b>Njësia e produktit</b>	Do të thotë një strukturë për prodhimin e energjisë elektrike i përbërë nga më shumë se një njësi gjenerimi.
<b>Organ rregullator</b>	Do të thotë çdo departament kompetent, agjenci, organizatë shtetërore ose



	të tjera nëndarje politike që kanë juridiksion mbi subjektin përkatës në lidhje me çështjen përkatëse.
<b>REMIT</b>	Do të thotë rregullore (EU), nr. 1227/2011, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian, mbi integritetin dhe transparencën e Tregut me shumicë të Energjisë Elektrike, e datës 25 tetor 2011.
<b>Rihapja</b>	Kur, për shkak të situatave specifike, Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë është rihapur për dorëzimin e porosive pas 12:00.
<b>Autorizime të kërkuara</b>	Do të thotë që të gjitha licencat qeveritare dhe të tjera, autorizimet, lejet, marrëveshjet, kontratat dhe miratimet e tjera (nëse ka), të cilat janë kërkuar për të mundësuar një palë për të përmbushur detyrimet e tij sipas Rregullave të tregtimit dhe/ose Rregullat e pagesave në përputhje me ligjin në fuqi.
<b>Shitës</b>	Do të thotë pala që ka rënë dakord për të shitur energji elektrike në bazë të çdo transaksioni individual.
<b>Shlyerja</b>	Do të thotë procesi i cili nëpërmjet tregtisë në tregjet, kryhet nëpërmjet transaksioneve në <i>cash</i> .
<b>Bankë e shlyerjeve</b>	Do të thotë një bankë e cila është e autorizuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike për të ekzekutuar shlyerjet <i>cash</i> dhe për të mbajtur llogaritë <i>cash</i> të garancive apo llogaritë e jogarancive në emër të një pjesëmarrësi apo klienti pagesash. Një listë e bankave të shlyerjeve është në dispozicion nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.
<b>Ditë(t) shlyerjesh</b>	Do të thotë dita(t) e specifikuar në specifikimet e produktit kur shlyerja <i>cash</i> përkatëse do të kryhet për një seri produkti.
<b>Mirëqenia Sociale</b>	Do të thotë një përcaktim sasiorë për të vlerësuar implikimet e mundshme të opsioneve të politikave alternative, duke përfshirë një konsiderim të përfitimit apo kostos shtesë ekonomike, të përcaktuar si shuma e përfitimeve shtesë individuale dhe shpenzimet të cilat priten të akumulohen për shkak të zbatimit të opsioneve përkatëse të politikave në krahasim me situatën aktuale.
<b>Shpërndarje</b>	Do të thotë rangun i çmimit siç është përcaktuar nga çmimi më i mirë i kërkesës dhe ofertës në seritë e produktit të regjistruara në ETS, në çdo pikë në kohë.
<b>Madhësia e impulsit</b>	Do të thotë madhësia e impulsit e specifikuar në specifikimet e produktit. Çmimi i një porosie i vendosur në një sistem tregtie duhet të jetë i ndarshëm nga madhësia e impulsit, për valuta tregtimi të ndryshme mund të aplikohen madhësi impulsesh të ndryshme.
<b>Porcioni i tregtimit</b>	Do të thotë volum minimal i secilit produkt, ashtu siç specifikohet për seritë përkatëse të produktit. Volumi i secilës porosi i vendosur në sistemet e tregtisë duhet të jetë i ndarshëm në porcione të plota tregtimi.
<b>Tregtar</b>	Do të thotë një person fizik i autorizuar për të drejtuar tregtinë në emër të pjesëmarrësit, në përputhje me rregullat e tregtisë në fuqi.
<b>Tregti</b>	Do të thotë një proces i hyrjes në një transaksion në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë duke prezantuar porosi.
<b>Përgjegjësi për tregtinë</b>	Do të thotë një person i emëruar nga pjesëmarrësi për të qenë përgjegjës për tregtinë e pjesëmarrësit dhe për të vepruar si një person kontakti për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, për sa i përket tregtisë në tregjet shqiptare të ditës më parë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.
<b>Valuta e tregtisë</b>	Do të thotë një ose disa valuta të aprovuara nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në të cilën një pjesëmarrës apo një klient pagese dëshiron të kryejë porosi dhe tregti.





<b>Dita(ët) e tregtisë</b>	Do të thotë dita(ët) kalendarike kur një treg është i hapur për tregti.
<b>Tryeza e tregtisë</b>	Do të thotë personeli që vepron në ETS në Tregun Shqiptar të Ditës më Parë.
<b>Gabimi i tregtisë</b>	Do të thotë çdo veprim apo joveprim që rezulton në një transaksion të gabuar.
<b>Tarifa e tregtisë</b>	Do të thotë tarifa vjetore dhe tarifa që varet nga vëllimi që paguhet për tregtinë nëpër tregje.
<b>Orët e tregtisë</b>	Do të thotë periudha e kohës gjatë një dite tregtimi kur seritë përkatëse të produktit janë të hapura për tregti, ashtu siç vendoset me tej nga operatori i tregut, siç përcaktohet në programin përkatës të tregtimit.
<b>Palë tregtimi</b>	Do të thotë mbajtësi i një llogarie shlyerjesh në emër të së cilit hyn transaksioni.
<b>Portofol tregtimi</b>	Do të thotë një set transaksionesh që kanë hyrë te pjesëmarrësi dhe i cili është caktuar për llogarinë e tij të lidhur të shlyerjeve. Portofolat tregtarë funksionojnë dhe mirëmbahen nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.
<b>Çmimi i tregtimit</b>	Do të thotë çmimi i dorëzimit i cili është kontraktuar në një transaksion.
<b>Rregullat e tregtimit</b>	Do të thotë rregullat e nxjerra nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në çdo kohë për të drejtuar tregtinë dhe tregjet shqiptare të ditës më parë, përfshirë shtojcat e tregtisë dhe marrëveshjet e tregtisë, si pjesë e Marrëveshjes së Pjesëmarrësit.
<b>Sistem tregtimi</b>	Do të thotë ETS, siç operohet nga operatori i tregut në vazhdimësi.
<b>Transaksion</b>	Do të thotë një marrëveshje ndërmjet dy palëve për të konkluduar një apo disa kontrata në një apo disa produkte, pavarësisht nga forma apo formati i përdorur për të mundësuar këtë marrëveshje.
<b>Konfirmim i transaksionit</b>	Do të thotë konfirmimi i një transaksioni nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike përmes sistemit të tregtisë.
<b>Informacion i transaksionit</b>	Do të thotë informacioni i grumbulluar [anonim] informacion mbi porositë dhe transaksionet e regjistruara, të kërkuara apo të raportuara në sistemin e tregtisë. Në çfarëdo formati, përfshirë të drejtat e autorit, sekretet e tregtisë, të drejtat e databazave dhe të tjera të drejta pronësie, që i takojnë një informacioni të tillë. Pavarësisht nga përgjithësimi i sa më sipër, termi informacion i transaksionit do të konsiderohet që përfshin çmimet ditore përfundimtare dhe të tjera indekse, vëllime, balanca neto të pozicioneve të hapura dhe vlerat historike që rrjedhin nga porositë dhe transaksionet.
<b>Koha e transaksionit</b>	Do të thotë një pikë në kohë ku Shitësi dhe Blerësi hyjnë në një Transaksion ligjërish të detyrueshëm.
<b>Vëllimi i transaksionit</b>	Do të thotë vëllimi i një Transaksioni të vetëm, i shprehur në njësinë e zbatueshme të vëllimit të Produktit. (e.g. në mw).
<b>Operator i sistemit të transmetimit ose OST</b>	Do të thotë një subjekt përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit.
<b>Tw (dhe Twh)</b>	Do të thotë një trilion (1,000,000,000,000) <i>watt</i> dhe “Twh” do të thotë energjia e gjeneruar apo e konsumuar në një përqindje konstante e një (1) Tw për kohëzgjatjen e një (1) ore.
<b>Taksa e vlerës së shtuar ose TVSH</b>	Do të thotë çdo taksë e vlerës së shtuar apo tatim analog me to, të vendosura nën çdo juridiksion përkatës apo ndonjë zëvendësues, apo taksë tjetër, të grumbulluara duke iu referuar vlerës së shtuar në një transaksion, por duke përjashtuar çdo interes të pagesave të vonuara statutores apo gjobave.
<b>W ose watt</b>	Do të thotë <i>watt</i> (w), një njësi energjie e barabartë me një (1) xhaul (J) të energjisë për sekondë, sipas SI (Sistemit Ndërkombëtar të Njësive), sistemi i njësive të matjes.



**RREGULLAT  
E TREGTIMIT  
RREGULLAT E TREGTIMIT - TERMAT E  
PËRGJITHSHËM  
BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Shtojcat e tregtimit

1. Specifikimet e Produktit
2. Tregu i një dite më parë
3. Rregullat e Tregtimit Intrady (Brenda ditës)
4. Rregullat e administrimit të Tregut
5. Rregullat e shlyerjeve dhe të Pagesave
6. Rregullat Specifike për Tregtimin e zonave

Import-Eksport

1. HYRJE

1.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike është e licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për të organizuar dhe operuar tregun e ditës më parë për energjinë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

1.2 Tregu Shqiptar i Ditës më Parë për energjinë elektrike krijon mundësinë e tregtisë së ditës më parë nëpërmjet një ankandit, në lidhje me secilën ditë të shpërndarjes, në bazë të të gjitha ofertave të vëllimit dhe ofertave të çmimit nga ana e anëtarëve, të marra para mbylljes së ankandit përkatës. Dispozita të mëtejshme që rregullojnë tregtimin në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë, janë përcaktuar në Rregulloren e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.

1.3 Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë ofron produkte të tilla për tregti, siç janë përcaktuar në specifikimet e produktit (shtojca 1).

1.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ofron pagesa të transaksioneve në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë.

1.5 Këto Rregulla Tregu aplikohen për të gjitha tregtitë dhe pagesat në tregjet shqiptare të Një dite më parë dhe përbëjnë një marrëveshje ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe çdo anëtar i Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë. Rregullat Tregut përfshijnë këto terma të përgjithshëm dhe gjithë shtojcat e tyre. Këto terma të përgjithshëm janë të detyrueshme dhe me të njëjtën fuqi ligjore. Këto rregulla tregtare janë gjithashtu të drejtuara nga legjislacioni sekondar shqiptar i aplikuar, modeli shqiptar i tregut dhe rregullat e tregtimit të aplikueshme.

1.6 Të gjitha transaksionet e regjistruara në

Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë do të jenë automatikisht dhe me mënyrë të detyrueshme objekt për pagesat, ku anëtarët do të bëhen kundërpalë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, që veprojnë si kundërpalë qendrore në të gjitha transaksionet, ashtu siç edhe është përcaktuar më tej në Rregullat e Pagesave dhe Shlyerjeve (shtojca 5).

2. INTERPRETIMI, PËRKUFIZIMET DHE SHKURTIMET

2.1 Termat e përdorur në këto Rregulla, do të kenë kuptimin e përcaktuar në shtojcën e Rregullave të tregut 1 (përkufizimet) ose siç përcaktohet në mënyrë specifike në tekstin e Rregullave të tregut 1.

2.2 Referencat në cilindo ligj ose statut do të konsiderohen të përfshijnë çdo amendim të lidhur, konsolidime, riratifikime ose zëvendësimet e tij.

2.3 Referencat ndaj një njësie ekonomike përfshijnë çdo korporatë, një organizatë të painkorporuar ose çdo subjekt tjetër juridik apo person fizik.

2.4 Referencat ndaj një anëtari do të konsiderohen të përfshijnë referencat për pasardhësit ose të caktuarit (të menjëhershëm ose ndryshe) të atij anëtari.

2.5 Referencat ndaj pikave në kohë i referohen kohës evropiane qendrore (formati 24-orësh), përveç kur përcaktohet ndryshe.

2.6 Çdo fjalë që prezanton njësinë do të pranojë shumësin kur konteksti e pranon dhe anasjellas. Çdo fjalë që prezanton gjininë asnjansë do të përfshijë edhe gjininë femërore dhe gjininë mashkullore (në lidhje me një person fizik).

2.7 Termi “përfshirë” do të ketë kuptimin “përfshirë por jo i kufizuar në”.

2.8 Çdo referencë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, që ka të drejtë të marrë një vendim ose ndërprerjen apo të formojë çfarëdo opinionin apo gjykimin, do të ketë kuptimin, përveç nëse përcaktohet ndryshe, se Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka të drejtë të ushtrojë gjykimin e vetë ekskluziv dhe të papenguar për ta bërë këtë.

2.9 Titujt në këto Rregulla Tregu janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë interpretimin e saj.

2.10 Referencat lidhur me komunikimet me shkrim do të përfshijnë, përveç kur përcaktohet ndryshe, komunikimin me *e-mail* dhe të komunikimit përmes ETS (sistemi i telefonisë elektronike).

2.11 Në rastin e konfliktit ndërmjet këtyre termave të përgjithshëm dhe Rregullave të Tregut



Shqiptar të Një Dite më Parë të përfshira në shtojcën tregtare 2, dispozitat e rregullave në fuqi të tregut të caktuara në shtojcën tregtare 2 do të prevalojnë. Në rast të konfliktit ndërmjet këtyre Rregullave Tregtare ose ndonjë prej shtojcave të saj tregtare në njërin anë dhe një marrëveshje tregtare të lidhur në anën tjetër, dispozitat e një marrëveshjeje të tillë do të prevalojnë.

### 3. KUSHTET PËR TREGTIM

#### 3.1 Parakushtet për tregtim

3.1.1 Subjektet të cilat dëshirojnë për të kryer tregti në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë, duhet të hyjnë në një marrëveshje për anëtarësim me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, të jenë të ligjshme si kundërpalë në rregullat e pagesave dhe likuidimeve dhe duhet të kenë të drejtën për të marrë pjesë në Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike sipas ligjit shqiptar të aplikuar që rregullon tregun e energjisë elektrike, përpara fillimit të tregtimit të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.

3.1.2 Në vazhdim të kërkesave në nenet 0, secili anëtar në çdo kohë duhet të:

a) jetë i ligjshëm si Kundërpalë kundrejt çdo transaksioni dhe transaksionit korrespondues të pagesës, në përputhje me Rregullat e Pagesave dhe Shlyerjeve;

b) përftojë, të mirëmbajnë dhe të pajtohen me të gjitha licencat, autorizimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga ligji në fuqi, për të mundësuar atë të kryejë tregtinë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas Rregullores së tregtimit;

c) caktojë një përgjegjës për TREGTINË, në përputhje me paragrafin 0.

3.1.3 Anëtarët duhet në emër të tyre ose nëpërmjet një furnizuesi të kenë hyrë në një marrëveshje për përgjegjësinë për balancimin me palën përkatëse përgjegjëse për balancimin ose me Operatorin e Sistemit të Transmetimit. Nëse një marrëveshje e tillë është ndërprerë ose pezulluar, anëtari ose përfaqësuesi i klientit, do të njoftojë menjëherë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mundet në raste të tilla të pezullojë dhe të ndërpresë marrëveshjet për anëtarësimin.

3.1.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kërkojë që një anëtar të ofrojë konfirmimin e marrëveshjes së tij me një furnizues

3.1.5 Të drejta dhe detyrime të mëtejshme mbi

anëtarët për sa i përket tregtisë, janë përcaktuar në marrëveshjet e tregtisë dhe Rregullat e drejtimit të tregut (shtojca 4) sipas rastit.

#### 3.2 Aprovimi i anëtarëve

3.2.1 Subjektet që dëshirojnë të hyjnë në një marrëveshje anëtarësimi, duhet të dërgojnë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike një aplikim me shkrim për anëtarësim në atë formë që do ta përshkruajë herë pas here Bursa Shqiptare e Energjisë.

3.2.2 Si pjesë e procedurës së aprovimit, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kërkojë informacion shtesë nga aplikanti mbi statusin ligjor të aplikantit, saktësinë financiare, organizimin, sistemet teknike, nivelin e eksperiencës dhe kompetencës dhe çështje të tjera relevante për vlerësimin nëse është apo jo aplikanti i përshtatshëm dhe i duhur për t'u bërë anëtar.

3.2.3 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund t'i kërkojë një aplikanti që të ofrojë një arsyetim bindës ligjor në ato çështje që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike i konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh që aplikanti ka ligjërisht të drejtën dhe është i autorizuar për të ushtruar tregtinë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe që Marrëveshja e Tregtisë ka qenë firmosur nga një përfaqësues i caktuar në mënyrë të rregullt.

3.2.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të lejojë vetëm aplikantët që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sipas gjykimit të saj, i konsideron të përshtatshëm dhe të duhur për t'u bërë anëtarë. Aplikantët nuk do të refuzohen në mënyrë të paarsyeshme. Në rast të refuzimit të një aplikanti, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të japë një deklaratë me shkrim për arsyet.

3.2.5 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të pranojë dhe trajtojë përgjithësisht aplikantë dhe anëtarë mbi baza të ndershme dhe jodiskriminuese. Subjekt i këtij principi të sipërpërmendur, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të imponojë termat dhe kushtet mbi subjektet individuale, nëse kjo, sipas mendimit të arsyeshëm të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, është e domosdoshme të reflektojë rrethanat e veçanta që zbatohen për atë subjekt ose të pranojë një subjekt, i cili do të përjashtohet në të kundërt nga anëtarësimi, përfshirë termat dhe kushtet e kërkuar nga ligji në fuqi në juridiksionin ku subjekti është i regjistruar.



3.2.6 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të informojë menjëherë aplikantin, me shkrim, mbi rezultatit e procesit të aplikimit. Nëse aplikimi aprovohet, një kopje origjinale e marrëveshjes e nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të nënshkruesit dhe Bursës Shqiptare do t'u vihet në dispozicion palëve.

### 3.3 Përgjegjësit për tregtimin dhe tregtarët

3.3.1 Çdo anëtar duhet të emërojë një përgjegjës për tregtinë e anëtarit, subjekt ky për aprovim nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, që nuk duhet të refuzohet pa arsye.

3.3.2 Çdo anëtar mund të emërojë tregtarë shtesë si të autorizuar për të kryer tregtinë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë, subjekt ky aprovimi nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, që nuk duhet të refuzohet pa arsye.

3.3.3 Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, përgjegjësi për tregtinë dhe tregtarët do të kenë akses të plotë në sistemin për tregtinë elektronike (STE) për sa u përket të gjithë portofolave të tregtisë së anëtarit. Çdo anëtar do të sigurojë që përgjegjësi i tij për tregtinë dhe tregtarët do të jenë plotësisht të autorizuar për të përfaqësuar anëtarin kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në të gjitha çështjet që lidhen me tregtinë e anëtarit dhe do të jetë në gjendje të marrë një veprim të tillë në një mënyrë konsistente me programet e përditshme kohore dhe kërkesa të tjera të vendosura nga ose në pajtim me Rregullat e tregimit.

3.3.4 Pas marrjes nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike të një njoftimi me shkrim nga anëtarit se emërimi i çdo individit si tregtari përgjegjës dhe/ose tregtari do të revokohet, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të pezullojë menjëherë aksesin në ETS të përgjegjësit për tregtinë dhe/ose tregtarit dhe do të dërgojë një konfirmim me shkrim. Pavarësisht këtij njoftimi, anëtarit do të mbetet i detyruar dhe përgjegjës për të gjitha veprimet ose mosveprimet e anëtarit në lidhje me tregtinë gjatë periudhës që përgjegjësi për tregtinë dhe/ose tregtari ka akses në STE, deri në kohën kur Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike të ketë konfirmuar me shkrim që aksesin në STE, përgjegjësit për tregtinë dhe/ose tregtarit është ndërprerë.

3.3.5 Në rastin kur përgjegjësi për tregtinë dhe/ose tregtari është pezulluar, anëtarit duhet të emërojë një person të ri sipas kushteve sipas pikave

3.3.1 dhe 3.3.2 brenda 5 (pesë) ditëve që kur personi i mëparshëm u pezullua.

### 3.4 Portofolat e tregtisë

3.4.1 Anëtarëve, subjekt aprovimi paraprak nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (aprovimi nuk mund të refuzohet pa arsye) do t'u lejohej numri i portofolave tregtarë të kërkuar prej tyre nga Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë, sipas rastit. Portofolat e tregtisë janë subjekt i pagesave siç janë të përcaktuara në programin tarifor.

## 4. PËRFAQËSIMI DHE GARANCITË

### 4.1 Përfaqësimi nga anëtarit

4.1.1 Secili anëtar përfaqëson dhe garanton kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në çdo datë në të cilën një porosi është paraqitur ose transaksion ka hyrë në të:

a) Autoriteti. Ka autoritetin të kryejë detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e tregimit dhe çdo transaksion;

b) Statusi. Është i organizuar dhe ekziston në mënyrë të rregullt sipas ligjeve dhe juridiksionit mbi shoqëritë tregtare;

c) Organizata. Ka personelin dhe organizimin e duhur për të mundur që të performojnë me sukses dhe personeli i vetë ka kompetencën dhe dijen e domosdoshme për tregtinë;

d) Ndërmarrja e rrezikut. Ai është i vetëdijshëm dhe kupton karakteristikat e secilit prej produkteve dhe rreziqet që lidhen me to, si dhe ka paraqitur urdhra pas një mundësie të plotë për të rishikuar termat dhe kushtet e tyre dhe ka një kuptim adekuat të këtyre termave dhe kushteve dhe të rreziqeve të tyre dhe është i aftë për ndërmarrjen e këtyre rreziqeve;

e) Asnjë shkelje apo konflikt. Ekzekutimi, shpërndarja dhe përmbushja e marrëveshjeve përkatëse tregtare apo rregullat tregtare, nuk shkelin apo konfliktojnë me asnjë ligj në fuqi apo ndonjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese në fuqi të anëtarit apo ndonjë nga pasuritë e tij, ose ndonjë kufizim kontraktual të detyrueshëm, ose që ndikon te ai apo në ndonjë nga pasuritë e tij;

f) Autorizimet e kërkuara. Të gjitha autorizimet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi, janë marrë dhe janë në fuqi dhe është përmbushur çdo kusht i autoriteteve dhe nuk ka më nevojë për licencë apo dokumente apo akte të tjera që kanë nevojë të merren nga anëtarit në përputhje me çdo organ rregullator ose gjykatën me qëllim tregtimin dhe pagesën;



g) Informacioni i saktë. Të gjitha informacionet e zbatueshme që dërgohen me shkrim nga ose në emër të anëtarit, i cili është identifikuar si i nënshtruar ndaj apo i lidhur me Rregullat Tregtare është që nga data që është e dërguar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, i vërtetë, i saktë dhe i plotë në çdo aspekt material; dhe

h) Pajtueshmëria. Ngjarje e papajtueshme, apo ngjarje që me njoftimin apo me kalimin e afatit apo me të dyja do të përbënte një ngjarje të papajtueshme ka ndodhur lidhur me të dhe një ngjarje e tillë nuk mund të ndodhë si rezultat i saj, që hyn në apo që përmbush detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e tregtisë.

4.1.2 Anëtari kur bën tregti mund, të përsërisë kushtet e specifikuar më sipër, ashtu si edhe çdo kusht tjetër të specifikuar si të tillë në Rregullat e tregtimit.

4.1.3 Anëtari pranon që është në detyrën e tij të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike me shkrim në rast të ndonjë shkeljeje apo dyshimi për shkelje të përfaqësimit të tij, menjëherë pasi anëtari bëhet i vetëdijshëm për të njëjtën gjë.

4.2 Përfaqësimet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike

4.2.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike përfaqëson dhe garanton për secilin anëtar në lidhje me çdo transaksion i cili ka hyrë në sistemin e saj STE - Sistemin e tregtisë elektronike ,që:

a) Autoriteti. Ka autoritetin të kryejë detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e tregtimit dhe çdo transaksion;

b) Statusi. Është i organizuar dhe ekziston në mënyrë të rregullt sipas ligjeve dhe juridiksionit mbi shoqëritë tregtare;

c) Organizata. Ka personelin dhe organizimin e duhur për të mundur që të performojnë me sukses dhe personeli i vet ka kompetencën dhe dijen e domosdoshme për tregtinë;

d) Asnjë shkelje apo konflikt. Ekzekutimi, shpërndarja dhe përmbushja e marrëveshjeve përkatëse tregtare apo rregullave tregtare, nuk shkelin apo konfliktojnë me asnjë ligj në fuqi ose ndonjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese në fuqi të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike apo të ndonjë nga pasurive të saj, ose ndonjë kufizim kontraktual të detyrueshëm, ose që ndikon te ajo apo ndonjë nga pasuritë e saj;

e) Autorizimet e kërkuara. Të gjitha autorizimet e kërkuara sipas ligjit në fuqi janë marrë dhe janë në

fuqi të plotë dhe është në përputhje me kushtet e çdo autorizimi të kërkuar dhe nuk ka më licenca, dokumente apo akt tjetër sa i përket organit rregullator apo gjykatës që kërkohet të merret, të bëhet, nga Bursa Shqiptare e Energjisë, në përputhje me aktivitetin e saj, sipas rregullave të tregtimit;

f) Informacioni i saktë. Të gjitha informacionet e zbatueshme që dërgohen me shkrim nga ose në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, e cila është identifikuar si e nënshtruar ndaj apo e lidhur me Rregullat Tregtare është, që nga data që u janë dërguar anëtarëve dhe, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në informacionin në fuqi, i besuar se është i vërtetë dhe i saktë, i plotë në çdo aspekt material; dhe

g) Pajtueshmëria. Asnjë mospagesë apo ngjarje që me njoftimin apo me kalimin e afatit apo me të dyja do të përbënte një mospagesë, s'ka ndodhur lidhur me të dhe asnjë ngjarje e tillë nuk mund të ndodhë si rezultat i saj, që hyn në apo që përmbush detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e tregtisë.

## 5. KRIJUESIT E TREGUT

5.1.1 Një anëtar mund të aplikojë pranë Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për t'u aprovuar si krijues tregu në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë. Nëse Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike e aprovon emërimin e anëtarit si krijues tregu, anëtari do të hyjë në një marrëveshje për krijimin e tregut me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

5.1.2 Të drejtat dhe detyrimet e krijuesve të tregut janë më tej të specifikuar në marrëveshjen individuale të krijuesit të tregut.

## 6. LISTIMI I PRODUKTEVE

6.1.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike vendos cili produkt do të listohet apo hiqet nga Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë, duke ndjekur konsultimet me Bordin Këshillimor të Klientëve

## 7. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME MBI TREGTINË

### 7.1 Objektet e tregtisë

7.1.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mirëmban një sistem tregimi elektronik (STE), përkatësisht *web-i* i Një dite më parë, një sistem telefonik tregtimi (TTS).

7.1.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lehtëson tregtinë e produkteve ndërmjet anëtarëve, duke marrë porosi në STE dhe përcakton vëllimet dhe çmimet që tregtohen sipas rregullave



prevaluese për llogaritjet e çmimeve. Një anëtar mundet në çdo ditë tregtie, brenda orëve të tregtisë për produktin përkatës, të paraqesë porosi nëpërmjet sistemit elektronik të tregtisë. Përpunimi dhe përputhja e porosive dhe transaksionet u nënshtrohet rregullave të zbatueshme për Tregun Shqiptar të Një Dite më Përpara.

7.1.3 Anëtarët janë përgjegjës për ngritjen e komunikimit elektronik me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, në përputhje me specifikimet e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

7.1.4 Tregtia në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë është anonime, me përjashtim asaj ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe anëtarit individual që fut një porosi dhe si konsekuencë e kësaj, futet kështu në një transaksion. Përveç rasteve kur është e nevojshme për të shfaqur porositë dhe transaksionet për Anëtarët, në përputhje me këtë nen 7.1.4 apo ose siç përcaktohet ndryshe në nenin 12 të këtyre Rregullave të tregtisë, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të trajtojë të gjitha porositë dhe informacionin tjetër nga anëtarët, që i kanë komunikuar Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në lidhje me transaksionet si konfidenciale. Kjo nuk shmang detyrimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike që, sipas ligjit në fuqi të ofrojë informacion ndaj autoriteteve rregullatore ose organeve të tjera, me përgjegjësinë e vetë ose me kërkesë të tyre.

7.1.5 Të gjithë porositë dhe transaksionet në STE do të ruhen elektronikisht dhe do të mbahen nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në përputhje me ligjin në fuqi. Informacioni i transaksioneve që rezulton nga këto rekorde mund të përdoret ashtu siç është specifikuar në nenin 12. Të gjitha telefonatat me tabelën e receptionit të tregtisë dhe TTS mund të regjistrohen e të ruhen në përputhje me ligjin në fuqi. Të dyja palët: Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe anëtarët, japin pëlqimin për regjistrime të tilla dhe ndërmarrin sigurimin e çdo pëlqimi të nevojshëm nga punonjësit e tyre, me qëllim që të përputhet me ligjin në fuqi.

7.2 Sistemi i tregtisë elektronike (STE, *web-i* i një dite më parë)

7.2.1 STE-ja është mjete kryesor i tregtisë për të gjithë anëtarët që dëshirojnë të kryejnë tregti në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë. Anëtarët mund të regjistrojnë porositë e tyre në STE, ku

porositë janë renditur dhe përputhur sipas rregulloreve për Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë.

7.2.2 Aksesit në STE për anëtarët është joekskluziv dhe i patransferueshëm. Anëtarët do të kenë të drejtën e aksesit dhe përdorimit të STE me kusht që:

a) Anëtarit plotëson kushtet për tregtinë, siç është specifikuar në nenin 3.1;

b) Anëtarit që nuk ka të drejtat e tij të tregtisë është pezulluar apo terminuar në përputhje me këto rregulla tregtimi; dhe

c) Përputhshmëria e anëtarit me termat e përdorimit të STE-së është ashtu siç është specifikuar në këto Rregulla Tregtimi.

7.2.3 Regjistrimi i porosive dhe transaksioneve në STE është i kushtëzuar nga të pasurit e së drejtës së anëtarit për të bërë pagesa, në përputhje me Rregullat e pagesave.

7.3 Sistemi telefonik i tregtisë (STT)

7.3.1 TTS përdoren si një mjet *backup-i* (kopje rezervë) për anëtarët e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë. Në kushtet kur STE-ja nuk punon apo Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, për arsye të tjera mendon se STT-ja është një opsion praktik se STE-ja, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mundet nën vendimmarrjen e vet të aprovojë që anëtarit mund të telefonojë për porositë e tij apo ndryshimet, apo anulimet e porosive, nga telefoni në STT.

7.3.2 Vetëm tregtarët e aprovuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në përputhje me nenin 3.3, janë të autorizuar të kontaktojnë STT-në. Kur kontakton STT-ja, tregtari duke qenë se është një telefonatë spontane e paprogramuar, duhet në çdo rast, në bazë të kërkesës nga ana e operatorit të STT-së, të identifikojë veten me emrin e plotë dhe cilin anëtar ai përfaqëson, shtetin nga vjen telefonata me dorëzimin e porosisë dhe pse anëtarit nuk ka mundësi ta dërgojë porosinë e vet me anë të STE-së.

7.3.3 Me kusht që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike të miratojë përdorimin e STT-së, anëtarit duhet të sigurojë një informacion të tillë siç do të kërkohet në qoftë se duke përdorur STE-në dhe, përveç kësaj të gjitha informacionet e tilla, të cilat Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme të mundësohet që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, ta regjistrojë me saktësi urdhrin.



7.3.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të regjistrojë porosinë nga STT-ja në STE sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së porosisë dhe, në rast të disa porosive në të njëjtën kohë, do të përpiqet për të regjistruar porositë e marra në të njëjtën sekuençë, pasi porositë të jenë njoftuar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

7.3.5 Një porosi e dërguar përmes STT-së konsiderohet e reregjistruar vetëm atëherë kur Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka konfirmuar hyrjen e porosisë në STE, përmes STT-së ose në të kundërt me shkrim. Porosia bëhet e detyrueshme mbi anëtarin nga koha e regjistrimit pavarësisht kohës së konfirmimit.

7.3.6 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të bëjë përpjekje komercialisht të arsyeshme për të drejtuar një shërbim STT efektiv dhe të mirëmbajë vazhdimësinë e aksesit në STT, por STT-ja ofrohet mbi një bazë “si në dispozicion” dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk bën asnjë përfaqësim ose garanci për sa i përket disponueshmërisë së STT-së për çdo anëtar, në çdo kohë të dhënë.

#### 7.4 Disponibiliteti i tregtarëve

7.4.1 Pasi një tregtar ka dërguar një porosi, tregtari i anëtarit në fuqi duhet të jetë i disponueshëm për t'u kontaktuar me telefon në çdo kohë, për aq kohë sa porosia të jetë në fuqi. Porositë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë konsiderohen si valide derisa ankandi përkatës të përfundojë apo porosia të revokohet në përputhje me Rregullat e tregtimit.

7.4.2 Kurdoherë që një anëtar ka hyrë në një transaksion në përputhje me Rregullat e tregtimit, Tregtari përkatës do të jetë i disponueshëm me telefon për një periudhë prej tridhjetë (30) minutash pas kohës së kontratës në fuqi.

#### 7.5 E drejta për të refuzuar porositë

7.5.1 Pavarësisht çdo dispozite tjetër në Rregullat e tregtimit, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike rezervon të drejtën, sipas gjykimit të saj dhe pa njoftim paraprak për një anëtar të refuzojë, të anulojë apo të refuzojë të shfaqë ose përputhë çdo porosi, e cila në përcaktimin Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike do t'u kundërvihet Rregullave Tregtare ose ligjit në fuqi. Çdo vendim i tillë duhet të jetë i bazuar në mënyrë të arsyeshme, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të njoftojë menjëherë anëtarin për një vendim të tillë.

## 8. TARIFAT DHE PAGESAT

8.1 Tarifat kohë pas kohe do të ngarkohen mbi anëtarët dhe do të faturohet në përputhje me planin tarifor. Përveçse kur siç thuhet në mënyrë eksplicite, të gjitha pagesat janë përcaktuar ekskluzivisht nga TVSH-ja.

8.2 Vetëm nëse parashihet ndryshe në Rregullat e Pagesave dhe të Shlyerjeve, çdo anëtar është përgjegjës dhe do të paguajnë çdo dhe të gjitha TVSH-të dhe taksat përkatëse që dalin në lidhje me aktivitetet e veta tregtare dhe e cila duhet të paguhet nga ai anëtar në bazë të ligjit në fuqi, pa pagesë të mëtejshme, rimbursimin ose dëmshpërblim kundrejt ose nga anëtari tjetër për një transaksion apo Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, pavarësisht nëse anëtari kërkohet bazuar në ligjin në fuqi të paguajë ndonjë TVSH apo taksë përkatëse, e cila është siç duhet për llogarinë e anëtarit tjetër ose Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

8.3 Shlyerja e tarifave do të kryhet nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, në përputhje me Rregullat e Pagesave dhe të Shlyerjeve dhe do të përfshihet në shlyerjen e transaksionit(ve) korresponduese. Pas kryerjes së pagesës në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të të shkarkojë pretendimin e saj përkatës kundrejt anëtarit.

## 9. DREJTIMI I TREGUT DHE MBIKËQYRJA E TREGUT

9.1 Anëtarët duhet në çdo kohë të jenë në përputhje me dispozitat e Rregullave të Drejtimit të Tregut kur tregtojnë. Mospërputhshmëria me Rregullat e Drejtimit të Tregut mund të dënohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në përputhje me dispozitat e Rregullave të Drejtimit të Tregut.

9.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të monitorojë, nëpërmjet mbikëqyrjes së Tregut, Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë, me një pikëpamje për t'u siguruar, që të gjitha tregtitë dhe aktivitetet e tjera në Tregun Shqiptar të një Ditë më Parë, janë në përputhje me Rregullat e Drejtimit të Tregut dhe ligjin në fuqi. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kryejë investigime mbi aktivitetet e anëtarëve të tregut, ashtu siç është specifikuar në Rregullat e Drejtimit të Tregut.

9.3 Mbikëqyrja e Tregut e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike mund të bëjë kërkesë për dhe të mbledhë informacion nga anëtarët në lidhje me



biznesin e tyre. Biznese të tilla përfshijnë të gjitha tregtitë fizike dhe financiare.

9.4 Në lidhje me investigimet për biznesin e anëtarëve, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund, drejtpërdrejt nga pala përgjegjëse për balancimin apo nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, të mbledhë çdo të dhënë lidhur me menaxhimin, tregun dhe shlyerjen e llogarive.

#### 10. DETYRIMET DHE FORCA MADHORE

10.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk do të jetë përgjegjëse për çdo humbje apo dëmtrim kundrejt anëtarit të shkaktuar nga vendimet e biznesit të anëtarit lidhur me tregtinë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë. Pritet që anëtari të drejtojë tregtinë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë me vëmendjen e duhur që kërkohet nga një biznesmen i mirë.

10.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në asnjë rrethanë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje ose dëmtrim të një anëtari, të shkaktuar nga një veprim ose mosveprim prej një tjetër anëtari.

10.3 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë humbje apo dëmtrim të një anëtari, që mund të lindë nga tregtia apo nga Rregullat e tregtisë, si rezultat i ndonjë veprimi apo mosveprimi nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ose ndonjë anëtar tjetër, me kusht që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk ka vepruar pakujdesisht, pandershmërisht (mashtim) ose duke mospaguar me paramendim.

10.4 Me përjashtim të rastit kur Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka vepruar pandershmërisht apo është në rast mospagese të paramenduar, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk do të jetë përgjegjëse në asnjë rrethanë kundrejt anëtarit për humbjen indirekte dhe për dëmtimin si pasojë e kësaj, përfshirë humbjen e fitimit apo të kontratave.

10.5 Pavarësisht nga nenet 10.1 dhe 10.2 një anëtar do të jetë përgjegjës kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për të gjitha humbjet apo dëmtimet e pësuar, përfshirë shpenzimet e akumuluar, që rezultojnë drejtpërdrejt nga mospagimi i anëtarit, si pasojë e një mosrealizimi.

10.6 As Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike as anëtari nuk do të jenë përgjegjës nën çfarëdo lloji rrethane për ndonjë humbje apo dëmtrim për sa i përket ndonjë dështimi nga ana e vetë për të kryer ndonjë prej detyrimeve e veta, në përputhje me Rregullat e tregtisë, në qoftë se një ngjarje force

madhore pengon kryerjen e detyrimeve të saj përkatëse.

#### 11. DËMSPËRBLIMET

11.1 Anëtari do të dëmshpërblejë plotësisht dhe në mënyrë efektive Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike prej dhe kundrejt çdonjërit dhe të gjitha kostove, ankesave, dëmtimeve dhe shpenzimeve që rrjedhin direkt nga çdo shkelje e detyrimeve të veta, në përputhje me Rregulloren e Tregtisë, me kusht që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të lehtësuar kosto, dëmtime e shpenzime të tilla, pa paragjykim për detyrimet e tij ndaj anëtarëve të tjerë dhe të drejtën e tij për të mbrojtur integritetin e çdo tregu fizik.

11.2 Çdo anëtar është i detyruar të dëmshpërblejë plotësisht të gjitha kostot të cilat mund të lindin për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, në lidhje me TVSH-në, taksat doganore, kapacitetet ndërkufitare apo pagesa të tjera të ngjashme për energjinë elektrike, e cila është tregtuar në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë, pasi këto kosto janë përgjegjësi vetëm e anëtarit në fjalë.

#### 12. SHËRBIMET E INFORMACIONIT TË TREGUT

12.1 Të drejtat pronësore kundrejt informacionit të transaksionit

12.1.1 Kurdo që një anëtar ofron të dhëna në formën e porosive ose të tjera për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike nëpërmjet STE-së ose SIT-së, të dhënat e tilla do t'i përkasin Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike. E drejta e autorit dhe të gjitha të drejtat tjera të pronësisë intelektuale ose të drejta ekskluzive të çfarëdo natyre të përfshira në informacionin e transaksionit (duke përfshirë, për shmangien e dyshimit, të gjitha të drejtat e bazës së të dhënave dhe të drejtat e ngjashme nëse janë apo jo të mbrojtura me ligj), që rrjedhin nga tregtia janë dhe do të mbeten në çdo kohë, ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe anëtarit, pronë e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike ose e licencuesve të saj.

#### 12.2 Prezantimi

12.2.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të ketë të drejtën të përdorë, kopjojë, përshtatë, autorizojë, furnizojë, shpërndajë, shesë, emërojë, transferojë, paguajë qira, kontraktojë për qira, caktojë pagesë ose gjithashtu menaxhojë informacionin e transaksioneve dhe informacione të tjera në lidhje me çështjet teknike dhe financiare, i papenguar nga çdo detyrë konfidencialiteti





kundrejt çdo anëtar, për aq kohë sa që ky informacion nuk identifikon asnjë anëtar individual. Anëtarët nuk do të kenë të drejtën e shpërblimit në lidhje me aktivitete të tilla.

12.2.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kalojë informacione te autoritetet publike dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit, nëse kështu kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të informojë anëtarin për këtë dispozitë të informacionit për aq sa është e lejuar për ta bërë këtë, në bazë të ligjit në fuqi apo rregullores.

12.2.3 Krahas dispozitave të këtij neni 12.2, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka të drejtë të japë informacion, siç është përcaktuar në Rregullat e Drejtimit të Tregut.

### 13. KOMUNIKIMET

13.1 Komunikimet me shkrim ndërmjet anëtarëve dhe Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike mund të jenë në anglisht, nëse një gjë të tillë kërkon Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

13.2 Çdo njoftim që jepet në bazë të Rregullores së Tregimit do të bëhet me shkrim dhe do të dorëzohet ose dërgohet me letër ose *e-mail* në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike në adresat dhe numrat e specifikuar në faqen e saj në çdo kohë (nëse i drejtohet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike) ose në adresën përkatëse apo numrin e telefonit ose adresën e *e-mail-it*, të specifikuar në marrëveshjen e saj të tregimit ose siç njoftohet ndryshimi i konfirmuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund gjithashtu të komunikojë në përgjithësi me anëtarët nëpërmjet faqes së vetë të internetit: [www.albanianpowerexchange.com](http://www.albanianpowerexchange.com)

13.3 Lajmërimet do të konsiderohen se janë dhënë (në rastin e komunikimit me *e-mail*), në datën në të cilën ato janë të dërguar ose (në rastin e komunikimeve të tjera) në datën e dorëzimit në adresën e duhur.

13.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të ketë të drejtë të veprojë, gjithashtu të besojë, mbi çdo komunikim (nëse ky është me shkrim apo jo) i cili ka sens dhe në të cilin Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka besim:

a) Ta lëshojë nga ose në emër të anëtarit; ose

a) Të ketë qenë aprovuar nga një individ i cili është autorizuar nga ai anëtar dhe i cili (në rastin e një komunikimi elektronik) kënaq kërkesat e çfarëdo kërkesë në fuqi të Bursës Shqiptare të

Energjisë Elektrike, në lidhje me sigurinë dhe integritetin e informacionit që transmetohet në mënyrë elektronike.

### 14. SHITESAT

14.1 Rregullat e tregimit mund të amendohen nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe të bëhen publike me një njoftim minimumi katërmëdhjetëditor (14-ditor).

14.2 Amendime për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike mundet të hyjnë në fuqi vetëm duke ndjekur konsultimet me Bordin Këshillimor të Konsumatorëve dhe me aprovimin e ERE-s.

14.3 Pavarësisht nga nenet 14.1 dhe 14.2, ndryshimet në Rregulloren e Tregimit mund të zbatohen me efekt të menjëhershëm në vijim të njoftimit për anëtarët e ndikuar:

a) Nëse kështu kërkohet nga ligji në fuqi;

b) Nëse të tilla amendime janë të domosdoshme për opinionin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, si për vazhdimin e operacioneve të tregimit apo për integritetin e tregut përkatës fizik;

c) Nëse kështu kërkohet në mënyrë për të lehtësuar fillimin e një ose më shumë produkteve të reja, me kusht që ndryshimet e tilla nuk ndikojnë drejtpërdrejt në tregtinë në (ose pagesën e) produkteve të tjera dhe me kusht që Bordi Këshillimor i Konsumatorëve ka rënë dakord me amendime të tilla;

d) Nëse amendime të tilla janë të domosdoshme për të korriguar gabimet në Rregullat e tregimit; apo

e) Nëse amendime të tilla janë vetëm me natyrë redaktuese dhe nuk sjellin ndonjë ndryshim thelbësor në Rregulloren e Tregimit, duke përfshirë edhe sqarimet dhe ndryshimet në paraqitjen etj.

### 15. TË NDRYSHME

#### 15.1 Transferimi i të drejtave

Të drejtat që Rregullat e tregimit i garantojnë një anëtar nuk janë të transferueshme apo të tjetërsueshme pa aprovimin paraprak me shkrim të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

#### 15.2 Ndarshmëria (pjesëzimi)

Nëse në çdo kohë ndonjë dispozitë e Rregullave të tregimit bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në çdo aspekt, në bazë të ligjit të çdo juridiksioni, as ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të Rregullave të tregimit, as ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e një dispozite të tillë, sipas ligjit



të çdo juridiksioni tjetër, nuk do të mundet në asnjë mënyrë të preket ose të dëmtohet në këtë mënyrë.

### 15.3 Të drejtat e mosdorëheqjes

Asnjë dështim i një pale për të ushtruar, as ndonjë vonesë nga ana e saj në ushtrimin, e çdonjërës prej të drejtave të veta (në tërësi ose pjesërisht) sipas Rregullores së Tregtisë, s'do të veprojnë si një heqje dorë nga të drejtat apo mjetet juridike të palës mbi atë rast, apo ndonjë rast të mëvonshëm.

## 16. LIGJI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

16.1.1 Këto Rregulla Tregtimi, të gjitha transaksionet, shlyerjet dhe pagesat që kryhen nën to dhe gjithë obligimet jokontraktuale që ngrihen nga ose në lidhje me to, do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

16.1.2 Gjykatat Shqiptare do të kenë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo ankesë, mosmarrëveshje apo diferencë që mund të dalë nga/ose në lidhje me këto Rregulla Tregtimi, përfshirë çdo pyetje për sa u përket ekzistencës, vlefshmërisë apo përfundimit të tyre.

16.1.3 Çdo anëtar dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në mënyrë të përvokueshme heqin dorë nga çdo vërejtje që mund të kenë aktualisht apo në të ardhmen, për vendndodhjen e çdo procedure në gjykatat shqiptare dhe çdo pretendim që çdo procedurë ka sjellë në një forum të papërshtatshëm dhe, më tej, në mënyrë të përvokueshme pranon se një gjykim në çdo një procedim të sjellë në gjykatat shqiptare, do të jetë përfundimtar dhe detyrues mbi këtë Palë dhe mund të zbatohet në gjykatat e çdo një juridiksioni tjetër në përputhje me ligjet e zbatueshme të atij juridiksioni. *Each Member and Albanian Power Exchange irrevocably waives any objection which it may have now or hereafter to the laying of the venue of any proceedings in the Albanian courts and any claim that any such proceedings have been brought in an inconvenient forum, and further irrevocably agrees that a judgment in any proceedings brought in the Albanian courts shall be conclusive and binding upon such Party and may be enforced in the courts of any other jurisdiction in accordance with the enforcement laws of that jurisdiction.*

16.1.4 Çdo anëtar dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në mënyrë të përvokueshme heqin dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar një shërbim apo proces në ndonjë procedurë që nuk është kryer si duhet, ku shërbimi i tillë i procesit

është kryer nëpërmjet dorëzimit në adresën e fundit të njoftuar nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sipas nenit 13 të kësaj rregullore.

## SPECIFIKIMI I PRODUKTIT RREGULLAT E TREGTIMIT SHTOJCA 1 BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE SPECIFIKIMET E PRODUKTIT – TREGU FIZIK

### HYRJE

#### 1.1 Të përgjithshme

Ky specifikim produkti aplikohet së bashku me rregullat e tregimit në tërësinë e tyre, me rregulla e rregullore të mëtejshme lidhur me produktet që janë paraqitur në Tregun Shqiptar të Ditës në Avancë.

#### 1.2 Referencat kohore

Referencat për pikat në kohë i referohen kohës CET, për sa kohë nuk është specifikuar ndryshe, koha është përcaktuar në formatin 24 orësh. Referencat ditore janë për ditët kalendarike për sa kohë nuk janë specifikuar ndryshe.

#### Ndryshimi i kohës së shkurtuar

Në ditën e orës së shkurtuar në mars (fillimi i kursimit të kohës verore), do të ketë vetëm 23 orë në ditën e tregut spot, kështu që ora ndërmjet 02:00 dhe 03:00 do të kapërcehet atë ditë.

#### Ndryshimi i kohës së zgjatur

Në ditën e ndryshimit të kohës së zgjatur në tetor (fundi i kursimit të kohës verore) do të ketë 25 orë në ditën e tregut spot. Llogaritja e zakonshme e çmimit të ditës më parë dhe programet mbulojnë 25 orë. 25 orët duhet të raportohen dhe dy orët ndërmjet 02:00 dhe 03:00 mund të trajtohen si dy orë të ndryshme.

#### 1.3 Shlyerjet *cash*

Shlyerjet *cash* për shpërndarjet që kryhen në çdo ditë shpërndarjeje do të kryhen si më poshtë, pavarësisht shërbimit të produkteve:

i) Për secilën faturë me sasi neto shlyerjeje *cash* që i kanë borxh BSHEE-së:

a) Dita e shpërndarjes + 1 ditë

ii) Për çdo faturë me sasi shlyerjeje *cash* që BSHEE-ja ka borxh:

a) Dita e shpërndarjes + 2 ditë

Rregulla dhe procedura të mëtejshme lidhur me shlyerjen *cash* dhe shpërndarjen janë përcaktuar në Rregullat e Tregut.



## 2. TREGU SHQIPTAR I NJË DITE MË PARË

### 2.1 Të përgjithshme

2.1.1 Metoda e kuotimit: Dërgimi i vazhdueshëm i porosive deri në mbylljen e portës, duke ndjekur porosinë eliminatorë që do të përputhen dhe duke përdorur metodën e ankandit të përcaktuar në rregulloret e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.

2.1.2 Orët e tregimit: 24 orët që vijnë duke filluar nga 00:00 CET.

2.1.3 Mbyllja e portës: 12:00 CET

2.1.4 Porcioni i tregimit: 0,1 mw

2.1.5 Madhësia e impulsit: Euro 0.1/mwh

2.1.6 Monedha: Porositë mund të dërgohen në euro. Llogaritja e çmimit në euro.

2.1.7 Tipat e porosive: Porosi orare

2.1.8 Hapat e çmimit: Numri i hapave të çmimit është 64 (përfshirë çmimet e porosive kufi, të sipërm e të poshtëm)

2.1.9 Çmimi teknik i porosisë kufi të ulët: Euro – 500.

2.1.10 Çmimi teknik i porosisë kufi të lartë: Euro + 3000.

2.1.11 Shpërndarja: Siç specifikohet në porosi.

2.1.12 Shlyerjet *cash*: Sipas nenit 1.3 të kësaj shtojce. Llogaritjet e shlyerjeve do të bazohen në livrimet konkrete për orë livrimi në secilën ditë livrimi në fuqi.

2.2 Kodet e Kontratës të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë:

Prapashtesa (e ndryshueshme)	Shpjegimi	Diapazoni
dd	Dita e muajit (dy shifra)	01–31
mm	Muaji i vitit ( dy shifra )	01–12
yyyy	Viti (katër shifra)	Viti korrent (viti tjetër)
nn	Ora	00:00–24:00

## 2.3 Orët e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë

Kontratat për çdo javë (nga e hëna në të diel) do të hapen normalisht për porosinë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dy javë në avancë. Nëse e hëna është ditë pushimi, kontratat do të hapen ditën e punës që vjen në radhë. Lidhur me periudhat e pushimeve, java e tregimit mund të hapen më herët, ndërsa në lidhje me zbatimet teknike java e tregimit mund të hapet më vonë, vetëm sipas gjykimit të BSHEE-së.

### TREGU I NJË DITE MË PARË

#### RREGULLAT E TREGTIMIT

##### SHTOJCA 2

#### BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË

##### ELEKTRIKE

#### RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË NJË DITE MË PARË

### 1. HYRJE

1.1 Këto rregullore të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë përmbajnë dispozita të detajuara mbi porosinë dhe llogaritjen e çmimit të Një dite

përpara në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe janë pjesë e Rregullave të Tregut.

1.2 Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë ofron mundësinë e tregimit në kuptimin e tregtisë së një dite më parë, bazuar në të gjitha porosinë e marra nga anëtarët përpara mbylljes së portës.

1.3 Pas mbylljes së portës, të gjitha volumet dhe porosinë e marra janë grumbulluar dhe ekuilibri i tregut është llogaritur. Bazuar në ekuilibrin e tregut të çmimit dhe volumit, të drejtat dhe detyrimet e çdo anëtari për sa i përket shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike për orët përkatëse të shpërndarjes, janë vendosur ashtu siç është përcaktuar në këtë rregullore.

1.4 Transaksionet që rezultojnë nga porosinë që janë përputhur në ETS janë regjistruar automatikisht dhe detyrimisht për pagesë.

### 1.5 PROGRAMI I TREGUT TË PËRDITSHËM

1.5.1 Programimi i tregut të përditshëm.

1.5.2 Programimi i tregut të përditshëm duhet të kryhet sipas programimit në tabelën më poshtë.



## SHTOJCA E TREGTISË 2 - RREGULLORJA E TREGUT SHQIPTAR TË NJË DITE MË PARË

Procesi	Koha	Qëllimi	Rezultati	Veprimet e mëvonshme
1. Verifikim i Kapacitetit në dispozicion të transmetimit (ATC) për interkonektorët dhe kapaciteti i rrjetit në dispozicion për të evakuuar/të shpërndarë energjinë elektrike - nxjerrja jashtë e (detyrimit për kontratat dypalëshe afatgjata) ekzistuese.	Dita (D)-1, 9:00	Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) furnizon informacionin e disponueshëm të rrjetit të sistemi i Operatorit të Tregut (OT). Informacioni nga SEE CAO në lidhje me alokimin e kapaciteteve për tregtimin ndërkufitar furnizon sistemin e Operatorit të Tregut (OT) dhe regjistrohen kontratat dypalëshe afatgjata (LTBC) të përcaktuara për kapacitetin e vazhdueshëm.	Krijohet kapaciteti në dispozicion të transmetimit ATC, si dhe disponueshmëria e rrjetit të nyjat e veçanta.	Nxjerrja paraprake jashtë e pjesëmarrësve të tregut (MPs) të cilët nuk janë në gjendje të marrin pjesë në Tregun e Një Dite në Avancë (DAM) për shkak të kufizimeve të rrjetit dhe/ose mungesës së alokimeve të CAO-s.
2. Verifikim i kolateraleve financiare për pjesëmarrje në treg.	D-1, 9:30	Verifikim i garancive të mjaftueshme financiare për të mbuluar kostot e detyrimeve për pozicionin e Operatorit të Tregut (OT).	Pjesëmarrësi i tregut është në gjendje të marrë pjesë të Tregu i Një Dite në Avance apo jo?	Pjesëmarrësit e Tregut që do të marrin pjesë në tregun e Një Dite në Avancë (DAM), si dhe hapet dera për mosmarrëveshjet ose paraqitjen e provave të tjera (brenda 15 minutave).
3. Dera për paraqitjen e ofertave.	D-1, 10:45	Pjesëmarrësit e tregut paraqesin ofertat e tyre për Tregun e Një Dite në Avancë.	Ofertat e paraqitura.	Verifikim i kolateralit për transaksionet.
4. Verifikim i kolateralit financiar për të mbuluar transaksionet e paraqitura.	D-1, 11:30	Verifikim i garancive të mjaftueshme financiare për të mbuluar kostot e transaksioneve të programuara (shitjet ndaj blerjeve që mund të nxirren).	Ofertat e pjesëmarrësve të tregut për të marrë pjesë në Tregun e Një Dite në Avancë (DAM) do të hiqet apo jo?	Ofertat e pjesëmarrësve të tregut (MPs) me garanci të mjaftueshme të përfshira në pastrimin e tregut, të tjera - të refuzuara. Pjesëmarrësit e tregut informohen përmes verifikimit të rezultateve. Nëse verifikohet e kundërta - hapet periudha e mosmarrëveshjeve gjatë të cilës mund të paraqiten prova të tjera për kolateralin (brenda 15 minutave).
5. Pastrim ( <i>cleaning</i> ) paraprak i tregut.	D-1, 13:00	Krijimi i sasive të energjisë elektrike dhe çmimeve të aplikueshme për çdo orë të ditës për Tregun e Një Dite në avancë (DAM); përcaktim i këtyre për pjesëmarrës të veçantë të tregut.	Rezultatet paraprake për pastrimin e tregut të paraqitura për pjesëmarrësit e tregut (MPs).	Dera për pjesëmarrësit e prekur të tregut për të treguar hapjen (në bazë të gabimeve të tregut që frenojnë mundësinë për të paraqitur oferta për Tregun e Një Dite në Avancë (DAM) dhe/ose për shkak të kushteve të disponueshmërisë (15 minuta).
6. Pastrimi përfundimtar i tregut.	D-1, 14:00	Në atë pikë që ankesat e pjesëmarrësve të tregut justifikohen, riorganizim i pastrimit të tregut ka përfunduar. Shumat përfundimtare të energjisë elektrike dhe çmimet që do të aplikohen për çdo orë të ditës për Tregun e Një Dite në avancë, caktuar për pjesëmarrës të veçantë të tregut (MPs).	Rezultatet përfundimtare të pastrimit të tregut që i janë njoftuar pjesëmarrësve të tregut dhe OST për qëllime dispeçerimi.	Programimet e Tregut të Një Dite në avancë të cilat implementohen për dispeçerimin e përditshëm.



## 1.6 Programimi emergjent i tregut

1.6.1 Në rast situatash emergjente, përfshirë rastet kur Operatori i Tregut të Sistemit është në rënie (*was down*), Operatori i Tregut mund të paraqesë një programim emergjent të tregut, sipas të cilit duhet të informojë pjesëmarrësit e tregut në kohë.

## 2. REGJISTRIMI I POROSIVE

### 2.1 Formulari i porosisë

2.1.1 Porositë në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë do të dorëzohen duke përdorur formularin standard të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe do të transmetohen për te Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nëpërmjet komunikimeve elektronike, siç specifikohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

2.1.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund që në situata ku komunikimi i specifikuar siç përcaktohet në nenin 2.1.1 nuk punon, të vendosë një formular alternativ porosish, siç specifikohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, p.sh., mund të përdoret si një dokument në *e-mail* apo si një kopje e formularit të porosisë nga dita e mëparshme. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mundet në situata të tilla, të kufizojë numrin e hapave të çmimit në porositë orare.

2.1.3 Formulari i porosisë duhet të sigurojë informacion të plotë në mënyrë që të jetë i vlefshëm. Në rast refuzimi, raporti i çmimeve të marra prej anëtarit nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të deklarojë se asnjë transaksion nuk është konkluduar.

2.1.4 Anëtarët janë përgjegjës të kontrollojnë që porositë e dërguara janë korrekte dhe të vlefshme. Kjo përfshin gjithashtu situatat ku përpunimi manual i porosive nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ka qenë i domosdoshëm.

### 2.2 Kuotimi

2.2.1 Të gjitha porositë janë të detyrueshme dhe janë në dispozicion për pranim, në përputhje me Rregullat e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.

2.2.2 Porositë do të kuotohen duke përdorur tipat e porosive, siç është specifikuar më poshtë në nenin 3. Secila POROSI duhet të specifikojë nëse është një kërkesë apo një ofertë, ku kërkesat janë shënuar me numra pozitivë të volumit të

energjisë dhe ofertat me numra negativë të volumit të energjisë.

2.2.3 Kufijtë e volumit të energjisë dhe kufijtë e çmimit të porosive duhet të jenë ndërmjet gamës së çmimeve gjatë gjithë kohës ashtu siç specifikohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

2.2.4 Anëtarë mund të kuotojnë vetëm porosi në zonat e ofertimit, ku ndërmer prodhimin, konsumin apo është palë me kontratat që lidhen me shpërndarjen fizike apo me blerjen.

2.2.5 Çdo porosi kundrejt çdo ankandi përfaqëson një porosi individuale dhe të pavarur për periudhën(at) e dorëzimit me të cilat ai është i lidhur. Përveç siç është mandatar specifikisht nga tipi i porosisë që përdoret, secila porosi do të përfaqësojë një ofertë individuale për të blerë ose të shitur në mënyrë të pavarur nga çdo porosi tjetër e paraqitur ose në emër të secilit anëtar në të njëjtin ankand gjatë asaj periudhe(ave) të dorëzimit.

2.2.6 Çdo ankand gjithmonë është i lidhur me ditën e nesërme duke filluar nga ora 00:00 CET. Porositë mund të regjistrohen që nga koha që ato janë vënë në dispozicion për tregtim dhe deri mbyllet e portës.

2.2.7 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kontaktojë anëtarët me telefon ose me *e-mail* dhe të ofrojë mundësinë që anëtarë të mund të transmetojë dhe/ose të korrigjojë një porosi, në rastin kur Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka arsye të besojë se një porosi e transmetuar nga anëtarë është e gabuar apo se anëtarë gabimisht ka dështuar për të transmetuar një porosi.

2.2.8 Anëtarët do të përdorin tregtimin në tregun shqiptar të ditës më parë për të arritur balancën ndërmjet fluksit hyrës të energjisë elektrike dhe kërkesës për energji elektrike në secilën zonë ofertimi. Me qëllim që të kontrollohet, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kërkojë dokumentacion për bazat e anëtarit për porositë.

### 2.3 Gama e çmimit

2.3.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të vendosë për çdo ankand një gamë çmimesh brenda të cilit duhet të jenë të gjitha çmimet e porosive në Tregun Shqiptar të Ditës më Parë për atë ankand. Anëtarët do të informohen për gamën e çmimeve përpara hapjes së portës të porosive për secilin ankand.



2.3.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të ndryshojë gamën e çmimeve të vendosur duke dhënë një lajmërim 4 (katër) ditë përpara. Në rast të një ndryshimi të rangut të çmimit për ndonjë ankand, që pasohet nga hapja e porosive për atë ankand, të gjithë porositë e dërguara përpara një ndryshimi të tillë, do të fshihen automatikisht.

2.3.3 Çmimet për porositë do të kuotohen në një valutë të aprovuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike. Numri maksimal i shifrave pas presjes dhjetore që mund të kuotohen në çdo valutë është përcaktuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

#### 2.4 Mbyllja e portës

2.4.1 Jo më vonë se mbyllja e portës, çdo ditë anëtari do të dërgojë porositë e tij lidhur me ditën pasardhëse që fillon nga ora CET.

2.4.2 Porositë e marra pas mbylljes së portës do të konsiderohen nul dhe do të anulohen pavarësisht nga arsyeja që kanë. Për të evituar dyshimin, kjo aplikohet gjithashtu për porositë e marra pas mbylljes së portës për shkak të fuqisë madhore apo dështimit të komunikimit dhe pa marrë parasysh nëse anëtari është ose jo në ndonjë situatë mospagese.

2.4.3 Anëtarët që hasin vështirësi kur dërgojnë porosi në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike duhet të informojnë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike menjëherë.

#### 2.5 Ndryshimet e porosisë

2.5.1 Urdhrrat orarë të dorëzuar mund të anulohen nëse anëtari dorëzon një urdhër të ri ore që mbulon orën e njëjtë të dorëzimit. Në rast të disa urdhrave të orëve të dorëzuara nga i njëjti anëtar për të njëjtin orar dorëzimi, rendi, ora e fundit e marrë nga Shkëmbimi i Energjisë në Shqipëri do të jetë gjithmonë i vetmi urdhër i orës i cili konsiderohet i vlefshëm.

2.5.2 Anëtarët janë përgjegjës për të kontrolluar që urdhrat (dhe çdo ndryshim i tyre) të paraqitura dhe të marra nga Bursa Shqiptare e Energjisë të jenë të sakta dhe të vlefshme.

### 3. LLOJET E POROSISË

#### 3.1 Porositë orare

3.1.1 Porositë orare janë deklarata e anëtareve për dëshirën e tyre për të blerë apo shitur një volum specifik energjie elektrike në një zonë specifike ofertimi me një çmim specifik në një orë livrimi të dhënë të ditës së livrimit në fuqi.

3.1.2 Në çdo porosi orare, anëtari duhet të paraqesë një set me specifikime porosi çmimi dhe volum energjie për orën e livrimit në fuqi dhe zonën e ankandit, që fillon me volumin e energjisë në kufirin e poshtëm të porosisë së çmimit dhe më tej duke përfunduar me kufirin e volumit të energjisë në kufirin e sipërm të porosisë së çmimit. Hapat e tjerë të çmimeve mund të specifikohen siç është përcaktuar në specifikimet e produktit, shtojca 1.

3.1.3 Volumi i energjisë i dhënë në një porosi orare për shitje (ofertë), duhet të jetë konstant ose rritës me porosi çmimesh rritëse. Volumi i energjisë i dhënë në një porosi orare për blerje (kërkesë), duhet të jetë konstant ose zbritës me porosi çmimesh zbritëse.

3.1.4 Për të krijuar një kurbë porosie (kërkesë), Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, pas marrjes së një porosie (kërkesë) orare, do të ndërpusë vlerat në mes të çdo hapi çmimi në porosi (kërkesë) orare me anë të ndërfutjes lineare dhe porosia (kërkesë) orare do të konsiderohet të aplikohet për çdo vlerë të interpoluar në kurbën rezultante të kërkesës.

#### 4.2 Porositë bllok

4.2.1 Urdhërimet e bllokut janë deklarata e anëtarit për gatishmërinë për të blerë ose për të shitur një vëllim të specifikuar të energjisë në një zonë të veçantë të ofertimit me një çmim të caktuar në një bllok orar të dhënë në ditën e aplikueshme të shpërndarjes.

4.2.2 Në çdo bllok porosish, anëtari duhet të paraqesë një sërë bllok çmimesh dhe vëllime energjie për bllokun orar që do të aplikohet për Shpërndarjen dhe zonën e ofertimit, e cila fillon me vëllimin e energjisë në kufirin më të ulët të çmimit të porosisë dhe që përfundon me kufirin e vëllimeve të energjisë në kufirin më të lartë të çmimit të porosisë. Hapa shtesë për çmimin mund të specifikohen pasi të vendosen te specifikimet e produktit.

4.2.3 Vëllimi i energjisë i dhënë në një bllok porosie për shitje (ofertë) duhet të jetë konstant ose në rritje me rritjen e çmimeve të porosisë. Vëllimi i energjisë i dhënë në një bllok porosish për blerje (ofertë) duhet të jetë konstant ose në rënie me rritjen e çmimeve të porosisë.

4.2.4 Për të krijuar një kurbë të porosive, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, pas marrjes së një bllok porosish, do të vendosë



vlerat midis çdo hapi të çmimit në bllokun e porosisë me vendosje lineare dhe blloku i porosisë do të konsiderohet se zbatohet për secilën vlerë të vendosur te kurba e porosisë që ka rezultuar.

#### 4. PËRPUTHJA

##### 4.1 Informacion mbi procesin e përputhjes

4.1.1 Procesi i llogaritjes në të cilin porositë janë përputhur, është përcaktuar në përshkrimin publik të Algoritmit të Bashkimit të Tregut PCR (*Price Coupling Region* - Rajoni i Çmimit të Bashkuar), *Euphemia*, i aksesueshëm në *website*-in e *Nord Pool*-it.

4.2 Përputhja e porosive të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë dhe volumi i ankandit

4.2.1 Të gjitha porositë e dërguara për çdo orë livrimi do të konsiderohen si një pikë në kurbën e kërkesës për ofertat dhe kërkesat respektivisht, ku çdo kurbë kërkesë është krijuar duke futur vija të drejta ndërmjet kërkesave në kurbë. Pika e prerjes ndërmjet kurbave të ofertës dhe kërkesës agregate, krijon çmimin dhe volumin e energjisë të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë për çdo zonë ofertuese për atë orë livrimi.

4.2.2 Çdo disbalancë ndërmjet ofertave totale dhe kërkesave totale të shkaktuara nga rrumbullakosja e vlerave të volumeve për secilin anëtar, do të llogaritet sipas çmimit zonal të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë dhe do të ndahet ndërmjet anëtarëve, kërkesat e të cilëve janë pranuar, për sa i përket orës relevante të livrimit.

4.2.3 Të gjitha transaksionet në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë të lidhura me një orë livrimi, do të kryhen me çmimin zonal të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë, të lidhur me atë orë livrimi.

4.2.4 Të gjitha çmimet llogariten në euro.

##### 4.3 Procedura në rastin e mospërputhjes

4.3.1 Nëse pika e ndërprerjes ndërmjet kurbës së kërkesës për ofertat dhe kërkesat nuk është arritur “mospërputhje”, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të zbrisë porositë proporcionalisht derisa pika e ndërprerjes të arrihet.

4.3.2 Çdo disbalancë ndërmjet blerjeve totale dhe shitjeve totale, si pasojë e kufizimit të kërkesave gjatë llogaritjes precize në Bursën Shqiptare e Energjisë Elektrike, sipas nenin 4.3.1 të kësaj shtojce, do të ndahen ndërmjet gjithë anëtarëve brenda secilës zonë ofertuese.

#### 5. RIHAPJA NË RAST NDARJEJE TË PAPANASHIKUAR

5.1 Në rastin e ndarjes së paparashikuar ndërmjet zonës së Bursës së Energjisë Elektrike dhe çdo zone të tregut fqinj, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të shpallë rihapjen.

5.2 Gjatë rihapjes çdo anëtar mund të fusë apo rifusë kërkesa për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

5.3 Rihapja do të rishikojë për një periudhë të njoftuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe në përputhje me bashkimin e çmimit të NWE-së (Evropës Veriperëndimore)

#### 6. RAPORTET

##### 6.1 Raporti i çmimit

6.1.1 Në momentin që çmimet e zonës dhe volumet e energjisë të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë janë konfirmuar, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të informojë çdo anëtar për pozicionin e tij të konfirmuar të blerjes/shitjes nëpërmjet një raporti çmimi.

6.1.2 Raporti i çmimit specifikon çmimet e zonës dhe volumet e energjisë të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë për çdo orë livrimi dhe për çdo zonë të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë në të cilën kërkesa(t) janë përputhur.

6.1.3 Raportet e çmimeve do të jenë normalisht në dispozicion të anëtarëve në *web*-in e Një dite më parë, menjëherë pas konfirmimit përfundimtar të rezultateve të ankandit. Nëse raporti i çmimit është vonuar, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të njoftojë anëtarët për një vonesë të tillë sa më shpejt të jetë e mundur. Raportet e çmimeve do të dërgohen te secili anëtarë nëpërmjet një njoftimi të përcaktuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

##### 7. TRAJTIMI I GABIMEVE

7.1 Nëse anëtari bëhet koshient për gabimet në kërkesë(at), menjëherë do të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për gabime të tilla.

7.2 Në vijim të marrjes së një njoftimi, në përputhje me nenin 7.1 të kësaj shtojce, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të konsiderojë sipas gjykimit të saj nëse mund të merret ndonjë masë për të evituar apo lehtësuar ndonjë humbje të mundshme të anëtarit pa konfliktuar me çmimin e ankandit dhe interesin e tregut, me anëtarët e tjerë, apo me ndonjë detyrim të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.



## 8. VONESA OSE DËSHTIMI I ANKANDIT

8.1 Nëse Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike vonohet në kryerjen e një Ankandit, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të informojë anëtarët duke publikuar një mesazh operacional në *website*-in e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike me intervale të rregullta që fillojnë jo më vonë se 13:00 CET, deri në atë kohë, kur ankandi të përfundojë me sukses.

8.2 Nëse Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk është e aftë të përcaktojë çmimet e Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë, para orës 20:00 të ditës para ditës së livrimit, raporti i çmimit nga dita e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm orë pas ore (çmimeve të ankandit dhe volumeve të energjisë për ditën e livrimit në fjalë). Në këtë kontekst, “dita e mëparshme” do të thotë dita e mëparshme e punës nëse dështimi i ankandit ka efekt mbi një ditë pune dhe dita e mëparshme e fundjavës apo e festës zyrtare, sipas rastit, nëse dështimi i ankandit ka afekt mbi një ditë të shtunë, të diel apo pushim zyrtar. Ditë pune do të thotë ditët nga e hëna në të premte, duke mos përfshirë festat zyrtare të ligjshme, të cilat janë identifikuar si festa zyrtare në vendet në zonën e Bursës së Energjisë Elektrike së bashku që ka të paktën 67% të konsumit të vitit të kaluar. Festa e Krishtlindjeve (24/12) dhe festa e Vitit të Ri (31/12) janë konsideruar festa zyrtare.

### **RREGULLAT E TREGTIMIT *INTRADAY* (BRENDA DITËS)**

#### **RREGULLAT E TREGTIMIT - SHTOJCA 3 BURSA SHQIPTARE E ENERGIJË ELEKTRIKE**

##### 1. HYRJE

1.1 Tregu brenda ditës është një treg për tregtimin e vazhdueshëm të produkteve gjatë orëve të tregimit, ku transaksionet janë përputhur automatikisht kur porositë konkurruese janë regjistruar në ETS. Transaksionet mund të bëhen deri në një orë para livrimit.

1.2 Këto rregullore të tregut brenda ditës përmbajnë dispozita të detajuara mbi porositë dhe transaksionet në tregun brenda ditës dhe janë pjesë e rregullave të tregimit.

1.3 Produktet e tregtueshme në tregun brenda ditës dhe orët që zbatohen për tregtimin e tyre, janë listuar të specifikimet e produktit (shtojca 1).

## 2. RENDITJA

### 2.1 Kuotimi

2.1.1 Porositë duhet të jenë vetëm të tipave të porosive të lejuara nga specifikimet e produktit dhe duhet të lidhen me një produkt të specifikuar.

2.1.2 Çmimet e porosive do të tregojnë çmimin në euro për mwh. Për shembull, një porosi e kuotuar 22.60 do të thotë që çmimi i porosisë është 22.60 euro për mwh.

2.1.3 Volumi i porosisë tregon volumin maksimal për t'u blerë apo shitur në mwh.

2.1.4 Një porosi do të specifikojë informacionin e mëposhtëm me qëllim që të jetë i vlefshëm:

- a) Për pjesëmarrësin që e bën porosinë;
- b) Nëse porosia është një kërkesë apo një ofertë;
- c) Për tipin e porosisë në fuqi;
- d) Për kodin e kontratës në fuqi;
- e) Për kufirin e volumit të energjisë në fuqi (në mw);
- f) Për kufirin e çmimit të porosisë në fuqi (në euro/mwh); dhe
- g) Nëse është e aplikueshme dhe/ose të dëshirueshme: Çdo informacion shtesë, siç është mandatar dhe/ose lejuar nga: i) Rregullat e tregimit (duke përfshirë rregullat e sjelljes së tregut); dhe/ose ii) funksionimin mbizotërues të ETS-së.

2.1.5 Një porosi do të jetë e vlefshme nga koha e regjistrimit, në përputhje me nenin 2 dhe, derisa ajo të përputhet, hiqet apo ndryshohet ashtu siç specifikohet në nenet 2.3 apo 3, apo ka skaduar ashtu siç specifikohet në porosi.

### 2.2 Renditja e porosive

2.2.1 Porositë janë renditur si me poshtë:

- a) Porositë janë renditur sipas çmimit të blerjes;
- b) Porositë me të njëjtën çmim porosie janë renditur, bazuar në faktin se cila porosi është regjistruar e para në ETS;

2.2.2 Bllok porositë që nuk mund të përputhen mund të anashkalohen nga porosi të renditura si më pak të rëndësishme të cilat mund të përputhen.

### 2.3 Regjistrimi i porosive dhe përputhja

2.3.1 Porositë do të dërgohen në Bursën Shqiptare të Energjisë nëpërmjet ETS. Transaksionet janë përputhur automatikisht sapo porositë konkurruese janë regjistruar në ETS. Transaksionet që rezultojnë nga porosi që janë





përputhur në ETS, janë automatikisht në mënyrë të detyrueshme të regjistruara për shlyerje (pagesa).

2.3.2 Ndryshimet apo anulimet e një porosie në ETS bëhen të vlefshme kur regjistrohen në ETS, me kusht që porosia nuk ka qenë në përputhje sipas nenin 2.3.1 nga koha e regjistrimit të ndryshimit apo anulimit.

2.3.3 Në situatat kur ETS nuk funksionon ose nuk është i aksesueshëm nga pjesëmarrësit, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të aprovojë që pjesëmarrësi mund t'i telefonojë porositë apo ndryshimet apo anulimet e porosive, ashtu siç është përcaktuar më tej në termat e përgjithshëm të këtyre Rregullave Tregtimi.

2.3.4 Në rast të një pezullimi të përgjithshëm të tregtimit, të gjitha porositë në ETS do të çaktivizohen automatikisht. Me kthimin në operacione normale, pjesëmarrësit do të duhet të riaktivizojnë të gjithë porositë nga gjendja e tyre joaktive. Porositë të cilat janë të paaktivizuara nga fundi i ditës përkatëse të tregtimit do të hiqen.

2.3.5 Balanca e hapur në prodhim do të livrohet në rrejtin kryesor të zonës brenda ditës, ku mbajtësi i llogarisë është regjistruar në përputhje me rregullat për shlyerjet e disbalancave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në zonën e veçantë.

### 3. GABIMET E TREGTIMIT

3.1.1 Pjesëmarrësit të cilët dëshirojnë të anulojnë një transaksion si rezultat i një gabimi tregtar, duhet të përdorin funksionalitetin e fshirjes së tregtimit në ETS, jo më vonë se pesë (5) minuta pas kohës së kontratës për transaksionin përkatës.

3.1.2 Nëse anulimi nuk është i mundur në ETS, pjesëmarrësi duhet të lajmërojë me një kërkesë për anulim tryezën e tregtimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike nëpërmjet telefonit sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se pesë (5) minuta pas kohës së kontratës për transaksionin përkatës.

3.1.2 Asnjë kërkesë për një gabim tregtimi nuk mund të ngrihet në lidhje me një transaksion dhe çdo kërkesë për një gabim tregtimi do të jetë e pavlefshme:

a) Nëse kërkesa është bërë më vonë se afati i përcaktuar në nenin 3.1.1;

b) Nëse kërkesa është bërë më vonë se njëzetë (20) minuta para përfundimit të tregtimit për produktin në fuqi.

3.1.3 Pas marrjes së një kërkesë për anulim, në përputhje me nenin 3.1.1, procedurat e mëposhtme do të aplikohen:

a) Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të vendosë mbi bazën e përpyekjeve më të mëdha dhe në diskrecionin e saj të vetëm, një çmim të arsyeshëm reference të tregut për serinë përkatëse të produktit në kohën e kontratës të transaksionit përkatës. Çmimi i referencës së tregut do të përcaktohet në bazë të informacionit në dispozicion të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, duke përfshirë:

i) Çmimin e transaksionit paraardhës për produktin përkatës;

ii) Porositë e regjistruara në ETS;

iii) Paqëndrueshmërinë;

iv) Çmimin e Transaksioneve të konkluduara duke konsideruar Periudhën e Kontratës të Transaksionit përkatës;

v) Nëse informacioni në dispozicion të tregtimit është i kufizuar në ETS; çdo informacion tjetër të tregut që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike e konsideron relevant për të përcaktuar një çmim të drejtë reference të tregut për produktin përkatës.

b) Çmimi i referencës së Tregut i përcaktuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sipas germës “a”, të nenit 3.1.3, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do t'i shtojë marxhinat e devijimit prej +/- 50% (pesëdhjetë për qind) kundrejt çmimit të referencës së tregut.

c) Nëse çmimi i kontratës në transaksionin përkatës është jashtë marxhinave të devijimit, Transaksioni përkatës do të anulohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike. Çdo anulim është subjekt i disponueshmërisë së kapacitetit të transmetimit në rast se tregtitë ndërkufitare janë përfshirë.

3.1.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike rezervon të drejtën edhe nëse kushti në paragrafin 3.1.1–3.1.3 është plotësuar, të refuzojë një kërkesë për anulim, nëse për shkaqe teknike ose operacionale Shkëmbimi Shqiptar i Energjisë nuk është në gjendje të anulojë efektisht transaksionin.

3.1.5 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund, nëse çmimi i kontratës së një transaksioni është jashtë marxhinës të devijimit, të iniciojë një proces konsultimi me palët e përfshira, në përputhje me nenin 3.1.3.



3.1.6 Palët në transaksionin përkatës do të mbeten anonimë gjatë diskutimeve, siç parashikohet në këtë nen.

3.1.7 Pas anulimit të suksesshëm Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të njoftojë tregun me anë të një mesazhi për tregun në ETS se transaksioni është anuluar.

3.1.8 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike duhet brenda pesëmbëdhjetë (15) minutash nga regjistrimi i transaksionit në ETS, të anulojë të gjitha transaksionet që përfshijnë gabime të regjistrimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, qoftë nga pakujdesia apo nga shkaqe të tjera. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të njoftojë menjëherë tregun përmes ETS që transaksioni është anuluar dhe do të regjistrojë një transaksion të ri në kushtet e duhura.

3.1.9 Një pagesë shërbimi, e specifikuar në listën e çmimeve të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, do të paguhet për çdo kërkesë anulimi të bërë ndaj Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, pavarësisht nëse kërkesat çojnë në anulimin e transaksionit apo jo.

#### 4. PEZULLIMI I TREGTIMIT

4.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të pezullojë tregtimin në ETS nëse Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike beson se është e nevojshme, nëse ka gabime teknike apo mirëmbajtje në ETS apo problem në sistemet elektrike.

4.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike duhet deri në masën e mundshme të informojë pjesëmarrësit për pezullimet.

4.3 Të gjithë porositë në ETS do të çaktivizohen automatikisht përpara se ETS-ja të rihapet, por do të mbeten të ruajtura në ETS, për aq sa kjo është teknikisht e mundur, duke aplikuar përpjekje tregtare të arsyeshme.

#### SITUATAT E NDËRPRERJEVE TË ENERJISË ELEKTRIKE

5.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund që në kushtet e një situatë kombëtare të ndërprerjes së energjisë elektrike, ashtu siç përcaktohet nga OST-të përkatëse, të pezullojë tregtimin dhe/ose anulojë një apo më shumë porosi apo transaksione.

5.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike duhet që menjëherë pas marrjes së informacionit të problemeve nga ana e OST-së, të njoftojë pjesëmarrësit për kohëzgjatjet e vlerësuara

nëpërmjet njoftimit elektronik në ETS ose me mjete të tjera që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike i shikon të arsyeshme.

5.3 Situatat problematike në sistemet elektrike që përfshijnë palët e vetme nuk do të kenë një efekt mbi detyrimet fikse të livrimeve të energjisë elektrike apo transaksioneve, të konkluduara nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike. Pala do të përmbushë detyrimet e veta kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, pavarësisht situatës së krijuar. Pasojat e një situatë problematike do të mbeten për t'u paguar ndërmjet palës dhe mundësisht iniciuesit të problemeve, ashtu si edhe furnitorit të hapur të palës.

5.4 Tregtimi në tregun e ditës përpara do të mbahet i hapur edhe nëse ka çrregullime në sistemin e energjisë elektrike që ndikojnë transferimin, konsumin apo prodhimin e energjisë elektrike nga ana e një pale të vetme.

#### 6. INFORMACIONI I TREGUT

6.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të furnizojë pjesëmarrësit gjatë çdo dite tregtimi, me informacion për të gjithë porositë dhe transaksionet e regjistruara në ETS, mbi baza anonime. Një informacion i tillë transaksionesh do të bëhet disponibël nëpërmjet ETS-së ku Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në gjykimin e vet vendos që kompensimi për një informacion të tillë është përfshirë në tarifën e anëtarësimit.

6.2 Informacioni i transaksionit do të përfshijë informacion mbi çmimet dhe volumet e porosive dhe transaksioneve, renditjen e porosive, kohën në të cilën një transaksion është kryer dhe çdo anulim apo ndryshim të transaksioneve.

6.3 Shkëmbimi i informacionit mund të bëhet vetëm midis pjesëmarrësit të tregut dhe operatorit të tregut dhe anasjellas ose operatorit të tregut dhe pjesëmarrësve të tregut, në një fazë të mëvonshme, megjithatë nuk duhet të lejohet që informacioni i ndjeshëm tregtar të lejohet identifikimin e pjesëmarrësit të tregut.

6.4 Sistemi i operimit të tregut, ndër të tjera, do të mundësojë një shkëmbim *online* të informacionit sa më sipër përmendur.



**RREGULLAT  
E ADMINISTRIMIT TË TREGUT  
RREGULLAT E TREGUT  
SHTOJCA 4  
BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË  
RREGULLAT E ADMINISTRIMIT TË  
TREGUT**

**1. HYRJE**

1.1 Këto Rregulla të Administrimit të Tregut janë nxjerrë nga Bursa Shqiptare e Energjisë mbi Rregullat e Tregut për Tregun Shqiptarë të Ditës në Avancë. Dispozitat në këtë dokument zbatohen te të gjithë pjesëtarët e Bursës Shqiptare të Energjisë në Tregun Shqiptarë të Ditës në Avancë.

1.2 Është përgjegjësi e secilit anëtar të veprorë në përputhje me Rregullat e Administrimit të Tregut në lidhje me të gjithë pjesën e organizimit. Çdo anëtar, duhet të sigurojë që çdo person i përfshirë në tregtim dhe/ose faturim në emër të tij, duke përfshirë pjesëtarët të administratës dhe të tjerët që marrin vendime në lidhje me produktet përmes ushtrimit të detyrës, profesionit ose funksioneve të pjesëmarrësve, janë subjekt i kufizimeve dhe detyrimeve që i mundësojnë anëtarit të përmbushë në mënyrë efikase Rregullat e Administrimit të Tregut.

1.3 Me përjashtim të udhëzimeve nga Bursa Shqiptare e Energjisë ose të përcaktuara ndryshe në këtë dokument, tregu mbikëqyrës do të ketë autoritetin për të përfaqësuar dhe vepruar në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë për të gjitha çështjet që rregullohen nga Rregullat e Administrimit të Tregut në adresim të “Bursës Shqiptare të Energjisë”, në këtë dokument do të interpretohet në përputhje me të. Tregu mbikëqyrës ka autoritetin të bëjë kërkesa për informacion siç parashikuar në nenin 6.1, si dhe të nxjerrë paralajmërime jopublike, siç parashikohet në nenin 8.2, pa përfshirë këtu lajmërimet publike ose shlyerjen e gjobës.

**2. PAJTUESHMËRIA ME LIGJIN E APLIKUESHËM**

2.1 Çdo anëtar duhet në çdo kohë të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe Rregullat e Administrimit të Tregut.

**3. INTERPRETIMI**

3.1 Termat në Rregullat e Administrimit të Tregut do të kenë, nëse nuk ka përcaktim në këtë dokument, kanë kuptim të njëjtë me ato të

përkufizimeve në termat e përgjithshëm në Rregullat e tregtimit.

3.2 “Informacion i brendshëm”, për qëllime të Rregullave të Administrimit të Tregut, termi ka të bëjë me informacionin që nuk është bërë ende publik, i cili lidhet direkt ose indirekt, me një ose më shumë produkte dhe, që po të ishte bërë publik, mund të ndikonte në çmimet e këtyre produkteve.

a) Termi “informacion” do të thotë:

i) Informacion që është kërkuar të bëhet publik në përputhje me këto Rregulla, kontrata apo praktika të Tregut Shqiptar të Ditës në Avancë, me kusht që ky informacion të ketë një efekt të rëndësishëm në çmimet e produkteve;

ii) Informacioni që është kërkuar të bëhet publik në përputhje me ligjin në fuqi, duke përfshirë rregullat e nxjerra nga ndonjë organ rregullator me kusht që ky informacion të ketë një efekt të rëndësishëm në çmimet e produkteve;

iii) Informacione të tjera që një anëtar mund të përdorë si pjesë e parimit bazë për hyrjen në një shitblerje ose porositjen e një produkti.

b) Termi “natyre të caktuar” do të thotë informacion që parashikon një sërë rrethanash të cilat ekzistojnë ose, në mënyrë të arsyeshme mund të pritët që të vijnë në ekzistencë ose një ngjarje e cila ka ndodhur, ose në mënyrë të arsyeshme pritët që të ndodhë dhe nëse është specifikuar mjaftueshëm mundëson arritjen në përfundimin e një efekti të mundshëm për atë grup rrethanash ose ngjarjesh, të tillë që mund të ndikojë në çmimin e produktit.

3.3 Në rast konflikti midis këtyre rregullave dhe dispozitave të Rregullave të Tregut, që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet parimeve të zbatueshme të interpretimit, Rregullat e Tregut do të mbizotërojnë për sa ka lidhje me çështjet që trajtohen nga këto Rregulla.

3.4 Rregullat e Administrimit të Tregut janë të detyrueshme për zbatim nga anëtarët.

**4. SJELLJA E MIRË NË BIZNES**

4.1 Anëtarët, duhet që në çdo rast të veprojnë në përputhje me këto Rregulla, kur përfshihen në tregti ose aktivitete me produktet dhe duhet të kërkojnë integritet dhe eficiencë nga Tregu Shqiptar i Ditës në Avancë. Anëtarët duhet të marrin përsipër çdo detyrim rregullator ose ligjor, çdo standard të përshtatshëm profesional, si dhe



nevojën e tregut të ditës në avancë që të operojë ndershmërisht dhe me eficiencë për të gjithë pjesëtarët.

4.2 Çdo anëtar duhet të sigurojë që çdo porosi e vendosur nga ai, të reflektojë një blerje apo shitje të vërtetë dhe se të gjitha transaksionet në të cilat është palë janë të vërteta.

4.3 Një anëtar nuk mund të ndikojë në asnjë mënyrë çmimin ose strukturat e çmimit të Tregut Shqiptar të Ditës në Avancë ose të pengojë hyrjen e pjesëmarrësve të tjerë në treg.

4.4 Pjesëtarët nuk duhet të aplikojnë metoda të paarsyeshme në tregti dhe duhet të kërkojnë gjithmonë të zbatojnë praktikën e biznesit më të mirë.

## 5. KËRKESAT PËR TRANSPARENÇË

5.1 Çdo pjesëtar duhet të bëjë publik çdo informacion i cili është vendosur në këtë nen lidhur me Tregun Shqiptar të Ditës në Avancë për energjinë elektrike, lidhur me biznesin ose objektet për të cilat anëtari në fjalë zotëron ose kontrollon ose për çështje për të cilat anëtari është përgjegjës në tërësi, ose pjesërisht.

Këto informacione të kërkuara nuk kanë lidhje me informacionin e planifikimit dhe strategjitë e ndjekura nga pjesëmarrësi.

Informacioni duhet të mendohet për të ardhmen e Tregut Shqiptar të Ditës në Avancë nëse ky informacion lidhet me biznesin brenda tregut energjetik shqiptar.

5.2 Informacioni që mund të bëhet publik, sipas nenit 5.1, do të kufizohet vetëm në informacionin që lidhet me lehtësimin në prodhim, konsum ose transmetim të energjisë elektrike që kanë të bëjnë me:

a) Çdo ndërprerje, kufizim, zgjerim ose ndarje e kapacitetit 100 mw ose më shumë, për një njësi prodhimi ose njësi konsumi ose 100 mw, ose më shumë për një njësi prodhimi me një kapacitet të instaluar prej 200 mw ose më shumë, deri në 3 vite më parë, përfshirë azhurnimin e këtij informacioni;

b) Çdo ndërprerje, ngushtim, kufizim, përhapje ose çmontim i kapacitetit në rrjetin e transmetimit duke afektuar kapacitetet ndërzonale nga 100 mw ose më shumë, deri në 3 vite më parë, përfshirë azhurnimin e këtij informacioni;

c) Çdo ndërprerje, ngushtim, kufizim, përhapje ose ndarje e kapacitetit në rrjetin e

transmetimit, duke afektuar ushqim me energji elektrike dhe/ose konsumin nga 100 mw ose më shumë, deri në 3 vjet më parë, përfshirë azhurnimin e këtij informacioni;

d) Çdo porosi e humbur ose me të meta e kryer në Tregun Shqiptar të Ditës në Avancë nga 200 mw ose më shumë;

e) Çdo informacion që mund të ndikojë në mënyrë të ndjeshme çmimet e një ose më shumë derivate bazuar në produktet nëse bëhen publike;

f) Çdo Informacion i brendshëm i pa përfshirë në paragrafët “a” dhe “e”.

5.3 Kur informacioni është subjekt kërkesave për transparencë sipas nenparashikimeve të nenit 5, ndarja e informacionit me publikun do të përmbajë një minimum të informacionit mbi:

a) Njësitë e gjenerimit, njësitë e prodhimit, njësitë e konsumit ose linjës;

b) Koha e marrjes së vendimit ose përsëritja e ngjarjes;

c) Kapaciteti i instaluar në mw;

d) Kapaciteti i disponueshëm në treg në mw;

e) Koha e parashikuar e nisjes dhe e mbylljes së ngjarjes;

f) Shkaku i ngjarjes;

g) Nëse informacioni lidhet me ndërprerjen, përhapjen ose ndarjen e kapacitetit duke afektuar 400 mw ose më shumë, brenda 3 viteve kalenderike, një ndikim pasigurie lidhur me zgjatjen e ngjarjes do të shfaqet në shkallë nga 1 deri në 6 si më poshtë:

1. +/- 6 orë;

2. +/- 24 orë;

3. +/- 3 ditë;

4. +/- 7 ditë;

5. +/- 31 ditë;

6. TË TJERA.

5.4 Çdo Informacion që do të publikohet sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, duhet të publikohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 60 minuta nga koha e ngjarjes e cila sjell këtë informacion. Një informacion i tillë do të shfaqet publikisht si një mesazh tregu urgjent (MTU).

a) Një anëtar mundet që, duke mbajtur vetë përgjegjësi, në raste të veçanta, të vonojë publikimin e informacionit në mënyrë të tillë që të mos cenojë interesin e tij legjitim dhe me kusht që një vonesë e tillë të mos konfuzojë publikun dhe me kusht që anëtari është i aftë të



garantojë konfidencialitetin e atij informacioni dhe nuk do të marrë vendime që lidhen me tregtimin e produkteve, bazuar mbi këtë informacion.

b) Kur një anëtar ose një person i punësuar nga ai, ose që vepron në emër të tij, shfaq informacionin siç është parashikuar në nenin 5, në ushtrimin normal të funksionit nga punonjësi i tij, profesioni ose detyrimet, ai pjesëmarrës ose person duhet të sigurojë njëkohësisht bërjen publike për atë informacion lidhur me pikën 5.4, paragrafi i parë. Në ngjarjet e rrjedhjes së informacionit jo të qëllimshme, pjesëmarrësi i tregut duhet të sigurojë bërjen publike të plotë dhe efektive të informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur, duke ndjekur rrjedhjen e paqëllimshme të këtij informacioni. Ky nen nuk do të zbatohet nëse një person merr një informacion kur ka për detyrë konfidencialitetin, pavarësisht nëse ky detyrim buron nga ligji, rregullat, nenet e kontratës.

5.5 Në rastin e MTU-së, në lidhje me një kufizim, ndërprerje, përhapje apo çmontim të kapacitetit duke afektuar 400 mw ose më shumë, ku në të cilën Bursa Shqiptare e Energjisë përcakton në diskrecionin e saj absolut që një MTU nuk përshkruan informacionin e përshtatshëm ose ka pasur disa mesazhe të tilla për të njëjtën ngjarje, Bursa Shqiptare e Energjisë mund t'u kërkojë pjesëmarrësve të paraqesin një informacion të zgjeruar në treg. Informacioni i detajuar duhet t'u përmbahet kërkesave të Bursës Shqiptare të Energjisë. Bursa Shqiptare e Energjisë mund të vendosë një afat të arsyeshëm për paraqitjen e MTU-së dhe MTU-së mund të publikohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë.

## 6. DETYRIMI PËR T'I DHËNË INFORMACION BURSËS SHQIPTARE TË ENERJISË

6.1 Në zbatim të nenit 6, anëtarët janë të detyruar të sigurojnë të gjithë informacionin që Bursa Shqiptare e Energjisë konsideron të përshtatshëm, si në kontekstin e performancës së rolit të saj monitorues ose në kontekstin e çdo hetimi të ndonjë shkeljeje të Rregullave të Administrimit të Tregut që dyshohen të jenë shkelur ose të pajtohet me ligjin në fuqi, sa më shpejt që të jetë e mundur, bashkëlidhur me të dhe një kërkesë nga Bursa Shqiptare e Energjisë. Anëtarët duhet të kryejnë të gjitha masat e

nevojshme me palët e treta në mënyrë që të sigurojnë që ata janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre sipas këtij neni.

6.2 Anëtarët duhet të sigurojnë që zyrtarët e tyre, të punësuarit, agjentët dhe personeli mbështetës duhet t'i përmbahen detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 6.1 të këtij neni.

6.3 Çdo anëtar pranon që:

a) Bursa shqiptare e energjisë mundet që herë pas here, pavarësisht nëse një informacion i caktuar është marrë në kontekstin e një hetimi apo jo, të sigurojë informacionin mbi aktivitetin tregtar ose informacione të tjera të rëndësishme tek autoriteti rregullator përkatës. Ky informacion mundet t'iu sigurohet gjithashtu edhe ekipeve të mbikëqyrjes së tregut të tregjeve të tjera përkatëse ose OST-ve, gjithmonë me kusht që të ketë një marrëveshje të shkruar ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë dhe një tregu përkatës ose OST-së, që kufizon përdorimin e informacionit të përbashkët për qëllim të tregut mbikëqyrës dhe duke garantuar trajtimin konfidencial të këtij informacioni;

b) Të gjitha komunikimet me Bursën Shqiptare të Energjisë dhe ekipet mbikëqyrëse të tregut duhet të regjistrohen, të ruhen dhe të përdoren për monitorimin e përputhshmërisë së tyre me ligjin e aplikueshëm dhe Rregullat e Administrimit të Tregut. Çdo anëtar duhet të sigurojë miratimin e nevojshëm nga të gjithë përfaqësuesit, punonjësit dhe agjentët e tij, përpara se të komunikojë me Bursën Shqiptare të Energjisë në emër të anëtarit.

6.4 Komunikimet ndërmjet anëtarëve dhe Bursës Shqiptare të Energjisë mund të përfshijë të dhëna lidhur me individët në masë që një informacion i tillë të përbëjë informacion të përshtatshëm apo është i nevojshëm.

6.5 Parashikimet e nenit 6 nuk do të interpretohen në kundërshtim me detyrimin e një anëtari për të zbatuar legjislacionin në fuqi.

6.6 Informacioni i marrë në përputhje me nenin 6, do të përdoret vetëm për qëllim të mbikëqyrjes së Rregullave të Administrimit të Tregut dhe ligjit në fuqi, përfshirë hetimin e shkeljeve të dyshuara.

## 7. PUBLIKIMI I INFORMACIONIT LIDHUR ME HETIMIN

7.1 Bursa Shqiptare e Energjisë mund të bëjë publik fillimin e hetimit për çdo çështje të veçantë, duke siguruar që identiteti i anëtarit të mos shfaqet. Bursa Shqiptare e Energjisë mund



të bëjë publik identitetin e një anëtari nën hetim, vetëm nëse në diskrecion të Bursës Shqiptare të Energjisë, një publikim i tillë është i nevojshëm për të mbështetur integritetin e tregut ose të parandalojë dëme të pajustificuara dhe/ose humbjen e reputacionit të një anëtari tjetër dhe, nëse pasojat e parashikuara të publikimit të identitetit konsiderohen më pak të dëmshme sesa ato për shkak të publikimit. Një anëtar, identiteti të cilit i është bërë publik emri në përputhje me këtë nen mund të kërkojë nga Bursa Shqiptare e Energjisë të shfaqë dhe bëjë publike rezultatet e këtij hetimi.

7.2 Bursa Shqiptare e Energjisë mund ta bëjë publike rezultatit e çdo hetimi i cili çon në një paralajmërim publik ose shkelje të këtyre rregullave, sipas nenit 8, duke përfshirë edhe identitetin e anëtarit. Bursa Shqiptare e Energjisë mund të riprodhojë dhe/ose të publikojë çdo informacion të mbledhur nga hetimi deri në atë masë që referenca të tilla të jenë të arsyeshme për Bursën Shqiptare të Energjisë, në lidhje me vendimin e tij ose arsyet e vendimit të tij. Bursa Shqiptare e Energjisë do të publikojë informacionin sipas nenit 7 në mënyrë të paanshme, duke njoftuar paraprakisht anëtarin që është subjekt i hetimit dhe/ose masave disiplinore.

## 8. MASAT DISIPLINORE

8.1 Çdo shkelje e këtyre Rregullave të Administrimit të Tregut do të konsiderohet si ngjarje e papajtueshmërisë ose ngjarje thelbësore e papajtueshmërisë në përputhje me Rregullat e tregtimit - Termat e përgjithshëm.

8.2 Në rastin e një ngjarje të papajtueshmërisë, siç është parashikuar më sipër në nenin 8.1, Bursa Shqiptare e Energjisë ka të drejtën të nxjerrë një njoftim jopublik lidhur me shkeljen e anëtarit, duke kërkuar që anëtari të shmangë shkakun i cili ka çuar në shkelje, brenda 15 ditëve kalendarike, pas njoftimit që Bursa Shqiptare e Energjisë ka dërguar njoftimin e shkeljes anëtarit.

8.3 Në rast se shkelja e parashikuar sipas nenit 8.2 të këtyre rregullave nuk është korrigjuar sipas njoftimit të dhënë, kjo shkelje do të konsiderohet si ngjarje thelbësore e papajtueshmërisë dhe do të zbatohen nenet 10.3 dhe 10.4 të Rregullave të tregtimit – Kushtet e përgjithshme.

8.4 Asgjë në këtë nen nuk do të kufizojë të drejtat dhe detyrimet e një anëtari sipas ligjit në fuqi dhe çdo veprim disiplinor i vendosur më

poshtë do të jetë në shtesë të çfarëdo lloj veprimi disiplinor ose gjobave të vendosura nga subjekte të tjera përveç Bursës Shqiptare e Energjisë në përputhje me ligjin në fuqi.

## 9. PROCEDURAT PËR HETIMIN E SHKELJES DHE MASAVE DISIPLINORE

### 9.1 Të përgjithshme

a) Në këtë nen përcaktohen procedurat që ndiqen për hetim nga/ose në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë për shkeljet e mundshme të këtyre rregullave ose ligjit në fuqi.

### 9.2 Hetimet dhe rekomandimet e mbikëqyrjes së tregut

a) Nëse mbikëqyrësi i tregut dyshon nëse ka një shkelje të Rregullave të Administrimit të Tregut ose ligjit në fuqi, mund të fillojë një hetim. Hetime të tilla mund të fillohen me iniciativën e mbikëqyrësit të tregut, pavarësisht nëse anëtari ka njohuri për përfshirjen.

b) Nëse mbikëqyrësi i tregut ka dyshime për shkeljen e këtyre Rregullave, mundet që me gjykimin e tij të njoftojë Bordin Rregulator:

i) Nëse mbikëqyrësi i tregut ka dyshime për shkeljen e këtyre Rregullave, mundet që në gjykimin e tij, të rekomandojë masa disiplinore kundër anëtarëve të përfshirë, siç parashikohet edhe më poshtë;

ii) Mbikëqyrësi i tregut mund të nxjerrë njoftime paraprake jopublike për anëtarët, siç përcaktohet në nenin 8.2 të kësaj Rregulloreje, pa konsultimin me Bordin e Drejtorëve të Bursës Shqiptare të Energjisë.

iii) Nëse hetimi i kryer nga mbikëqyrësi i tregut ka dyshime për shkelje të ligjit në fuqi, mundet që në gjykimin e tij, të raportojë te Bordi Rregulator.

### 9.3 Vendimi i Bursës Shqiptare të Energjisë

a) Bordi drejtues i Bursës Shqiptare të Energjisë në gjykimin e plotë të tij, do të vendosë masën disiplinore që do të zbatohen kundrejt anëtarit. Bordi Drejtues i Bursës Shqiptare të Energjisë mund t'ia delegojë këtë vendim Drejtorit Ekzekutiv të Bursës Shqiptare të Energjisë.

b) Vendimi i Bursës Shqiptare të Energjisë do t'i njoftohet me shkrim anëtarit përkatës. Në rastin kur Bursa Shqiptare e Energjisë publikon vendimin, anëtari duhet të njoftohet përpara publikimit të këtij vendimi.



**RREGULLAT  
E SHLYERJEVE DHE TË PAGESAVE  
RREGULLAT E TREGTIMIT  
SHTOJCA 5  
BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

**1. HYRJE**

1.1.1 Këto Rregulla aplikohen për të gjitha produktet e shlyerjeve dhe të pagesave në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë.

1.1.2 Pagesat janë iniciuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, duke hyrë në një transaksion si kundërpalë qendrore dhe duke regjistruar transaksionin në llogaritë e pagesave të mbajtësve të Llogarive të përfshira.

1.1.3 PAGESA është subjekt i tarifave të përcaktuara në listën e tarifave.

1.1.4 Këto rregulla përbëjnë një kontratë ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe çdo mbajtësit të llogarisë për sa i përket pagesës dhe plotësojnë marrëveshjet përkatëse të Anëtarëve dhe Rregullave të tregut - Termat e përgjithshëm.

**2. KËRKESAT PARAPRAKE PËR PAGESËN**

2.1 Kategoritë e anëtarësimit dhe kërkesat

2.1.1 Vetëm personat juridikë mund të aplikojnë për anëtarësim. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mundet që në rrethana të veçanta dhe nën gjykimin e saj, të devijojë nga kjo kërkesë.

2.1.2 Një anëtarë i ardhshëm duhet, me kërkesë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, të jetë në gjendje për të dokumentuar se posedon të gjitha autorizimet e kërkuara të kategorisë së tij të anëtarësimit.

2.2 Vlefshmëria e kundërpalës

2.2.1 Vetëm anëtarët janë të vlefshëm si kundërpalë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike në transaksionet e pagesave. Për të qenë i vlefshëm si kundërpalë për transaksionet e pagesave, anëtari duhet në kohën kur transaksioni i pagesës është regjistruar:

a) Të ketë emëruar një përgjegjës për pagesat;  
b) Të ketë krijuar një apo më shumë portofol(a) tregtimi;

c) Të ketë krijuar një ose më shumë llogari *cash* për qëllime shlyerjeje për të qenë ose një llogari *cash* garancie ose një llogari *cash* e jogarancie;

d) Të ketë krijuar një ose më shumë llogari pagese (*cash*);

e) Të ketë krijuar një kolateral si një llogari *cash* garancie ose garancie mbi bazën e kërkesës dhe të ketë përmbushur garancinë e tij të dhënë nëpërmjet telefonit; dhe

f) Të mos ketë akses në pagesat e pezulluara apo të përfunduara, në përputhje me Rregullat e Tregut.

2.2.2 Anëtarët duhet në çdo kohë dhe menjëherë pas kërkesës nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, të jenë në gjendje të dokumentojnë që ata plotësojnë kriterin e nenit 0 të kësaj rregulloreje.

2.3 Detyrimet e vazhdueshme të informacionit për anëtarët

2.3.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund që në çdo kohë të kërkojë dhe të marrë informacion mbi kredinë në mënyrë që të monitorojë nivelin e qëndrimit dhe saktësisë financiare të kompetencës dhe çështjeve të tjera përkatëse (sipas Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike) për statusin financiar dhe ligjor të anëtarit, përfshirë autorizimet e kërkuara. Çdo anëtarë pajtohet menjëherë për të siguruar informacion dhe dokumente të tilla si Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund t'i kërkojë dhe t'i kërkojë çdo pale tjetër që mbajnë informacione ose dokumente në emër të anëtarit, të japin informacion ose dokumente të tilla.

2.3.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, pa u penguar nga ndonjë detyrë konfidencialiteti i mbajtësit të informacionit, mund të kërkojë dhe të marrë informacion dhe dokumente (aty ku janë të disponueshme) nga banka(t) e anëtarit ose burime të tjera përkatëse të informacionit për të cilën Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike e konsideron të përshtatshme. Anëtari menjëherë duhet të sigurojë që informacioni i kërkuar shtesë t'i ofrohet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

2.3.3 Anëtari do të njoftojë menjëherë me shkrim Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike sapo anëtari të jetë në dijeni për ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme që do të ndodhë në lidhje me të:

a) Çdo ngjarje që nuk përputhet me Rregullat e Tregut apo procedurat disiplinore, penale apo rregullatore të lidhura me aktivitetet e tregtimit dhe pagesave që përfshijnë anëtarin ose Bordin e



Drejtorëve e tij të apo punonjësit e përfshirë në pagesën e tij me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike;

b) Çdo çështje tjetër që lidhet me të, për të cilën një anëtar duke vepruar në mënyrë të arsyeshme në interes të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike lidhur me pagesat dhe pozicionin e tij si anëtar.

### 3. STRUKTURA E LLOGARISË

#### 3.1 Portofoli i tregtimit

3.1.1 Secilit anëtar i jepet portofoli i tregtimit për Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë, në përputhje me marrëveshjen e tyre të pjesëmarrësit apo të klientit.

3.1.2 Transaksionet e kryera nëpërmjet portofolit(ave) të tregtimit transferohet në llogaritë/depozitat përkatëse.

#### 3.2 Llogaritë e pagesave

3.2.1 Kur një anëtar aprovon, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të krijojë të paktën një llogari (1) pagese me anëtarin.

3.2.2 Çdo llogari pagese është e shoqëruar me një apo më shumë portofola tregtimi të anëtarit dhe është gjithashtu e shoqëruar me një ose më shumë llogari *cash*.

3.2.3 Thirrjet për kolateral (të BSHEE-së) dhe shumat e shlyerjeve *cash* do të llogariten veçmas për secilën llogari pagesash.

#### 3.3 Llogaritë *cash*

3.3.1 Secili anëtar duhet që me shpenzimet e tij të krijojë dhe të mirëmbajë të paktën një llogari *cash* në një bankë për shlyerjet e aprovuara nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, me një valutë të miratuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

### 4. PROCEDURAT E PAGESAVE

4.1 Transaksionet e përfunduara në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë

4.1.1 Transaksionet e përfunduara në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë janë automatikisht dhe në mënyrë të detyrueshme subjekt i pagesave, në përputhje me Rregullat e Tregut në fuqi.

4.1.2 Pas përfundimit të transaksionit, rezultati do t'i alokohet llogarisë së pagesave në fuqi.

4.1.3 Anëtarët kanë detyrimin për të dhënë (shitur) ose për të marrë (blerë) sasitë e specifikuar të livrimit. Mosdhënia ose mosmarrja do të zgjidhet me palën përgjegjëse

për balancimin ose Operatorin e Sistemit të Transmisionit, në përputhje me rregullat në fuqi, pa ndikimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

4.1.4 Shlyerjet e pagesave do të bazohen në transaksione të regjistruara vetëm nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe nuk do të pasqyrojnë mosdhënien dhe mosmarrjen.

#### 4.2 Shlyerjet cash

4.2.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të sigurojë informacion për secilën llogari pagese të anëtarit, duke përfshirë informacion rreth shlyerjes *cash* dhe kolateralit.

4.2.2 Për secilën ditë pagese, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të deklarojë për çdo transaksion, i cili përmban shumën neto për portofolin e tregtimit që prej ditës së mëparshme të pagesës, në kohën kur është përcaktuar në programin e pagesës. Këto deklarata përbëjnë bazën për shlyerjet në *cash* që do të mbahen ditën e shlyerjesh së pagesës.

4.2.3 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lëshon fatura vetëm për anëtarët, sipas nenit 4.2.2 të kësaj shtojce. Gjithashtu, anëtarët duhet të paguajnë me tarifa variable, siç është përcaktuar në listën e tarifave. Deklaratat do të lëshohen në të njëjtën valutë si porosi. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike i dërgon faturat anëtarit, me shkrim nëpërmjet *e-mail*-it, në adresën e shënuar në marrëveshjen e anëtarësisë.

4.2.4 Fatura maturohet në Ditën e parë të Pagesës pas ditës së faturimit. Shuma e detyrimit do të jetë në dispozicion në llogarinë rrjedhëse të anëtarëve brenda orës 11:00 në ditën e pagesës me datë valute të barabartë me datën e maturimit dhe në valutën përkatëse të tregtimit.

4.2.5 Shumat e dhëna në faturë do të depozitohen në llogarinë rrjedhëse të anëtarëve me datë valute, jo më vonë se ditën e dytë të pagesës pas ditës së faturës dhe në valutën përkatëse të tregtimit.

#### 4.3 Kërkesat për kolateral

4.3.1 Çdo anëtar duhet që me shpenzimet e tij të krijojë dhe mirëmbajë kolateralin, në përputhje me Rregullat e pagesave dhe të sigurojë që vlera e kolateralit të tij të postuar në çdo kohë plotëson thirrjet e aplikueshme të kolateralit.

4.3.2 Anëtarët mund të zgjedhin që të ofrojnë kolateral përmes njëres ose një kombinimi të formave të mëposhtme:





- i) *Cash* i depozituar në llogarinë(të) rrjedhëse;
- ii) Garanci bankare e pranuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

4.3.3 Kolateralët të cilët janë depozituar nga anëtarët mund të përdoren si kolateral për të gjitha detyrimet e anëtarëve kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike që rrjedhin nga aktivitetet e anëtarit në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe nga anëtarësimi i tij. Kolateralët u referohen të gjitha detyrimeve kontraktuale dhe jokontraktuale të cilat mund të rrjedhin prej anëtarëve, përfshirë pagesën e çmimit të maturuar për produktet, tarifat e tregtimit, parashikimi i normës së interesit sipas detyrimeve monetare, si dhe të gjitha dëmshpërblimet që i detyrohen Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, duke përfshirë dëmet ose shpenzimet e bëra nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, për shkak të pretendimeve të palëve të treta, TVSH-së, doganave apo kapaciteteve ndërkufitare.

4.3.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike kërkon minimumin e kolateralit nga të gjithë anëtarët. Thirrja minimale e kolateralit mund të rregullohet në diskrecion të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike. Kolaterali minimal duhet të krijohet përpara fillimit të tregtimit. Thirrja e kolateralit mund të përcaktohet individualisht, sipas kategorive të anëtarëve apo për të gjithë anëtarët.

4.3.5 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të përcaktojë thirrjet e kolateralit për anëtarët e rinj, bazuar në parashikimin e blerjeve të ardhshme neto.

4.3.6 Thirrjet e kolateralit përcaktohen nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike për çdo Ditë Pagine, si çmimi total i blerjes për secilin anëtar në tregun e energjisë elektrike gjatë një periudhe kohore të vendosur nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, duke përfshirë TVSH-në. Periudha mund të ndryshohet duke njoftuar dy ditë përpara, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit.

4.3.7 Nëse një anëtarë ndryshon nga shitës neto në blerës neto në ditën e parë, thirrja për kolateral është përcaktuar si blerje neto e energjisë elektrike shumëzuar me një numër ditësh, siç përcaktohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike. Nëse anëtarë vazhdon si një blerës neto, thirrjet për kolateral do të

rregullohen çdo ditë përgjatë një numri ditësh, siç përcaktohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, e më pas të specifikuara në kushtet e përgjithshme. Nëse anëtarë kthehet në pozicionet e një shitjeje neto, thirrjet për kolateral do të reduktohen çdo ditë derisa sasia minimale të rikuperohet.

4.3.8 Thirrja për kolateral është specifikuar për secilën monedhë tregtimi. Anëtarë i cili operon me më shumë se një monedhë tregtimi do të deklarojë monedhën e zbatueshme të kolateralit.

4.3.9 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mundet që në gjykimin e saj, të rregullojë thirrjet për kolateral nëse tregtimi i anëtarëve ndryshon ose kur rrethana të veçanta e kërkojnë këtë.

4.3.10 Pjesëmarrësi do të njoftohet për çdo thirrje kolaterali brenda orës 09:00 CET për secilën ditë pagine. Thirrjet për kolateral duhet të plotësohen brenda orës 11:00 CET në të njëjtën ditë pagine.

4.3.11 Anëtarë që operon me më shumë se një monedhë tregtimi duhet të bjerë dakord me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike mbi monedhën e kolateralit për të llogaritur të gjitha thirrjet e kolateralit, duke ndjekur monedhën e kolateralit të prezantuar, ku është e përshtatshme, aplikimin nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike të normave të tilla të arsyeshme të këmbimit valuator, siç Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike i konsideron të përshtatshme.

4.3.12 Kolaterali i jashtëzakonshëm mund të postohet brenda një (1) ore pasi anëtarë merr njoftimin e thirrjes së kolateralit të jashtëzakonshëm, në formën e kolateralit *cash*, ose në të kundërt mund të rrisë kolateralin e ofruar nga/ose në emër të anëtarit në të njëjtin afat. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund, sipas gjykimit saj, të aplikojë ndonjë procedurë tjetër të llogaritjes së riskut sipas rrethanave përkatëse. Thirrja e kolateralit mund të përcaktohet individualisht, sipas kategorive të anëtarëve ose për të gjithë anëtarët.

## 5. TAKSAT DHE TVSH-ja

5.1 TVSH-ja do të aplikohet për të gjithë anëtarët e regjistruar në Shqipëri (rezidentët) dhe specifikisht:

- i) Të gjitha sasi të maturuara si rezultat i transaksioneve të kryera;



ii) Me llogaritjen e kolateralëve të kërkuar.

5.2 Për anëtarët e regjistruar jashtë Shqipërisë (jorezidentët), pagesa e të gjitha taksave, përfshirë TVSH-në, do të jetë një detyrim i anëtarit respektiv, në përputhje me ligjin në fuqi në vendin e regjistrimit.

5.3 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk është përgjegjëse për asnjë lloj dëmshpërblimi të TVSH-së kundrejt anëtarëve.

## 6. SHKELJET E RREGULLAVE

6.1 Çdo shkelje e këtyre Rregullave (duke përfshirë çdo mospagesë që anëtari i detyrohet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike), do të konsiderohen si ngjarje e mospërputhshmërisë ose ngjarje e mospërputhshmërisë thelbësore (sipas rastit), siç përcaktohet në nenin 9 të Rregullave të tregtimit - Kushtet e përgjithshme.

6.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në kushtet e një ngjarje të mospërputhshmërisë, duhet:

a) Të deklarojë ankesat e anëtarit mospagues të parashikuar në atë datë;

b) T'i mbajë një sasi shlyerjesh *cash* që i detyrohet anëtarit;

c) Të zbatojë, të realizojë dhe të aplikojë të drejtat e tij në kolateralin e postuar nga ose në emër të anëtarit, duke: i) përdorur garancitë bankare ofruar kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike nga ose në emër të anëtarit; ose ii) duke përdorur balancën e llogarive *cash* të garancisë, të ofruara kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike nga ana e ose në emër të anëtarit.

## **RREGULLAT SPECIFIKE PËR TREGTIMIN E ZONAVE TË IMPORTIT DHE EKSPORTIT RREGULLAT E TREGUT SHTOJCA 6 BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE**

### 1. HYRJE

1.1 Këto rregulla janë pjesë e Rregullave të Tregut dhe përmbajnë dispozita të hollësishme në llogaritjen e ofertave dhe çmimeve në zonat e eksportit dhe në zonat e importit.

1.2 OST-ja siguron një sasi të caktuar të kapacitetit transmetues disponibël të ditës në

avancë për zonat e importit dhe të eksportit. Këto kapacitete janë të publikuara në faqen zyrtare të Bursës Shqiptare të Energjisë deri në orën 10:00 të çdo dite në ditët e tregtimit.

1.3 Pjesëmarrësit të cilët kanë hyrë në marrëveshje përkatëse me OST-në, janë të lejuar të hapin portofolin për tregtim në një ose më shumë, në zonat e importit dhe të eksportit.

## 2. KUFIZIME TË VEÇANTA NË ANKANDET PËR EKSPORT OSE IMPORT NË ZONAT E VEÇANTA

2.1 Vetëm aplikimet orare janë të lejueshme për ofertim në zonat e importit dhe të eksportit.

2.2 Në zonat e eksportit janë të lejueshme vetëm porositë për blerje.

2.3 Në zonat e importit janë të lejueshme vetëm porositë për shitje.

2.4 Vëllimet e ofertave për anëtar në çdo orë nuk duhet ta tejkalojë kapacitetin tregtar disponibël në lidhjet përkatëse, për orët përkatëse.

## 3. LLOGARITJA E ÇMIMIT DHE E SASIVE

3.1 Në zonat e importit, çdo sasi e shitur e anëtarëve llogaritet bazuar në aplikimet e shitjes së anëtarëve, sipas ekuilibrit ndërmjet kurbës së shitjes të zonës së importit dhe sasisë së llogaritur të importit.

3.2 Nëse sasia totale e shitjes me çmimin minimal nga të gjithë anëtarët në zonat e importit tejkalon kapacitetin disponibël në drejtim të Shqipërisë, sasia e shitur për çdo anëtar do të kufizohet proporcionalisht deri në arritjen e çmimit minimal.

3.3 Në zonat e eksportit sasia e blerjes së çdo anëtari do të llogaritet bazuar në aplikimin e blerjes së çdo anëtari sipas ekuilibrit ndërmjet kurbës së blerjes së zonës së importit dhe sasisë së llogaritur të eksportit.

3.4 Nëse sasia totale e blerjes me çmimin maksimal nga të gjithë anëtarët në zonat e eksportit tejkalon kapacitetin disponibël në drejtim të Shqipërisë, sasia e blerë për çdo anëtar do të kufizohet proporcionalisht deri në arritjen e çmimit maksimal.

3.5 Sasitë e blera në zonat e eksportit ose të shitura në zonat e importit do të zgjidhen gjithmonë në Zonën Shqiptare të Çmimit.



**MARRËVESHJE  
PËR PJESËMARRJEN NË BURSËN  
SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

№ ...../.....

Ndërmjet,

Bursës Shqipëtare të Energjisë Elektrike, një kompani që kryen aktivitetin e licencuar nga ERE, mbajtës i licencës nr.\_\_\_\_, me seli në Shqipëri, me adresë: \_\_\_\_\_, i regjistruar në Regjistrin Tregtarë (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit) me vendim nr.\_\_\_\_datë \_\_\_\_\_, i përfaqësuar nga XXX, Administrator i shoqërisë, këtu e më poshtë referuar si OPERATOR

Dhe

“Shoqëria tregtare”, regjistruar si person juridik pranë QKR në datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_ me seli në Shqipëri, me adresë: (Adresa; Qyteti; Shteti) me NIPT nr.\_\_\_\_\_, përfaqësuar nga \_\_\_\_\_ Administrator i shoqërisë, këtu e më poshtë referuar si Pjesëmarrësi.

**I. Dispozita të Përgjithshme**

1. Bursa Shqipëtare e Energjisë Elektrike (BSHE) i licencuar për organizimin e bursës së energjisë elektrike, në cilësinë e një operatori të bursës së energjisë, organizon bursën e energjisë elektrike.

2. Pas lidhjes së kësaj marrëveshjeje (këtu e më poshtë si Marrëveshje), Pjesëmarrësi do të ketë të drejtë të përfundojë transaksione në bursën e energjisë elektrike, e cila do të jetë subjekt i likuidimeve.

3. Të drejtat dhe detyrimet e Pjesëmarrësve duke ju referuar veprimeve në bursën e energjisë, parashikohen në këtë Marrëveshje, Rregullat e Tregut dhe në të gjitha anekset e tij dhe në tarifatat e BSHE-së (këtu e mëposhtë referuar si Rregullat e Bursës së Energjisë).

4. Pjesëmarrësi në këtë mënyrë pranon të nënshtrohet Rregullave të Bursës së Energjisë Elektrike, të cilat konsiderohen si pjesë e kësaj marrëveshjeje.

5. Termat dhe afatet e vendosura tek Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike janë gjithashtu të përfshira në këtë marrëveshje.

**II. Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike**

1. Rregullat e Bursës së Energjisë miratuar nga ERE janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.

2. Duke nënshkruar këtë marrëveshje, Pjesëmarrësit bien dakort të kryejnë veprimet në

përputhje me kushtet dhe kërkesat e vendosura në Rregullat e Bursës së Energjisë. Në rast konflikti midis Rregullave të Tregut dhe Marrëveshjes, Rregullat e Tregut do të prevalojnë.

3. Pjesëmarrësit pranojnë që Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike miratuar nga ERE janë të kontrolluara dhe aprovuara nga BSHE dhe BSHE do të ketë të drejtën për imponimin e dispozitave të këtyre rregullave mbi pjesëmarrësit.

4. Të gjithë pjesëmarrësit që kanë kontrata afatgjata bilaterale ekzistuese dhe marrëveshje të ngjashme duhet t'i regjistrojnë ato në përputhje me kërkesat e informacionit të paraqitura nga Bursa Shqipëtare e Energjisë elektrike brenda tre muajve nga ekzekutimi i kësaj marrëveshjeje.

5. Pjesëmarrësi duhet të ofrojë garanci kolaterale të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin e tij në treg në lidhje me transaksionet sipas Rregullave të Tregut.

6. Qëllimi i transaksioneve të lejuara për pjesëmarrësin në treg do të përcaktohet në Shtojcën 1 të Rregullave të Tregut - Specifikimet e Produktit.

7. Bursa Shqipëtare e Energjisë elektrike do të lëshojë fatura për elementët e mëposhtëm që lidhen me shkëmbimin e energjisë përmes tregut të operuar nga ai:

- Për shërbimet e Bursës Shqipëtare të Energjisë elektrike dhe pjesëmarrjen në treg;
- Për energjinë e tregtuar;
- Për penalitetet, ashtu si aplikohen për transaksionet, sipas Rregullave të Tregut; dhe
- Për interesin e mbledhur mbi pagesat e vonuara.

8. Shkëmbimi i informacionit në lidhje me procesin e ofertimit dhe përcaktimit të çmimit si dhe të gjitha proceset e zgjidhjes financiare, duke përfshirë garancitë, do të përcaktohen në Rregullat e Shkëmbimit të Informacionit që do të hartohen më vonë nga Operatori i Tregut.

**III. Përfaqësimi**

Përfaqësimi nga Pjesëmarrësit

1. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Pjesëmarrësi i garanton BSHE-së:

a) Të gjitha veprimet e nevojshme që janë ndërmarrë për marrjen e autorizimit pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, të cilat janë të përshkruara në Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike; dhe

b) Nënshkruarja e kësaj marrëveshjeje, e plotësuar nga Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike nuk



shkel: asnjë ligj, rregull, rregulla, marrëveshje ose ndonjë dokument detyrues ose të zbatueshëm për pjesëmarrësit.

2. Pjesëmarrësi pranon që të ketë detyrimin të lajmëroj BSHE-në në rastet kur shkel rregullat e pikës 9.

#### IV. Përfaqësimi nga BSHE

1. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, BSHE i garanton Pjesëmarrësit:

a) Të gjitha veprimet e nevojshme që janë ndërmarrë për marrjen e autorizimit pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, të cilat janë të përshkruara në Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike; dhe

b) Nënshkruarja e kësaj marrëveshje, e plotësuar nga Bursa e Energjisë Elektrike nuk shkel: asnjë ligj, rregull, rregulla, marrëveshje ose ndonjë dokument detyrues ose të zbatueshëm për pjesëmarrësit.

#### V. Konfidencialiteti

1. BSHE garanton se asnjë palë e tretë nuk ka të drejtë të jap ose të marrë informacion mbi çështjet lidhur me veprimtarinë e kryer ose çështjet personale të Pjesëmarrësit, e cila ka marrë vlerë në transaksionet që janë kryer në Bursën e Energjisë Elektrike nga Pjesëmarrësi. BSHE nuk do të përdorë këto informacione për qëllime të tjera nga çështjet e përshkruara.

2. Pjesëmarrësi do të sigurojë që asnjë palë e tretë të ketë akses ose të marrë informacion konfidencial lidhur me aktivitetin, marrëveshjet, konsumatorët, klientët ose furnizuesit e BSHE-së.

3. Detyrimi i konfidencialitetit nuk përfundon pas përfundimit ose amendimit në terma dhe karakter të marrëdhënies juridike të punës midis Operatorit dhe punonjësve të tij ose personave që kanë të drejtë akses në informacionet konfidenciale në bazë të një kontrate civile ose kontrata të tjera.

4. Marrëveshja e konfidencialitetit jep informacion, i cili është ose është bërë publik për shkak të shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit në pajtim me këtë marrëveshje.

5. Detyrimi konfidencial nuk kufizon Operatorin të marrë informacion nga Enti Rregullator ose ku është kërkuar nga ligji.

6. Pjesëmarrësi, pranon të drejtën e pronësisë të Operatorit mbi informacionet e biznesit si dhe të drejtën e disponimit në përputhje me kushtet dhe kërkesat e Rregullave të Bursës së Energjisë Elektrike.

7. Përmbyllja e kësaj marrëveshjeje dhe çdo ndërprerje ose përfundim nuk heq detyrimin e konfidencialitetit.

#### VI. Amendimi i Marrëveshjes

1. Amendimi i kësaj marrëveshje kërkon marrëveshje me shkrim nga të dyja palët.

2. BSHE mund të amendojë Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike në përputhje me kushtet e përcaktuara në to, pavarësisht pikës 19.

3. Amendimet në Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike pas miratimit nga ERE dhe mbylljes së kësaj marrëveshje bëhen pjesë e saj dhe janë të aplikueshme për të dyja palët.

#### VII. Përfundimi i Marrëveshjes

1. Çdo pjesëmarrës mund të përfundojë këtë marrëveshje me një letër njoftim në përputhje me Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike.

2. Ndërprerja ose përfundimi i kësaj Marrëveshje për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve nga një nga palët është e përshkruar në Rregullat e Bursës së Energjisë Elektrike.

#### VIII. Përjashtimet

1. Pavlefshmëria e ndonjë klauzole të kësaj marrëveshje nuk çon në pavlefshmërinë e ndonjë klauzole tjetër ose në pavlefshmëri të të gjithë marrëveshjes.

#### IX. Ligji i Aplikueshëm

1. Çdo pretendim, konflikt ose mospajtim të cilat mund të lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, përfshirë çdo çështje që ka të bëjë me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e saj do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi.

2. Çdo palë përfundimisht heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë momentalisht ose më vonë lidhur me vendin e ndonjë procedure në gjykatën e Shqipërisë dhe duhet të pranojë që çdo vendim i marrë në gjykatën e Shqipërisë duhet të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët.

NË CILËSINË E DËSHMITARIT PËR MARRËVESHJEN E TYRE çdo palë sjell përfaqësuesit e autorizuar për ta bërë efektive këtë marrëveshje që nga data e firmosjes nga të dyja Palët.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 kopje origjinale, dy në gjuhën Angleze dhe dy në gjuhën Shqipe, dhe çdo palë duhet të ketë dy kopje, nga një në secilën gjuhë. Në cdo rast për efekt të interpretimit të këtij dokumenti, gjuhe referuese do të konsiderohet gjuha që palët zgjedhin si referuese.



Për dhe në emër të Pjesëmarrësit

\_\_\_\_\_  
Firma

\_\_\_\_\_  
Emri dhe Titulli

Data:

Për dhe në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike

\_\_\_\_\_  
Firma

\_\_\_\_\_  
Emri dhe Titulli

Data:

Aplikimet, si pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje:

1. Informacion për personin përgjegjës për tregtimin dhe zgjidhjen në emër të pjesëmarrësit të tregut.
2. Kolaterali fillestar.
3. Deklarata për rrjetin e detyrimeve.
4. Deklarata për miratimin për të marrë fatura elektronike.

Njoftim:

Marrëveshja firmoset nga përfaqësuesit e kompanive në përputhje me certifikatën e marrë nga procesi i regjistrimit. Operatori mund të kërkoj informacione shtesë nëse pjesëmarrësi nuk është regjistruar në librin tregtar Shqiptar dhe për këtë arsye nuk është në pozicionin për të marrë certifikatën e duhur për regjistrim.

## MARRËVESHJA E PJESËMARRJES ANEKSI 1

### DETAJET MBI KONTAKTET DHE AUTORIZIMET

#### 1. STATUSI

<b>Pjesëmarrësi</b>	Emri i shoqërisë		
<b>Statusi i dokumentit:</b>	<input type="checkbox"/> Origjinal	<input type="checkbox"/> Amenduar	

1.1 Aneksi 1 formon një pjesë integrale të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes.

#### 2. DETAJE TË PËRGJITHSHME PËR KONTAKTIN

<b>Adresa postale:</b>	[adresa] [postcode] [vendi]	<b>Adresa:</b>	[adresa] [postcode] [vendi]
<b>Nr. i regjistrimit:</b>	[vendos nr.]	<b>NUIS</b>	[vendos nr.]
<b>Adresa e faturimit:</b>	(vendos adresën nëse është e ndryshme nga adresa postale)		
<b>Telefoni:</b>	[vendos nr.]	.....	[vendos nr.]
<b>Adresa e e-mail-it për grupin e tregimit të ditës në avancë:</b>	[specifiko adresën e e-mail-it që do të përdoret për të marrë raportet tregtare nga sistemi SESAM i ankandit të ditës në avancë ]		
<b>Adresa e e-mail-it në grupin për shlyerjet</b>	[specifiko adresën e e-mail-it që do të përdoret për marrjen e raporteve të faturave nga sistemi i pasqyimit të BSHE-Së]		
<b>Adresa e e-mail-it për grupin e kolateralit:</b>	[specifiko adresën që do të përdoret për marrjen e raporteve të kolateralit nga sistemi i pasqyimit të BSHE-së]		



## 3. Organizimi

Pjesëmarrësi autorizon çdo apo të gjithë individët e mëposhtëm në lidhje me tregtimin ose pasqyrimin.

## 3.1 Personi përgjegjës për tregtimin e ditës në avancë

<b>Emri:</b>		<b>Pozicioni:</b>	
<b>Telefoni:</b>		<b>Celular:</b>	
<b>E-mail:</b>			
<b>Koment:</b>			

## 3.2 Personi përgjegjës për shlyerjet

<b>Emri:</b>		<b>Pozicioni:</b>	
<b>Telefoni:</b>		<b>Celulari:</b>	
<b>E-mail:</b>			
<b>Koment:</b>			

## 3.3. Personi përgjegjës për kolateralin

<b>Emri:</b>		<b>Pozicioni:</b>	
<b>Telefoni:</b>		<b>Celulari:</b>	
<b>E-mail:</b>			
<b>Koment:</b>			

## 4. Amendimi

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe anëtarët e saj mund t'i drejtohen ERE-s, me kërkesën për amendime në këtë aneks dhe, kjo e fundit shprehet me vendim mbi miratimin apo jo të këtyre kërkesave. Në çdo rast palët kanë të drejtë të saktësojnë të dhënat e kërkuara sipas këtij aneksi.

\* \* \*

Për dhe në emër të kompanisë

Data:

\_\_\_\_\_  
Firma

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli

## Nënshkrimi

Nënshkrimet e autorizuara janë të kërkuara për ta bërë efektive këtë aneks 1 dhe çdo amendament. Nënshkrimet e autorizuara ekzekutohen nga persona që kanë autoritet të përgjithshëm për nënshkrimet për pjesëmarrësin ose personin përgjegjës, në përputhje me nenin 3 të këtij aneksi (vetëm në rastet e amendimit).



MARRËVESHJA E PJESËMARRJES  
ANEKSI 2

PAMJE E PËRGJITHSHME E PORTOFOLIT TREGTAR

1. STATUSI

<b>Pjesëmarrësi:</b>			
<b>Statusi i dokumentit:</b>	<input type="checkbox"/> <b>Origjinal</b>	<input type="checkbox"/> <b>Amenduar</b>	

1.1 Aneksi 2 formon një pjesë integrale të Marrëveshjes së Pjesëmarrjes.

2 PORTOFOLI TREGTAR PËR DITËN NË AVANCË

Emri i portofolit	Zona e tenderimit	Data e fillimit	Data e mbarimit

3. Amendimet

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe anëtarët e saj mund t'i drejtohen ERE-s, me kërkesën për amendime në këtë Aneks dhe, kjo e fundit shprehet me vendim mbi miratimin apo jo të këtyre kërkesave. Në çdo rast palët kanë të drejtë të saktësojnë të dhënat e kërkuara sipas këtij Aneksi.

\* \* \*

Për dhe në emër të kompanisë:

Data:

\_\_\_\_\_  
Firma

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli

Për dhe në emër të Bursës:

Data:

\_\_\_\_\_  
Firma

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli

Nënshkrimi

Firma e autorizuar kërkohet në mënyrë që të bëjë efektive aneksin 2 dhe çdo amendim. Firma e autorizuar jepet nga persona që kanë të drejtën e firmosjes së përgjithshme për pjesëmarrësit



MARRËVESHJA  
E KRIJUESIT TË TREGUT  
BURSA SHQIPTARE E ENERJISË  
ELEKTRIKE

MARRËVESHJA E PJESËMARRJES  
ANEKSI 3

Marrëveshja e Krijuesit të Tregut,  
lidhur ndërmjet:

Krijuesi i Tregut - kompanisë [vendosni emrin e kompanisë], me nr. regj. [vendosni numrin e regjistrimit], në [vendosni shtetin e rezidencës], regjistri i kompanisë;

dhe

BSHEE-së - Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, një kompani shqiptare me nr. regj. XXXXX, në regjistrin e kompanive shqiptare.

Krijuesi i Tregut dhe Bursa e Energjisë Elektrike janë këtu e tutje të referuara si “Palët” dhe individualisht si “Pala”.

#### 1. TË PËRGJITHSHME

1.1 BSHEE-ja funksionon në tregjet e tregimit të kontratave të energjisë elektrike me shpërndarjen fizike në Shqipëri. Krijuesi i Tregut ka hyrë në një marrëveshje pjesëmarrësi me BSHEE-në për Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe ka aplikuar për miratimin e BSHEE-së për t'u bërë një Krijues Tregu në këtë treg.

1.2 Me anë të kësaj marrëveshjeje, Krijuesi i Tregut fiton të drejta dhe merr përsipër detyrimet e një Krijuesi të Tregut në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë. Kjo marrëveshje plotëson marrëveshjet përkatëse të anëtarësimit me pjesëmarrësin dhe rregulloret përkatëse të tregimit.

#### 2. INTERPRETIMI

2.1 Termat dhe shprehjet e përcaktuar në përkufizimet e Rregullave të Tregut (shtojca 1- Specifikimi i produktit - Rregullat e tregimit) do të kenë të njëjtin kuptim kur të përdoren në këtë marrëveshje dhe çdo parim i interpretimit të Rregullave të Tregut do të zbatohet siç duhet në këtë marrëveshje. Përveç kësaj, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin si më poshtë:

a) “Programi i faturave” do të thotë Rregullat e tregimit, shtojca 5.

b) “Grup” do të thotë pjesëmarrësi, çdo subjekt i kontrolluar nga pjesëmarrësi, çdo subjekt që kontrollon pjesëmarrësin, si dhe çdo subjekt nën kontroll të përbashkët me pjesëmarrësin.

c) “Rregullat e tregimit” do të thotë urdhrat e lëshuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në çdo kohë për të drejtuar tregtimin në tregjet fizike, duke përfshirë edhe shtojcat e tregimit dhe marrëveshjet e tregimit.

2.2 Në rast, konflikti me Rregullat e Tregut, kjo marrëveshje do të prevalojë.

#### 3. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KRIJUESIT TË TREGUT

3.1 Krijuesi i Tregut do të kuotojë çmimet e detyrueshme të ofertës për produktet me një vëllim dhe kërkesa minimale të shpërndarjes, siç përcaktohet në aneksin 1 të këtij aneksi (vëllimi minimal dhe kërkesat e shpërndarjes).

3.2 Çdo porosi e kuotuar nga Krijuesi i Tregut do të zëvendësohet me një porosi të re pa vonesa të pabaza pasi një transaksion të jetë kryer.

3.3 Krijuesi i Tregut do të kuotojë çmimet në përputhje me këtë Marrëveshje, në gjithë ditët e tregimit, në periudhën nga 30 minuta pas fillimit të orëve të tregimit deri në fund të orëve të tregimit, me përjashtimet e dhëna në këtë Marrëveshje, përfshirë si më poshtë.

3.4 Krijuesi i Tregut ka të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij të kuotimit për një periudhë totale prej 10 ditësh tregtimi gjatë një viti kalendarik, ashtu si është rënë dakord me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, por jo më pak se një muaj më parë se dita e fillimit të një çlirimi të tillë.

3.5 Krijuesi i Tregut ka të drejtën të çlirohet nga detyrimet e tij të kuotimit për një periudhë totale prej 30 minutash çdo ditë tregtimi, gjithmonë me kusht që Krijuesi i Tregut përmbush detyrimet e veta gjatë 15 minutave të fundit të orëve të tregimit të asaj dite tregtimi.

3.6 Krijuesi i Tregut që ka informacion do të lirohet nga detyrimet e tij të kuotimit deri kur ky informacion të vihet në dispozicion të publikut. Çlirimi për shkak të informacionit të brendshëm nuk do të ndikojë në numrin e minutave të lira gjatë Ditës së Tregimit. Krijuesi i Tregut duhet, me kërkesë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, të dokumentojë se mungesa e tij ishte për shkak të informacionit të brendshëm.

#### 4. TARIFAT E TREGTIMIT DHE KOMPENSIMI

4.1 Krijuesi i Tregut do t'i paguajë BSHEE-së tarifata tregtare dhe tarifata tjera të përshkruara në aneksin 2 të këtij aneksi (tarifat tregtare dhe kompensimin për Krijuesin e Tregut në Tregun





Shqiptar të një Ditë më Parë). Tarifat duhet të faturohen siç është përshkruar në Rregullat e Tregut.

## 5. INFORMACIONI

5.1 BSHEE-ja do të bëjë përpjekje maksimale për të mbajtur Krijuesin e Tregut të informuar për të gjitha të dhënat materiale relevante për rolin e saj si Krijues i Tregut. Kjo përfshin përfundimin e çfarëdo marrëveshjeje ekzistuese për Krijimin e Tregut apo krijimin e marrëveshjeve të reja të Krijuesit të Tregut me krijuesit e tjerë të tregut. Një informacion i tillë do të shpërndahet pa vonesë dhe te të gjithë Krijuesit e Tregut në të njëjtën kohë.

## 6. RREGULLORE E FUNKSIONIMIT NË GJENDJE TEKNIKE TË JASHTËZAKONSHME

6.1 Në rastin e një dështimi teknik në ETS apo në sistemet e krijuesve të tregut, Krijuesi i Tregut do të çlirohet nga detyrimet e veta si Krijues Tregu, në përputhje me këtë Marrëveshje. Në rast të dështimit teknik në sistemet e vetë krijuesve të tregut, Krijuesi i Tregut do të informojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për dështimin dhe menjëherë ndërmerr veprimet e nevojshme për të ndrequr veten.

## 7. SHKELJA E KONTRATËS

7.1 Nëse Krijuesi i Tregut dështon në përmbushjen e detyrimeve të veta, në përputhje me këtë Marrëveshje për ndonjë periudhë specifike të çfarëdoshme, do të imponojë tarifa normale tregtare dhe pagesë për të gjitha transaksionet e kryera nga Krijuesi i Tregut gjatë periudhës në fjalë. BSHEE-ja do të informojë Krijuesin e Tregut që Krijuesi i Tregut është në shkelje të detyrimeve të veta dhe se tarifa të tilla do të imponohen. Dështimi i Krijuesit të Tregut për të përmbushur detyrimet e veta nuk do të çojë në përgjegjësi, direkte ose indirekte të rimbursimit të BSHEE-së për tregtinë gjatë periudhave të tjera.

## 8. NDRYSHIMET NË KONTRATË

8.1 Ndryshimet në këtë Kontratë kërkojnë një marrëveshje me shkrim nga të dyja palët.

8.2 Pavarësisht nga neni 8.1 i këtij aneksi, BSHEE-ja mund të ndryshojë Rregullat Tregtare përkatëse në përputhje me dispozitat e tyre.

## 9. KOHËZGJATJA DHE NDËRPRERËJA

9.1 Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi nga [vendosni datën].

9.2 Secila Palë mund ta ndërpresë këtë marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim Palës tjetër tre (3) muaj më parë.

9.3 Në rast se Marrëveshja e Pjesëmarrjes me Krijuesin e Tregut është ndërprerë, kjo Marrëveshje do të ndërpritet në të njëjtën datë, si edhe Marrëveshja e Pjesëmarrjes.

## 10. TË NDRYSHME

### 10.1 Vërejtje

10.1.2 Çdo njoftim që kërkohet të jepet sipas kësaj marrëveshjeje apo Rregullave të Tregut nga Krijuesi i Tregut, do të jepet nga përfaqësuesit e autorizuar dhe me shkrim të përfaqësuesve të autorizuar të BSHEE-së, përveç kur parashikohet ndryshe në Rregullat e Tregut.

### 10.2 Marrëveshja e plotë

10.2.1 Kjo marrëveshje dhe Rregullat e Tregut përmbajnë marrëveshjen e plotë ndërmjet BSHEE-së dhe Krijuesit të Tregut në lidhje me lëndën e kësaj marrëveshjeje dhe Rregullave të Tregut dhe i mbivendoset çdo rregullimi të mëparshëm, marrëveshjeje mes tyre në lidhje me këtë çështje.

10.2.2 Secila palë pranon, se me hyrjen në këtë marrëveshje, ajo (pala) nuk është mbështetur në, dhe nuk do të ketë asnjë të drejtë apo zgjidhje në lidhje me çfarëdo deklarate, përfaqësimi, sigurimi ose garancie tjetër, përveçse siç është përcaktuar shprehimisht në këtë marrëveshje dhe Rregulloren e Tregut.

10.2.3 Asgjë në këtë nen 10.2 nuk do të kufizojë ose përjashtojë ndonjë përgjegjësi për mashtrimin.

### 10.3 Ndarshmëria

10.3.1 Në rast se ndonjë apo më shumë dispozita të kësaj marrëveshjeje, për ndonjë arsye, do të jenë të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, dispozitat e mbetura do të mbeten të vlefshme dhe të zbatueshme.

### 10.4 Delegimi

10.4.1 Pjesëmarrësi nuk mund të transferojë, të zëvendësojë apo të delegojë këtë marrëveshje ose të drejtat e saj në përputhje me Rregullat e Tregut, pa pëlqimin paraprak me shkrim të BSHEE-së.

### 10.5 Homologët

10.5.1 Kjo marrëveshje mund të zbatohet nga cilido numër palësh e, në çdo rast, kur të zbatohet do të konsiderohet si një original i kësaj marrëveshjeje, por të gjitha palët do të konsiderohen si e njëjta marrëveshje.



## 10.6 Dorëheqja

10.6.1 Asnjë dështim ose vonesë nga një palë për të ushtruar ndonjë të drejtë apo zgjidhje të parashikuar sipas kësaj marrëveshjeje ose nga ligji, nuk do të përbëjë një dorëheqje nga ajo apo nga ndonjë e drejtë apo zgjidhje tjetër.

## 11. LIGJI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

11.1 Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në përputhje me legjislacionin shqiptar.

11.2 Gjykatat shqiptare do të kenë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur ndonjë pretendim, mosmarrëveshje apo ndryshim që mund të lindin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje, duke përfshirë edhe ndonjë pyetje, si për ekzistencën e saj, vlefshmërinë apo ndërprerjen.

11.3 Secila palë heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshti që mund të ketë tani apo në të ardhmen në lidhje me kompetencën territoriale të shqyrtimit nga gjykatat shqiptare apo çdo pretendim në lidhje me procedurat e ndjekura në një gjykim të tillë dhe, më tej në mënyrë të pakthyeshme bie dakord se, cilido qoftë vendimi i marrë gjykatat shqiptare, do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të gjitha palët dhe mund të zbatohet në çdo juridiksion tjetër në pajtim me ligjin në fuqi.

Në dëshmi të marrëveshjes tyre, çdo palë ka realizuar që përfaqësuesi i autorizuar të ekzekutojë këtë marrëveshje funksionale që nga data e nënshkrimit nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje është bërë në dy (2) kopje origjinale dhe secila palë mban një (1).

Për dhe në emër të anëtarit:

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli (germat e printuara)

Data:

Për dhe në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli (germat e printuara)

Data:

FIRMAT
--------

Nënshkrimet e autorizuar janë të nevojshme për të realizuar këtë Marrëveshje të Krijuesit të Tregut. Nënshkrimet e autorizuar bëhen nga person(a) që kanë autoritet të përgjithshëm nënshkrimi për anëtarin.
--

Aneksi 1. Volumi dhe kërkesat minimale të shpërndarjes (Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë)

Aneksi 2. Tarifat e tregtimit dhe kompensimet për Krijuesin e Tregut në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë.



ANEKSI 1  
VOLUMI DHE KËRKESAT MINIMALE TË SHPËRNDARJES

Intervali i çmimit në tabelën më poshtë përcaktojnë çmimet e zonave shqiptare. Krijuesi i Tregut do kuotojë porosinë në të gjitha intervalet e çmimeve në zonat e ofertimit të Tregut Shqiptar të Një Dite më Parë.

Volumi i Krijuesit të Tregut në një porosi është [futni volumin mw dhe zona e ofertimit]. Krijuesi i Tregut është i detyruar të mbushë të njëjtin volum maksimal [futni numrin] koha pas mbushjes së parë.

Orët e Krijuesit të Tregut janë nga [futni orët] në të gjitha ditët e tregimit

Tregu Shqiptar i Një Dite më Parë Çmimi i tregut EUR/mwh	<20	20–40	40–60	60–80	>80
Shpërndarja (diapazoni) i krijuesit të tregut		5	10	15	-

Për dhe në emër të kompanisë:

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli (germat e printuara)

Data:

Për dhe në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike:

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli (germat e printuara)

Data:

FIRMAT

Nënshkrimet e autorizuara janë të nevojshme për të realizuar këtë marrëveshje të krijuesit të tregut. Nënshkrimet e autorizuara bëhen nga person(a) që kanë autoritet të përgjithshëm nënshkrimi për anëtarin.

ANEKSI 2

TARIFAT E TREGTIMIT DHE KOMPENSIMET PËR KRIJUESIN E TREGUT NË TREGUN SHQIPTAR TË NJË DITE MË PARË

1. Tarifat tregtare dhe vjetore do të paguhet siç përcaktohen në Rregullat e Tregut.

2. Kompensimi për krijuesin e tregut.

Kompensimi për krijuesin e tregut do të llogaritet mbi një bazë mujore. Kompensimi për krijuesin e tregut është një XXX% zbritje nga tarifat vjetore të anëtarësimit në Tregun Shqiptar të Një Dite më Parë dhe një XXX% zbritje nga tarifa e tregtimit të gjithë volumit të tregtuar të ditës më parë nga krijuesi i tregut.

Zbritja i është paguar krijuesit të tregut, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të muajit.

Për dhe në emër të kompanisë:

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli (germat e printuara)

Data:

Për dhe në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike AS:

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Emri dhe titulli (germat e printuara)

Data:

FIRMAT

Nënshkrimet e autorizuara janë të nevojshme për të realizuar këtë marrëveshje të krijuesit të tregut. Nënshkrimet e autorizuara bëhen nga person(a) që kanë autoritet të përgjithshëm nënshkrimi për anëtarin.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë